



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 5

Tiranë – E martë, 9 janar 2024

PËRMBAJTJA

| | | Faqe |
|---|--|------|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 732, datë 13.12.2023 | Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për gruan, paqen dhe sigurinë” 2023–2027, në Republikën e Shqipërisë..... | 295 |
| Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 30.11.2023 | Çështja Alsula dhe të tjerë kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 63975/10 dhe 2 të tjera</i>)..... | 351 |
| Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 14.11.2023 | Çështja Çupi kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 27187/08</i>)..... | 354 |
| Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 62, datë 20.11.2023 | Me objekt shfuqizimin e pikës 2, të nenit 5, për sa i përket delegimit të dhënë Këshillit të Ministrave; nenit 8; fjalëve “ose me emra që janë në kundërshtim me rendin ose me dispozitat urdhëruese të ligjit”, në pikën 1, të nenit 9; shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 17; shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 20; neneve 26, 28, pika 6 dhe 32, që lidhen me pozitën e kancelarit; fjalëve “kancelari/ose kancelari” në nenet përkatëse ku përcaktohen; pikës 1 të nenit 29; pikave 1 dhe 2, të nenit 36; pikave 2–6 të nenit 49; pikës 5, të nenit 50, të ligjit nr. 80/2021, datë 24.5.2021, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. | 359 |
| Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 64, datë 30.11.2023 | Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit nr. 232, datë 1.2.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Konstatimin e cenimit të së drejtës për të mos u diskriminuar, si pasojë e statusit si ish-i përndjekur politik nga regjimi komunist..... | 384 |
| Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Arkivave nr. 5, datë 3.1.2024 | Për delegimin e kompetencave | 396 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 364, datë 15.12.2023 | Mbi miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, për vitin 2024..... | 397 |

| | | |
|---|---|-----|
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 365, datë 15.12.2023 | Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022..... | 398 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 366, datë 15.12.2023 | Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022..... | 400 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 367, datë 15.12.2023 | Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ‘Albgaz’ sh.a.”, për vitin 2024..... | 401 |
| Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 56, datë 27.12.2023 | Për licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a..... | 402 |
| Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 57, datë 27.12.2023 | Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 3, datë 30.1.2023, “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Kukës”..... | 404 |
| Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 58, datë 27.12.2023 | Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Vlorë sh.a..... | 405 |



VENDIM

Nr. 732, datë 13.12.2023

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E
REZOLUTËS 1325 TË KËSHILLIT TË
SIGURIMIT TË ORGANIZATËS SË
KOMBEVE TË BASHKUARA “PËR
GRUAN, PAQEN DHE SIGURINË” 2023–
2027, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimit për zbatimin e rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për gruan, paqen dhe sigurinë” 2023–2027, në Republikën e Shqipërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministritë dhe institucionet e tjera përgjegjëse, të përcaktuara në planin e veprimit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Shkurtesa

| | |
|----------------|---|
| Agjenda GPS | Agjenda ‘Gratë, Paqja, Siguria’ |
| AMVV | Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore |
| AFA | Akademia e Forcave të Armatosura |
| ASPA | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike |
| AKMC | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile |
| AVL | Komisioni Kombëtar për Armët e Vogla dhe të Lehta |
| BE | Bashkimi Evropian |
| FZ | Fletorja Zyrtare |
| FA | Forcat e Armatosura |
| KE | Komisioni Evropian |
| Koalicioni GPS | Koalicioni “Gratë, paqja, siguria” |
| KMS | Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë |
| KSKB | Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara |
| KKBGj | Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore |
| MAS | Ministria e Arsimit dhe Sportit |
| MB | Ministria e Brendshme |

PLANI I VEPRIMIT

PËR ZBATIMIN E REZOLUTËS 1325 TË
KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË
ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË
BASHKUARA “PËR GRUAN, PAQEN DHE
SIGURINË”

2023–2027

Tabela e Përmbajtjes

Shkurtesa

PJESA I. Konteksti strategjik

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit strategjik

PJESA II. Qëllimi i politikave, objektivat specifike dhe masat parësore të zbatimit të planit të veprimit

PJESA III. Qëllimet strategjike

Fusha politike 1 – Pjesëmarrja

Fusha politike 2 – Ndërgjegjësim dhe ekspertizë e thëlluar për agjendën Gruaja, Paqja, Siguria

Fusha politike 3 – Parandalimi

Fusha politike 4 – Mbrojtja

Fusha politike 5 – Lehtësimi dhe Rimëkëmbja

PJESA IV. Burime financiare

PJESA V. Llogaridhënia, monitorimi dhe analiza vlerësuese e planit të veprimit

Shtojca 1: Plani i Veprimit 2023–2027

Shtojca 2: Kostimi i Planit të Veprimit 2023–2027



| | |
|--------------------------------|--|
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| MEPJ | Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme |
| MSHMS | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| OKB | Organizata e Kombeve të Bashkuara |
| MTM | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit |
| OSHC | Organizatë e Shoqërisë Civile |
| MIE | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës |
| OSBE | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë |
| PKIE | Plani Kombëtar për Integrimin Evropian |
| Plani i Veprimit Rezoluta 1325 | Plani i Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 në Republikën e Shqipërisë Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për gruan, paqen dhe sigurinë” |
| QKEDH | Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm |
| RSH | Republika e Shqipërisë |
| SHM | Shkolla e Magjistraturës |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| SHPPFA | Shtabi i Përgjithshëm i FA |

PJESA I. Konteksti strategjik

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit strategjik

Republika e Shqipërisë iu bashkua vendeve që kanë hartuar një Plan Veprimi në kuadër të detyrimeve të zbatimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, “Për gruan, paqen dhe sigurinë”,¹ në vitin 2018 përmes miratimit të Planit të parë të Veprimit për zbatimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Rezoluta 1325 ‘Për gratë, paqen, sigurinë’ si tregues i vendosmërisë politike për të përparuar në adresimin e agjendës grua, paqja siguria (agjenda GPS) në vend.² Rezoluta 1325 vë theksin tek rëndësia e rolit dhe pjesëmarrjes së barabartë të grave në procesin e parandalimit dhe zgjidhjes së konflikteve dhe ndërtimin e paqes së qëndrueshme, dhe vë në plan të parë një agjendë për gratë, paqen e sigurinë në botë. Republika e Shqipërisë, përmes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nën drejtimin e ministres Manastirliu, vijoi angazhimin dhe koordinimin e punës për të garantuar të njëjtën qasje ndaj kësaj politike dhe miratimin e Planit të dytë të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325.

Republika e Shqipërisë, e zgjedhur për herë të parë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së anëtare jo e përhershme për periudhën kohore 2022–2023, ndër prioritet dhe angazhimet e saj në çështjet e sigurisë dhe paqes ka renditur si parësore qasjen me bazë gjinore, duke vënë në vëmendje se “një nga mënyrat më efektive për të arritur paqen dhe sigurinë e qëndrueshme është përmes përqendrimit të vazhdueshëm në zbatimin e përforcuar të agjendës së Grave, Paqes dhe Sigurisë, duke siguruar procese paqeje më gjithëpërfshirëse, barazj gjinore, fuqizimin e grave dhe mbrojtjen e të drejtave të grave.”³

Plani i Veprimit synon të jetë një akt me ndikim të lartë thyen ndarjen tradicionale mes qeverisë dhe shoqërisë civile, politikave rajonale dhe ndërkombëtare dhe atyre vendase, dhe mes çështjeve të forta të shoqërisë civile dhe zhvillimit dhe të drejtave të njeriut.

Vijmësia e politikës në kuadër të agjendës GPS është pasqyrim i qëllimit për të përfshirë dhe pasur kontributin e grave dhe vajzave në jetën politike dhe publike në vend dhe shfrytëzuar kapacitetet e të gjithë shoqërisë për një zhvillim të qëndrueshëm të vendit në përputhje me angazhimet në nivel ndërkombëtar dhe rajonal,

¹ Shih në: <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N08/576/40/PDF/N0857640.pdf?OpenElement> (aksesuar në maj 2022). Numri i shteteve anëtare të OKB-së që kanë miratuar tashmë një Plan Veprimi është 103, 53% e shteteve anëtare të OKB-së. Shih përditësimin e vijueshëm të numrit të shteteve me një plan veprimi për Rezolutën 1325 në: <https://1325naps.peacewomen.org/index.php/nap-overview/> (aksesuar në shtator 2022).

² Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 524, datë 11.9.2018, “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, “Për gruan, paqen dhe sigurinë”, 2018–2020”, në: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2018/09/11/524>

³ Shih në: <http://www.ambasadat.gov.al/council-of-europe/sites/default/files/Security%20Council%20UN.pdf>, f. 12-13. (aksesuar në dhjetor 2021)



përfshirë ato të OKB-së, NATO-s, BE-së, OSBE-së, dhe partnerëve ndërkombëtarë strategjikë të vendit⁴. Plani është në harmoni dhe respektim të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ) nr. 5 (Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave) dhe 16 (shoqëri paqësore, të drejta dhe gjithëpërfshirëse)⁵ të OKB-së. OZHQ nr. 5 “Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave” përcakton standarde të rëndësishme në kuadër të miratimit dhe zbatimit të politikave që promovojnë barazinë gjinore dhe synojnë fuqizimin e grave dhe vajzave në të gjitha etapat në përbërje të procesit të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë. Plani i Veprimit është në mbështetje edhe të UN Women, në zbatimin e Produktit 4 (“Më shumë gra të të gjitha moshave marrin pjesë plotësisht, udhëheqin dhe angazhohen në institucione dhe procese politike”), Rezultati 13 (“Më shumë angazhime për gratë, paqen dhe sigurinë zbatohen nga Shtetet Anëtare dhe sistemi i KB dhe më shumë mbrojtës të barazisë gjinore ndikojnë në paqen dhe proceset e sigurisë”), Produkti 14 (“Më shumë gra luajnë një rol më të madh dhe shërbejnë më mirë nga shërbimet e reagimit humanitar dhe shërimin”), dhe Rezultati 15 (“Më shumë gra luajnë një rol më të madh dhe shërbejnë më mirë nga proceset e menaxhimit të rrezikut nga katastrofat”) të Planit Strategjik të Kombeve të Bashkuara.⁶ Plani i Veprimit i posaçëm është në përputhje me programin kryesor të OKB-së të Grave për 'Gratë, Paqja dhe Siguria dhe Veprimi Humanitar' i përqendruar në ndërtimin e sinergjive mbi vazhdimësinë e zhvillimit humanitar duke

përfunduar veprimin, udhëheqjen dhe pjesëmarrjen e grave për të rindërtuar jetën e tyre në situata krize, konflikti apo katastrofe.⁷ Synimi i akteve për agjendën GPS është përmirësimi i institucionalizimit dhe kapacitetit për të siguruar që përpjekjet e GPS të jenë të qëndrueshme dhe afatgjatë. Qasja gjinore në adresimin e aspekteve humanitare, të situatave të konflikteve e pas-konflikteve, krizave në tërësi, apo edhe katastrofave natyrore është një qasje progresive që pasqyron se cilido ka vend dhe duhet të kontribuojë për një shoqëri që synon zhvillim të qëndrueshëm në çdo drejtim.

Qasja aktive në kuadër të agjendës GPS është në harmoni me Planin e Veprimit të NATO-s 2021–2027 për agjendën GPS, i cili mbështet angazhimin e aleatëve për të avancuar më tej barazinë gjinore dhe integrimin e perspektivave gjinore në angazhimet e NATO-s. Plani i Veprimit i NATO-s zbatohet për të gjithë Aleatët e NATO-s, përfshirë Shqipërinë.⁸ Kjo qasje është po ashtu në harmoni me politikën e Bashkimit Evropian (BE). BE-ja promovon barazinë gjinore, të drejtat e njeriut, paqen dhe sigurinë brenda dhe jashtë kufijve të tij, një parim ky i sanksionuar në Traktatin për Themelimin e Bashkimit Evropian, dhe që pasqyrohet në Strategjinë Globale për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian, Planin e Veprimit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (GPS), 2019–2024,⁹ si dhe *Gender Action Plan III - 2021–2027*, Planin e Nivelit të Zbatimit CLIP Albania¹⁰. Një nga pesë prioritetet e Strategjisë Globale është Qasja e Integruar ndaj Konflikteve dhe Krizave,¹¹ sipas së cilës BE-ja do të veprojë me shpejtësi në parandalimin e konflikteve dhe do të

⁴ Kjo qasje është në harmoni me Strategjinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Gratë, Paqja, Siguria, 2019, dhe Planin e Departamentit të Shtetit për të zbatuar Strategjinë për Gratë, Paqja, Siguria, 2020–2023. Shih në: https://www.state.gov/wp-content/uploads/2021/01/WPS_Strategy_10_October2019.pdf dhe https://www.state.gov/wp-content/uploads/2020/06/20-01943-SGWI_v11_forWeb_Bookmarks508.pdf (aksesuar në shtetor 2022).

⁵ <https://www.un.org/sustainabledevelopment/>, dhe “Programi i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2017–2021”, në: [https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/democratic_governance/programme-of-cooperation-](https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/democratic_governance/programme-of-cooperation-for-sustainable-development-2017-2021.html)

<for-sustainable-development-2017-2021.html>

⁶ <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2017/8/un-women-strategic-plan-2018-2021>

⁷ <https://wphfund.org/>

⁸ Miratuar nga Ministrat e Mbrojtjes në tetor 202. Shih në: https://www.nato.int/cps/en/natohq/official_texts_187485.htm?selectedLocale=en

⁹ Shih në: https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/eugs_reviw_web_0.pdf (aksesuar në maj 2022)

¹⁰ Shih në <https://europa.eu/capacity4dev/country-level-implementation-plans-clips---gender/documents/clip-albania> (aksesuar në 2022)

¹¹ Shih f. 9, po aty.



përgjigjet me vendosmëri dhe përgjegjësi ndaj krizave dhe konflikteve. Agjenda GPS, e konkretisht zbatimi i Rezolutës 1325, është në themel të kësaj strategjie.¹² Në këtë kuadër, BE-ja ka miratuar dhe është duke zbatuar Planin e Veprimit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (GPS) 2019–2024. Qasja Strategjike, sipas këtij Plani, është mbështetja e veprimeve të shoqërive dhe qeverive për të angazhuar, fuqizuar, mbrojtur dhe mbështetur gratë dhe vajzat me prejardhje të ndryshme nëpërmjet promovimit të angazhimeve dhe veprimeve konkrete, me theks të veçantë në arritjen e paqes dhe sigurisë së qëndrueshme dhe të qëndrueshme.¹³

COVID-19 dhe fatkeqësitë natyrore përballin shoqëritë në tërësi, përfshirë edhe atë shqiptare, me sfida të shumta e të panjohura. Ato e bënë shoqërinë në tërësi dhe mbi të gjitha gratë e vajzat të ishin jo vetëm vulnerabël, por edhe të përjetonin një shtim të dhunës ndaj tyre. Vijmësia e politikës së promovimit të qeverisjes së përgjegjshme gjinore, parandalimit dhe luftës së dhunës ndaj grave e vajzave të çdo forme, si dhe rritjes së pjesëmarrjes së grave në jetën politike dhe publike është kusht për zhvillimin e qëndrueshëm dhe qeverisjen e mirë. Vijmësia e politikës në kuadër të agjendës “Gruaja, paqja siguria” është pasqyrim i qëllimit për të përfshirë dhe pasur kontributin e grave dhe vajzave në jetën politike dhe publike në vend dhe shfrytëzuar kapacitetet e të gjithë shoqërisë. Një qasje më e thelluar ndaj sigurisë njerëzore, përfshirë aksesin në shkollim, kujdesin shëndetësor, mundësinë për të punuar dhe për të pasur qasje në drejtësi është e nevojshme të marrë vëmendjen përmes këtij Plani të dytë të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325, duke vënë theksin edhe tek qasje

invoative ndaj sigurisë e paqes, drejt një agjende që adreson sigurinë me një qasje më të butë ndaj sigurisë njerëzore, ekonomike apo edhe mjedisore. Masa që pasqyrojnë ndjeshmëri ndaj ndryshimeve klimatike, pasigurisë ushqimore, sëmundjeve pandemike si ajo e COVID-19, terrorizmit, krimi kibernetik, etj., që për nga natyra shtrihen përtej një shteti dhe destabilizojnë një vend po aq sa edhe cenimet apo pushtime territoriale, janë në vëmendje të këtij Plani Veprimi. Siguria më e lartë njerëzore dhe qasjet inovative janë përfshirë edhe si një sugjerim i posaçëm i shoqërisë civile në vend.

Bashkëpunimi brenda vendit, bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar është thelbësor për krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të favorshëm për gratë e vajzat si ndërtuese të paqes, mbrojtëse të të drejtave të njeriut dhe aktiviste të shoqërisë civile.¹⁴ Në hartimin dhe zbatimin e Planit të parë të Veprimit të vendit, shoqëria civile në vend si dhe aktorë të ndryshëm ndërkombëtarë luajtën një rol mjaft të rëndësishëm. Kjo qasje vijoi edhe në procesin e hartimit të këtij Plani të dytë Veprimi, i cili u hartua me mbështetjen e UN Women. Rol të rëndësishëm luajtën dhe Ambasada e Vendeve të Ulëta në vendin tonë, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, dhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në vendin tonë. Shoqëria Civile ishte pjesë e grupit që hartoi Planin e parë të Veprimit të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e Rezolutës 1324, pjesë zyrtarisht e grupeve të monitorimit të zbatimit të tij, si dhe aktore kyçe në përgatitjen e dy raporteve të monitorimit të hartuara dhe botuara të Planit të parë të Veprimit. Veçanërisht rol parësor ka luajtur Koalicioni ‘Gruaja Paqja Siguria’ dhe OSHC që kanë agjendën GPS në objekt të veprimtarisë së

¹² Shih f. 31, po aty.

¹³ Objektivat themelore të Planit të BE-së përfshijnë: pjesëmarrjen, duke synuar rritjen e pjesëmarrjes së grave në pozicione drejtuese dhe në të gjitha fushat që lidhen me paqen e sigurinë si dhe forcimin e lidhësive të grave në botë; integrimin gjinor në çdo politikë dhe realizimin e analizave për këtë aspekt; drejtimin përmes shembullit, që do të thotë përforsim i veprimeve të BE-së për zbatimin e agjendës GPS në nivel vendor, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar; parandalimin në nivel global, rajonal, kombëtar dhe lokal, të konflikteve përmes qasjes GPS, duke promovuar politika të tolerancës zero/përgjegjshmërisë së plotë për të ndihmuar në dhënien fund të mosndëshkimit dhe daljen e autorëve të krimeve të tilla para drejtësisë, si dhe duke përshtatur procese të drejtësisë tranzicionale që integrojnë plotësisht parimin e mosdiskriminimit dhe në Faqe | 298

përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut; mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave, si dhe rritjen e aksesit të tyre në drejtësi në nivel vendor, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar duke vënë theksin tek drejtësia restauruese, të drejtat e të mbijetuarve dhe viktimave, si dhe parandalimi i të gjitha formave të dhunës seksuale me bazë gjinore; dhe së fundi, lehtësimin dhe rimëkëmbjen e përshtatshme në situata konflikti dhe pas-konflikti duke plotësuar nevojat e grave dhe vajzave në kësi situatash.

¹⁴ Shih fjalimin e ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme, në Këshillin e Sigurisë, qershor 2022, në: <https://ambasadat.gov.al/united-nations/remarks-by-mfa-olta-xhacca-at-the-security-council-open-debate-on-keeping-the-promises-the-role-of-regional-organizations-in-implementing-women-peace-and-security-in-the-face-of-political-turmoil-a/>




tyre, e kryesisht Shoqata “Gruaja, Paqja, Siguria”. Shoqëria civile dhe veçanërisht Koalicioni ‘Gruaja Paqja Siguria’ ishte gjithashtu pjesëmarrëse aktive në procesin e hartimit të Planit të dytë të Veprimit. Kjo qasje pasqyron përfshirjen e shoqërisë civile si kontribuese madhore e politikave gjinore në vend dhe në zbatimin e agjendës GPS. Ajo respekton kërkesën e OKB-së që në çdo raport apo dokument që lidhet me Rezolutën 1325 shoqëria civile të jetë aktore e rëndësishme. Vijimi i kësaj qasje të hapur dhe angazhimi aktiv i shoqërisë civile garanton një Plan Veprimi edhe më të mirë dhe zbatim më të plotë të Rezolutës 1325.

1.1. Situata aktuale. Arritjet e deritanishme dhe sfidat e së ardhmes. Vizioni.

Qeveria Shqiptare, në zbatim të VKM-së nr. 524, datë 11.9.2018, “Për miratimin e planit të veprimit

për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, “Për gruan, paqen dhe sigurinë”, 2018–2020” hartoi dhe shpalli dy Raporte Monitorimi, përkatësisht në nëntor 2019 dhe nëntor 2020. Të dhënat tregojnë se ka pasur një angazhim më të mirë të grave dhe vajzave në fushat e mbrojtjes dhe policore dhe plotësimi i masave të Planit të veprimit për periudhën 2018–2020 reflektojnë vëmendjen e shtuar ndaj kësaj agjende, edhe pse vijon të mbetet njësoj e nevojshme marrja e masave për shtimin e numrit të grave dhe vajzave në këtë fushë. Shih fig. nr. 1.





Raportet e monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit 2018–2020, vunë në dukje nevojën për një adresim me seriozitet të masave nga ana e institucioneve përgjegjëse të ngarkuara me zbatimin e tij, nën bashkërendimin dhe koordinimin me përgjegjësi nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përmes takimeve apo kontakteve të vijueshme përgjatë zbatimit të Planit. Raportet e monitorimit nr. 1 dhe nr. 2, të zbatimit të Planit të Veprimit 2018–2020, përfshijnë një sërë rekomandimesh, duke vënë në plan të parë nevojën për vijimin e politikës për agjendën GPS si me rëndësi parësore për grupet shoqërore dhe angazhimin e tyre. Gjatë zbatimit të Planit të Veprimit 2018–2020, u vu re një bashkëpunim aktiv mes institucioneve shtetërore përgjegjëse dhe organizatave të shoqërisë civile, dhe partnerëve ndërkombëtarë. Kjo qasje rezultoi në një realizim në një shkallë të lartë të masave të Planit të Veprimit 2018–2020, në masën 82%.¹⁵ Gjithsesi, mungoi një sistem lehtësues i zbatimit dhe monitorimit të këtij Plani. Përdorimi gjatë hartimit dhe zbatimit të Planit të Dytë i sistemit IPSIS nën drejtimin e Agjencisë Shtetërore të Programin Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës vlerësohet si lehtësim i këtij procesi gjithëpërfshirës dhe kompleks. Qasja përgjatë zbatimit të Planit të Veprimit 2018–2020, synoi sa rritjen e numrit të grave dhe vajzave në sistem, aq edhe pasjen e një sistemi që reflekton në tërësi aspektet e organizimit dhe funksionimit me ndjeshmëri gjinore. Edhe pse të dhënat flasin në tërësi për një rritje të pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në forcat ushtarake, policore, apo edhe në sektorë të tjerë, numri i grave dhe vajzave në drejtim në sektorët e ruajtjes së sigurisë dhe paqes ende mbetet i ulët. Shih fig. nr. 1. U vunë re vështirësi të identifikimit të mbështetjes nga buxheti i shtetit, apo edhe nga burime jo buxhetore zbatimin e Planit të Veprimit 2018–2020. Aktivitetet për agjendën GPS gjatë zbatimit të Planit të Veprimit 2018–2020, u realizuan në të gjithë vendin duke kontribuar kështu në lokalizimin e agjendës GPS në Shqipëri, por në një numër të kufizuar. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë angazhuar në një numër të kufizuar aktiviteteve për agjendën GPS, madje disa njësi të vetëqeverisjes vendore nuk e njohin Rezolutën

1325. Edhe ndërveprimi rajonal për agjendën GPS u pa i nevojshëm të forcohet. Media dhe institucionet e arsimit të lartë u angazhuan në veprimtari të ndërlidhura me zbatimin e agjendës GPS, por jo aktivisht.¹⁶

Raportet e monitorimit nr. 1 dhe nr. 2, të zbatimit të Planit të Veprimit 2018–2020, përfshijnë një sërë rekomandimesh, duke vënë në plan të parë nevojën për vijimin e politikës për agjendën GPS si me rëndësi parësore për grupet shoqërore dhe angazhimin e tyre. Një tjetër rekomandim është që çështjet objekt i politikës së qëllim të për zbatimin e Rezolutës 1325 të zgjerohen me zhvillime të aktualitetit, përfshirë edhe ngjarje si ajo e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19 apo katastrofat natyrore të lidhura me situatën konkrete që përjeton vendi në çështjet gjinore në këndvështrimin e sigurisë dhe paqes. Masat rekomandohet të vijojnë në kuadër të shtyllave të Rezolutës 1325, si përfshirja e grave në nivele vendimmarrëse, pavarësisht trendit të rritjes në këtë drejtim.

Me po aq rëndësi, sugjerohet që institucionet përgjegjëse të Planit të Veprimit të zgjerohen me qëllim që ky plan të mos jetë vetëm ndërinstitucional, por të jetë gjithëpërfshirës, përfshirë këtu edhe struktura të tjera me rëndësi të shoqërisë si Institucionet e Arsimit të Lartë, duke ndikuar në formësimin e kapaciteteve për agjendën GPS mes të rinjve e të rejave, apo edhe median e cila kërkohet të luajë një rol më aktiv për përparimin e agjendës GPS në vendin tonë. Institucionet përgjegjëse të zbatimit të politikës për këtë çështje në vend rekomandohet të ndërveprojnë më aktivisht me median në këtë drejtim, sikurse edhe vetë media të vetëangazhohet aktivisht për çështjet gjinore në fushën e sigurisë dhe paqes.

Rekomandimet përfshijnë edhe masa të mëtejshme për lokalizimin e agjendës GPS duke sugjeruar që Këshillat e Sigurisë në nivel vendor të përfshijnë në planet e tyre të veprimit masa dhe objektiva në kuadër të zbatimit të Rezolutës 1325, forcimin e kapaciteteve të nëpunësve gjinorë në nivel vendor që të nxisin përfshirjen e njësisë vendore në aktivitete për përfshirjen e grave dhe vajzave në nivel vendor përmes këshillave të lagjeve apo organeve të tjera të krijuara në nivel vendor për

¹⁵ Shih Raporti i Monitorimit nr 2, tetor 2019–nëntor 2020, “Për zbatimin e Planit Ndërinstitucional të Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Faqe | 300

Kombeve të Bashkuara, “Për gruan, paqen dhe sigurinë”, 2018–2020”, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

¹⁶ Po aty.



nxitjen e paqes dhe mirëkuptimit në komunitet si dhe politika me ndjeshmëri gjinore.

Plani i ri i Veprimtimit rekomandohet të përfshijë tregues realistë dhe të posaçëm sasiorë dhe cilësor për matjen e përparimit në kuadër të politikës GPS në vend. Plani i Veprimtimit të vijojë të jetë i kostuar dhe buxhetuar dhe institucionet përgjegjëse të marrin masa për të identifikuar dhe mbledhur të dhëna për mbështetjen buxhetore dhe jo-buxhetore për zbatimin e masave për të cilat janë përgjegjës. Ndër të tjera të tilla rekomandime kërkojnë edhe që koha e rishikimeve të planit të ndërlidhet me kohën e përcaktimit/rishikimit të buxhetit nga ana e qeverisë dhe të marrjes në konsideratë të Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor, duke angazhuar edhe MFE-në, si ministri përgjegjës për financat në vend, në procesin e hartimit, zbatimit, monitorimit dhe raportimit.

Gratë përbëjnë 50,1 % të popullsisë nga 2.845.955 persona në vitin 2021¹⁷ dhe angazhimi për krijimin e një mjedisi barazie për gjysmën e popullsisë është domosdoshmëri. Në tërësi, indeksi i pabarazisë gjinore, në vitin 2021 rezultoi 0,09 nga 0,06 që ishte në vitin 2020.¹⁸ Gjatë vitit 2020, për herë të parë Shqipëria iu bashkua Indeksit të Barazisë Gjinore të BE-së, ku miratimi i Planit ndërinstitucional i veprimtimit për zbatimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara 1325 “Për Gratë, Paqen, Sigurinë, 2018–2020” përmendet shprehimisht në radhën e politikave të miratuara për arritjen e barazisë. Sipas këtij indeksi, “. . . fusha e pushtetit shënon 60.9 dhe e rendit Republikën e Shqipërisë në vendin e 6të në krabasim me pjesën tjetër të vendeve që raportojnë mbi Indeksit të Barazisë Gjinore”. Një tregues i tillë është pozitiv, edhe pse shifrat për

fushat e tjera nuk janë po kaq pozitive.¹⁹ Fusha e pushtetit, sipas Indeksit të Barazisë Gjinore 2020, është fusha ku Shqipëria shënon një rezultat më të mirë se mesatarja e BE-28 me 60,9 pikë. Kjo vjen për shkak të rezultateve më të mira se sa mesatarja e BE-28 në nënfushat e pushtetit politik dhe ekonomik, ndërkohë që sa i përket pushtetit social, rezultati i Shqipërisë është më i ulët.²⁰

Ministria e Mbrojtjes (MM) deri në vitin 2020 u drejtua nga një grua²¹, detyrë e mbajtur nga një grua që prej vitit 2013 në Shqipëri.²² Kuvendi i Shqipërisë drejtohet nga një grua aktualisht dhe zëvendëskryetare e Kuvendit është po ashtu një grua.²³ 75% e kabinetit qeveritar aktualisht përbëhet nga gra (12 nga 16 gjithsej, ku përfshihen Kryeministri, ministrat dhe Kryenegociatorja për Integrimin Evropian). Zëvendëskryeministria dhe Kryenegociatorja e vendit për integrimin evropian janë gra.²⁴ Ky tregues e ka vendosur Shqipërinë ndër vendet me përfaqësim më të lartë të përfshirjes së grave në qeveri ndër vendet në botë. Përmirësimi i ndjeshëm i pjesëmarrjes së grave anëtare në Parlamentin e Shqipërisë u bë i mundur pas përfshirjes së kuotës 30 % në ndryshimet e kodit elektoral në vitin 2008, dhe si rezultat është vënë re një tendencë në rritje e pjesëmarrjes së grave e vazhduar në zgjedhjet parlamentare, me 35,7 % të deputetëve gra në vitin 2021. Drejtimi i komisioneve parlamentare aktualisht bëhet në 50% të rasteve nga gra. Ndër tetë komisionet parlamentare, pjesëmarrja më e madhe e grave shihet në “Komisionin për punën, çështjet sociale dhe shëndetësinë” dhe “Komisionin për edukimin dhe mjetet e informimit publik”, përkatësisht 61,9 % dhe 57,9 %.²⁵ Në kuadër të kësaj qasje, në 2020 për herë të parë një

¹⁷ INSTAT, Burra dhe gra 2020, f. 20. Shih në: <http://www.instat.gov.al/media/7376/burra-dhe-gra-2020.pdf>

¹⁸ Shih INSTAT, Gratë dhe Burrat në Shqipëri, 2021. Shih në <http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/barazia-gjinore/publikimet/2022/grat%C3%AB-dhe-burrat-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-2021/> (aksesuar në janar 2022)

¹⁹ Indeksi i Barazisë Gjinore për Republikën e Shqipërisë 2020, janar 2020. Shih në: https://eurogender.eige.europa.eu/system/files/events-files/gender_equality_index_for_the_republic_of_albania_2020_alb.pdf

²⁰ http://www.instat.gov.al/media/6657/gender_equality_index_for_the_republic_of_albania_2020_alb.pdf f. 21.

²¹ <https://www.mod.gov.al/index.php/ministria/ministri>

²² Ministret ishin përkatësisht znj. Mimi Kodheli dhe znj. Olta Xhaçka. Shih njoftimin për emërimin e ministres së parë grua, në:

<https://www.facebook.com/MinistriaMbrojtjes/videos/marrja-e-detyr%C3%ABs-nga-ministria-e-mbrojtjes-znj-mimi-kodheli/592779867452215/>

²³ Deputetja, znj. Lindita Nikolla, është kryetare e Kuvendit, dhe deputetja, znj. Ermonela Felaj zëvendëskryetare e Kuvendit. Shih në:

<https://www.parlament.al/>

²⁴ Shih përbërjen në: <https://kryeministria.al/qeveria/>.

²⁵ <http://www.instat.gov.al/media/11027/burra-dhe-gra-2022.pdf> f. 106



deputete shqiptare u emërua në postin e zëvendës-presidentes së Asamblesë Parlamentare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.²⁶ Në nivel vendor janë vetëm 13% e kryetarëve të bashkive dhe 44% e këshilltarëve në Këshillat në nivel vendor gra.²⁷ Gjykata Kushtetuese në vend drejtohet që prej vitit 2019 nga një grua.²⁸ Në Gjykatën e Lartë janë 15.4% e anëtarëve gra, ndërsa në gjykatat e apelit janë 39.7% gra dhe në ato administrative janë 66,7% gjyqtare gra.²⁹

Përqindja e grave që punojnë në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme aktualisht është 56.5% e punonjësve në tërësi të saj. Në shërbimin diplomatik, në 2021 INSTAT-i raporton se ishin 30,8% Ambasadore, 66,7% Ministër Fuqplotë, 46,2% Ministër Këshilltar.³⁰ MEPJ raporton se aktualisht ka 13 Këshilltare, 21 Sekretare të Para, 24 Sekretare të Dyta, 1 Sekretare të Treta, dhe 1 Atashe, ndërkohë që vendi ynë nuk ka asnjë Atashe Ushtarake në Përfaqësitë tona Diplomatike aktualisht.³¹ Numri i grave në Misionin e RSh-së pranë Këshillit të Sigurimit është 10. Edhe pse ka një ndërgjegjësim të pjesëmarrjes dhe rëndësisë së kontributit të grave në fushën e diplomacisë, ndihet nevoja e përforsimit të kësaj qasje por edhe e zhvillimit të të dhënave administrative si dhe e statistikave të thelluara dhe të qëndrueshme në këtë fushë. Po me aq rëndësi është forcimi i kapacitetit të grave në fushën e diplomacisë për çështjet gjinore në tërësi dhe agjendën GPS në veçanti.

Puna për zbatimin e Planit të Veprimit Kombëtar e Planit të Veprimit të Ministrisë së Mbrojtjes për zbatimin e Rezolutës 1325 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për Gruan, Paqen e Sigurinë” ka bërë të mundur që gratë ushtarake të zënë sot rreth 14.76% të numrit të përgjithshëm të personelit ushtarak aktiv me objektiv e synim për të arritur 15% të efektivave të

jenë gra. INSTAT-i raporton se në vitin 2021 gratë zënë 20,1% të personelit gjithsej në ushtri.³² Miratimi në vitin 2019 nga Ministri i Mbrojtjes i dokumentit “Politikat kundër ngacmimeve dhe ngacimit seksual në ambientet e punës”, garanton më shumë siguri, përkujdesje e mbrojtje nga strukturat shtetërore për aspektet gjinore.³³ Aktualisht, që prej janarit 2018, një Gjeneralmajore grua është Zëvendësshefe e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Gjithsesi, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Komandantët e Forcës Ajrore, Detare dhe tokësore janë burra.³⁴ Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në ushtri edhe pse ka vëmendje ndaj përforsimit të politikave për një rekrutim eficient të ndjeshëm ndaj kategorive të ndryshme, nuk përmend në mënyrë të drejtpërdrejtë grupimet gjinore dhe nuk adreson mospërfaqësimin e grave dhe vajzave në ushtri me qëllim rritjen e numrit të tyre si dhe përshtatjen e politikave të ndjeshme gjinore për përfshirjen dhe karrierën në ushtri.³⁵ është hequr kërkesa për pjesëmarrje në të paktën 15% të grave/vajzave ushtarake, dhe kjo nuk ka ndihmuar rritjen e pjesëmarrjes së grave ushtarake në ushtri. Ligji nr. 121/2015, datë 12.11.2015, “Për miratimin e Planit Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2016–2027” po ashtu nuk përdor një gjuhë të ndjeshme gjinore. Si një shembull, edhe pse përmirësimi i sistemit të të dhënave të personelit (*data base*) është një ndër angazhimet sipas këtij ligji, nuk ka një parashikim për të dhëna të ndjeshme gjinore në personelin ushtarak.³⁶

Aktualisht, Policia e Shtetit reflekton një progres të rëndësishëm lidhur me përfshirjen e grave dhe vajzave në strukturat e saj edhe në pozicione të larta, si dhe forcimin e kapaciteteve të tyre. Në vitin 2021, raportohet se 14.3% e punonjësve në Policinë e Shtetit janë gra, me 1562 punonjëse gra nga 10.854

²⁶ Deputetja, znj. Mimi Kodheli, u emërua zëvendës-presidente e Asamblesë Parlamentare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut. Shih në: <https://www.nato-pa.int/content/vice-presidents-and-treasurer>

²⁷ <http://www.instat.gov.al/media/11027/burra-dhe-gra-2022.pdf> f. 116.

²⁸ Shih në: <https://www.gjk.gov.al/>

²⁹ <http://www.instat.gov.al/media/11027/burra-dhe-gra-2022.pdf> f. 115.

³⁰ Shih <http://www.instat.gov.al/media/11027/burra-dhe-gra-2022.pdf> f. 113.

³¹ Informacioni i përcjellë nga MEPJ për vitin 2022.

³² Shih <http://www.instat.gov.al/media/11027/burra-dhe-gra-2022.pdf> f. 114.

³³ 110 Ushtri Shqiptare, Mbrojtja, Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes. Viti i 90-të i botimit - Speciale, f. 14. Shih në: <https://www.mod.gov.al/images/mbrojta/pdf/2022/mbrojta-speciale-dhjetor1.pdf>

³⁴ Shih në: <https://www.aaf.mil.al/kush-eshte>

³⁵ Shih në: <https://www.mod.gov.al/images/PDF/2020/Strategjia-e-Menaxhimit-2020-2024.pdf>

³⁶ Shih në: <https://www.mod.gov.al/pdf/PAZHFA-2016-2027.pdf>



punonjës në total. INSTAT-i konfirmon se në strukturën e policisë, numri i punonjëseve gra rritet me uljen e nivelit të gradave. Me gradë policore raportohet se janë 9.8% gra dhe përqindja më e lartë është për gradën Inspektor me 43,5 %, ndërsa gra janë 0% drejtuese madhore, 0% drejtuese e lartë, 10.4% drejtuese dhe 3% drejtuese e parë.³⁷ Të dhënat administrative të raportuara nga Policia e Shtetit për vitin 2022 tregojnë se gra janë 1 drejtues i parë, 11 drejtues, 29 k/komisare, 59 komisare, 169 nënkomisare, 656 inspektore dhe 577 punonjëse civile. Policia e Shtetit ka miratuar një Kod Etike, si dhe një manual për etikën dhe integritetin policor, i cili adreson ndërtimin dhe konsolidimin e rrugës drejt kapaciteteve dhe praktikave etike dhe me integritet në Policinë e Shtetit. Në kuadër të punës së saj, ajo ka miratuar një Procedurë Standarde të Ngacmimit Seksual në vendin e punës, të miratuar me urdhrin nr. 96, datë 7.7.2020. Në kuadër të njohjes së kësaj procedure, me mbështetjen e Programit të Barazisë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje, UN Women, janë organizuar disa aktivitete trajnuese me qëllim njohjen dhe zbatimin e dokumentit të politikave dhe procedurave kundër ngacmimit, me punonjës të strukturave të policisë të Drejtorive Vendore të Policisë dhe Drejtorive Rajonale të Kufirit dhe Migracionit, me pjesëmarrje të të gjitha niveleve të gradave dhe punonjës civil. Të gjithë drejtuesit e lartë të Policisë së Shtetit, përfshirë dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, janë trajnuar gjatë 2022, në lidhje me ngacmimet seksuale në vendin e punës. Në zbatim të urdhrin nr. 86, datë 24.1.2020, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për diversitetin, diskriminimin dhe barazinë gjinore, kanë vijuar inspektimet si dhe fushata sensibilizuese në qarqet Gjirokastrë, Vlorë, Fier, Korçë, me synim vlerësimin dhe monitorimin e zbatimit të Politikës për Diversitetin, barazinë gjinore dhe ngacmimin seksual. Me mbështetjen e UN Women, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T’i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri”, financuar nga Qeveria e Suedisë dhe zbatohet nga UN Women, UNDP dhe UNFPA si dhe të monitorimit të situatës lidhur me nivelin e kuptimit dhe zbatimit, në muajin Shkurt-Mars 2020, janë realizuar tryeza diskutimi dhe reflektimi “5 vjet zbatim i urdhrin të Drejtorit të

Përgjithshëm për “Politikat dhe procedurat e trajtimit të rasteve të ngacmimit dhe ngacmimit seksual në Policinë e Shtetit”. Policia e Shtetit është njëkohësisht organizata e parë që realizon një politikë të tillë duke inkurajuar edhe struktura të tjera shtetërore. Gjithashtu, mbi 500 punonjës të Policisë së Shtetit, kryesisht gra e vajza u pyetën përmes një pyetësori *online* për politikën e barazisë gjinore brenda strukturave të policisë si dhe për ofrimin e një sërë trajnimesh. Sektori i Hetimit Disiplinor të Policisë ka trajtuar 17 raste që lidhen me këtë politikë duke dhënë masa të rënda disiplinore si dhe janë trajtuar jo formalisht disa raste. Policia e Shtetit ka miratuar “Planin e Veprimit mbi zhvillimin e Diversitetit, në Policinë e Shtetit”, ka prezantuar “Deklaratën e Diversitetit” si dhe hartuar dhe publikuar “Manualin për Barazinë dhe Diversitetin” i përgatitur nën kujdesin e Prezencës së OSBE-së dhe Un Women në Shqipëri. Gjithashtu, janë realizuar mbi 100 takime me strukturat vendore të Policisë dhe me Institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të drejtat e njeriut për komunitetin LGBTI, kryesisht për krimet e urrejtjes.

Shqipëria është pjesë aktive e nismave rajonale për adresimin e sigurisë. Ajo është bërë pjesë e Rrjetit të Mesdheut të Grave Ndërmjetëse, ku ka theksuar angazhimin maksimal dhe gjithëpërfshirës si parakusht për sigurinë në vend. Shqipëria është përfshirë në angazhimet e OSBE-së për të ngritur dy rrjete rajonale në Evropën Juglindore dhe Azinë Qendrore për gra profesioniste në fushën e parandalimit dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm që çojnë në terrorizëm, në kuadër të projektit për nxitjen e zbatimit të rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së “Gratë, paqja dhe siguria” në rajonin e OSBE-së.

Vendi ynë vijoi të përqafojë aktet ndërkombëtare për luftën kundër dhunës e ngacmimit duke ratifikuar në vitin 2022 edhe Konventën 190 “Konventa për Dhunën dhe Ngacmimin” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Bërija pjesë e legjislacionit të brendshëm të standardeve që vendos kjo Konventë e vendos politikën e brendshme para nevojës për të ndërmarrë masa konkrete për të

³⁷ Shih <http://www.instat.gov.al/media/11027/burra-dhe-gra-2022.pdf> f. 113.



garantuar të drejtën për barazi dhe mosdiskriminim në punësim dhe profesion.³⁸

Në vijim të masave konkrete dhe zbatimit të politikave konkrete me bazë gjinore, bazuar në fotografimin e situatës aktuale në Shqipëri dhe identifikimin e problematikave që has vendi ynë në zbatimin e plotë të rekomandimeve në kuadër të Rezolutës 1325, është i nevojshëm miratimi i një plani të ri veprimi në kuadër të Rezolutës 1325 të KSKB-së. Asnjë arritje, sado e madhe të jetë, nuk është e pakthyeshme, për më tepër që shifrat tregojnë se arritjet nuk janë të konsiderueshme. Qëllimi i këtij Planit të ri Veprimi është vijimi i politikave të zgjuara të përfshirjes së grave në fushën e sigurisë, të veprimtarisë së jetës që kanë të bëjnë me paqen dhe sigurinë dhe adresimit të çështjeve me të cilat përballen ato në kësi situatash, apo pas tyre. Ky Plan i dytë Veprimi synon të mundësojë një zbatimin edhe më të mirë të Rezolutës 1325 në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, duke reflektuar edhe mbi rekomandimet e raporteve të monitorimit të Planit të Veprimit 2018–2020. Kjo qasje është në harmoni me kërkesat e BE-së për agjendën GPS për të luftuar dhunën kundër grave dhe promovimin e pjesëmarrjes së grave në ndërtimin e paqes.

Ndërsa agjenda GPS është përqaftuar nga vendi ynë dhe vijon të jetë në vëmendje të politikës së vendit, aktualiteti ka sjellë sfida të reja. Sfidat si ajo e COVID-19, katastrofa natyrore apo kriza energjetike e ekonomike, sfida sociale si lëvizje demografike për shkaqe ekonomike apo politike, apo edhe qasje të reja si ajo e përballjes hapur me dhunën seksuale me bazë gjinore, etj., janë të gjitha aspekte që ndërlidhen natyrshëm me paqen e sigurinë. Një studim i OSBE-së për Planet e veprimit në zbatim të Rezolutës 1325 në rajonin e OSBE-së, ndërkohë që ka vlerësuar Planin e Veprimit të Republikës së Shqipërisë, 2018–2020, ka vënë në pah nevojën për të përfshirë në të çështje aktuale, si p.sh. çështje që lidhen me armët e vogla

dhe të lehta, ekstremizmin e dhunshëm, migrimin ose katastrofat natyrore.³⁹ Të dhënat në vend tregojnë se të dëmtuar sipas gjinisë dhe veprave penale të trafikimit, dhunës në familje dhe krime seksuale janë shumë më tepër gra se sa burra dhe shifrat rriten më shumë ndaj grave se burrave. Për vitin 2021, të dëmtuar për krime seksuale janë 88.4% gra dhe vetëm 11.6% burra, shifër e cila ka ardhur në rritje nga vitit në vit për të dëmtuarat e rritura dhe të mitura gra e vajza.⁴⁰ Po ashtu, klima dhe fatkeqësitë e shkaktuara nga njeriu po shkatërrojnë planetin dhe po ndikojnë në jetën e grave dhe vajzave në mënyrë jo proporcionale.⁴¹ Planit i ri zgjeron fushën e vet të veprimit edhe në këtë këndvështrim, kjo edhe në harmoni me Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin të Riskut nga Fatkeqësitë, 2023–2030, në të cilën përfshihet si një prej objektivave ai i rritjes së ndërgjegjësimit, njohurive kombëtare dhe lehtësimit të shkëmbimit të informacionit për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile dhe të krijohen komunitete ripërtëritëse dhe të qëndrueshme me vëmendje, ndër të tjera, edhe tek barazia gjinore.⁴² Duke vlerësuar se kuptimi i ‘paqes dhe sigurisë’ nuk është i lidhur vetëm me sigurinë dhe rendin, referuar të tilla sfidave që sjellin pasiguri, konflikte dhe cenim të paqes në shoqëri, zgjerimi i fushës së veprimit të Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 është nevojë e natyrshme. Ndeshmëria më e lartë gjinore në trajtimin e rasteve të fatkeqësive gjinore, gjuha e ndjeshme gjinore, të dhëna të diferencuara sipas gjinisë, indikatorë të ndjeshëm gjinorë në vlerësimin e shkallës së riskut apo edhe të ndikimit të ndërhyrjeve në rast fatkeqësisht dhe miratimin e planeve për menaxhimin e riskut me qasje gjinore janë masa me rëndësi për mundësimin e një mjedisi të ndjeshëm në raste fatkeqësish apo katastrofash natyrore ndaj grave e vajzave.

Planit i Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325, 2023–2027, bazohet në vizionin e qeverisë shqiptare që i konsideron gratë si pjesë dhe kontribuuese të

³⁸ Shih *ligjin nr. 13/2022, “Për ratifikimin e Konventës 190 ‘Komventa për Dhunën dhe Ngacimin’ të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, 1986”*.

³⁹ <https://www.osce.org/files/f/documents/3/4/444577.pdf> (aksesuar në janar 2022)

⁴⁰ Shih <http://www.instat.gov.al/media/11027/burra-dhe-gra-2022.pdf> f. 97.

⁴¹ UN Women, *Progress on the sustainable development goals the gender snapshot 2022*,

https://www.unwomen.org/sites/default/files/2022-09/Progress-on-the-sustainable-development-goals-the-gender-snapshot-2022-en_0.pdf

⁴² Shih f. 31, në:

https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_509_Strategjia%20Komb%C3%ABtare%20p%C3%ABr%20Zvog%C3%ABlimin%20e%20Riskut%20nga%20Fatkeq%C3%ABsit%C3%AB%202023-2030_31.08.2022_Final%20Draft.pdf



zhvillimit të qëndrueshëm. Një plan i tillë është një politikë që njëkohësisht ka një mision, atë të luftës ndaj dasive shoqërore me bazë gjinore në çdo sektor. Ai vë në pah politikën në kuadër të agjendës GPS dhe mundëson raportimin e fokusuar në kuadër të raporteve ndërkombëtare.

1.2. Ndërlidhja e Planit të Veprimit me kuadrin politik në fuqi

Ky Plan Veprimi është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila sanksionon në nenin 18, paragrafi i dytë të saj parimin e barazisë ndër të drejtat dhe liritë themelore në vend. Po ashtu, Plani i Veprimit është në përputhje me politikën dhe aktet ligjore dhe nënligjore të miratuara nga Republika e Shqipërisë për fuqizimin e grave e vajzave, dhe arritjen e barazisë gjinore, apo ku është integruar perspektiva gjinore, si:

- Ligj nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili përfshin parimin e mosdiskriminimit, ndalimin e ngacmimit moral dhe seksual dhe sanksione përkatëse dhe të çdo veprimi që përbën shqetësim seksual,⁴³

- Ligj nr. 9970 datë 24.7.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri”, i cili parashikon ndalimin e pabarazisë për shkak të përkatësisë gjinore në çdo fushë, sigurimin e integritetit gjinor në të gjitha fushat, sidomos në ato politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, si në nivel qendror ashtu edhe vendor, mbledhja e detyrueshme e statistikave gjinore si dhe edukimin e barazisë gjinore.⁴⁴

- Ligj nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i cili parashikoi me ndryshimet e vitit 2016 konceptin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në menaxhimin e sistemit buxhetor,⁴⁵ ligji nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” që gjithashtu ka përfshirë këtë qasje,⁴⁶ si dhe VKM-ja nr. 465, datë 16.7.2012, “Për integritetin gjinor në programin buxhetor afatmesëm”, e cila parashikon planifikimin të objektivave të matshme gjinore në programet buxhetore të institucioneve qendrore,⁴⁷

- Ligj nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i

cili përfshin respektimin e barazisë gjinore duke vendosur edhe kuota në organet e zgjedhura në nivel qendror e vendor, përfshirë edhe kuotën për gjininë e nënpërfaqësuar në jo më pak se 30 për qind të përbërjes së Kuvendit të Shqipërisë dhe të organeve të njëjësive bazë të vetëqeverisjes vendore,⁴⁸

- Ligj nr. 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, që përfshin parimin e mosdiskriminimit ndër të tjera edhe për shkak të gjinisë,

- Ligj nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku në pikën 3, të nenit 6, parashikohet se: “Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënëseve/nxënësve dhe punonjëseve/punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t’u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral”,

- Ligj nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Shqipëri”, i ndryshuar, në nenin 32, parashikon që shërbimet e mediave audio dhe/ose audiovizive nuk duhet të transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo forme tjetër diskriminimi,⁴⁹

- Ligj nr. 108/2014, “Për policinë e shtetit”, i ndryshuar, që ndër parimet themelore të organizimit e funksionimit të Policisë së Shtetit përfshin atë të mosdiskriminimit,⁵⁰

- Ligj nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, i cili funksione të bashkive në fushën e sigurisë publike, mjedisit, infrastrukturës, shërbimeve publike, mbështetjes financiare, etj. duke garantuar akses të balancuar gjinor, si dhe duke respektuar ligjin për barazinë gjinore në komitete, borde ose komisione që krijohen në nivel vendor, apo edhe në emërimet në nivel vendor,⁵¹

- Ligj nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 17, përcakton qartë parimin e barazisë, pa dallime të çfarëdolloj forme duke plotësuar dhe mosdiskriminimin për shkak të gjinisë, identitetit gjinor dhe orientimit seksual,⁵²

⁴³ Shih në: <http://qzb.gov.al/eli/ligj/1995/07/12/7961>

⁴⁴ Shih në: <http://qzb.gov.al/eli/ligj/2008/07/24/9970>

⁴⁵ Shih në: <http://qzb.gov.al/eli/ligj/2008/06/26/9936>

⁴⁶ Shih në: <http://qzb.gov.al/eli/ligj/2017/04/27/68-2017>

⁴⁷ Shih në: <http://qzb.gov.al/eli/vendim/2012/07/18/465>

⁴⁸ Shih në: <http://qzb.gov.al/eli/ligj/2008/12/29/10019>

⁴⁹ Shih në: <http://qzb.gov.al/eli/ligj/2013/03/04/97-2013>

⁵⁰ Shih në: <http://qzb.gov.al/eli/ligj/2014/07/31/108>

⁵¹ Shih në: <http://qzb.gov.al/eli/ligj/2015/12/17/139>

⁵² Shih në: <http://qzb.gov.al/eli/ligj/2015/04/30/44>



- Ligj nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, synon parandalimin dhe zvogëlimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje,⁵³

- Udhëzim nr. 816, datë 27.11.2018, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale”,⁵⁴

- Udhëzim i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 9, datë 17.6.2020, “Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre”,

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 327, datë 2.6.2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimit të viktimave të dhunës”,

- Ligj nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, që përfshin parimin e mosdiskriminimit edhe për shkaqe gjinie në ofrimin e shërbimeve,

- Ligj nr. 65/2016, “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”, që synon edhe punësimin e personave të pafavorizuar në tregun e punës, si gratë viktime të dhunës dhe trafikimit, etj.,

- Ligj nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon vendosjen e një koordinatori/koordinatoreje për marrëdhëniet me publikun në çdo prokurori,

- Ligj nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, i cili përfshin mosdiskriminimin në parimet e përgjithshme të ligjit,

- Ligj nr. 37/2017, “Kodi i drejtësisë penale për të mitur”, që garanton mbrojtjen e fëmijëve nga dhe në kuadër të një vepre penale,

- Ligj nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, që ndër të tjera garanton ndihmë juridike falas për kategori të veçanta viktime të dhunës në familje, abuzimit seksual, trafikimit të qenieve njerëzore, të mitur/mitura në konflikt me ligjin, etj.,

- Ligj nr. 75/2019, “Për rininë”, i cili parashikon edhe mbështetjen dhe fuqizimin e të rejave/rinjve edhe në kuadër të akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacionit në fuqi,⁵⁵

- Ligj nr. 35/2020, “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’”, i ndryshuar, i cili përfshin ndër veprat penale për dhunën në familje dhe atë ndaj grave,

- Ligj nr. 62/2022, “Për regjistrin kombëtar të të dënuarve për krime seksuale”, i cili synon parandalimin e ngacmimit, dhunës, abuzimit apo shfrytëzimit seksual⁵⁶,

- Ligji nr. 79/2020, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”⁵⁷.

- Ligj nr. 13/2022, “Për ratifikimin e konventës 190 ‘Konventa për dhunën dhe ngacmimin’ të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, 1986”⁵⁸

- Ligj nr. 79/2021, “Për të huajt” i cili garanton mbrojtje për viktimat e trafikimit.⁵⁹

Plani i Veprimit është në përputhje me aktet politike të miratuara dhe në fuqi në vend, si:

- Projekt Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim,⁶⁰

- Strategjia e 4-rt Kombëtare “Për barazinë gjinore dhe të planit të veprimit 2021–2030” e miratuar me VKM-në nr. 400, datë 30.6.2021,⁶¹

- VKM-ja nr. 670, datë 10.11.2021, për një shtesë në vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë kundër

⁵³ Shih në: <http://qzb.gov.al/eli/ligji/2006/12/18/9669>

⁵⁴ Shih në:

<http://qzb.gov.al/eli/udhezim/2018/11/27/816>

⁵⁵ Shih në: <http://qzb.gov.al/eli/ligji/2019/11/04/75>

⁵⁶ Shih në: <http://qzb.gov.al/eli/ligji/2022/07/21/62>

⁵⁷ Shin në: <https://qzb.gov.al/eli/dekret/2020/07/16/>

⁵⁸ Shih në: <http://qzb.gov.al/eli/ligji/2022/02/03/13>

⁵⁹ Shih në: <http://qzb.gov.al/eli/ligji/2021/06/24/79>

⁶⁰ Projektstrategjia përfshin ndër objektivat në kuadër të forcimit të të drejtave të njeriut edhe “Mbrojtja më e mirë e Faqe | 306

grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave dhe djemve, nga të gjithë grupet nga të gjitha format e praktikave të dëmshme, seksizmit, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, përmes përmirësimit të legjislacionit, zbatimit efektiv të tij, ofrimit të shërbimeve mbështetëse të specializuara për personat e dënuar, ndëshkëmin e dhunuesve dhe vënien në funksionim të programeve rehabilituese”. Shih në:

<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/538>

⁶¹ Shih në: <http://qzb.gov.al/eli/vendim/2021/06/30/400>



krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, 2021–2027 dhe planin e veprimit 2021–2022”,⁶²

- VKM-ja nr. 1139, datë 24.12.2020, “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të sigurisë në komunitet 2021–2026 dhe të planit të veprimit 2021–2023”,⁶³

- VKM-ja nr. 1140, datë 24.12.2020, “Për miratimin e strategjisë kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, 2021–2027, dhe planin e veprimit 2021–2022”,⁶⁴

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 50, datë 6.2.2019, për miratimin e strategjisë për kontrollin e armëve të vogla, të lehta, municioneve dhe eksplozivëve 2019–2024 dhe të planit të veprimit 2019–2021,⁶⁵

- VKM-ja nr. 930, datë 18.11.2015, “Strategjia kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe Plani i Veprimit”,⁶⁶

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 88, datë 22.2.2023, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim evropian, 2022–2030”,⁶⁷

- VKM-ja nr. 659, datë 10.10.2019, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për punësim dhe aftësi, 2019–2022 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, i ndryshuar,⁶⁸

- Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, 2020–2023 dhe të Planit të Veprimit në zbatim të saj,⁶⁹

- VKM-ja nr. 864, datë 24.12.2019, “Për miratimin e dokumentit politik kombëtar për moshimin, 2020–2024 dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij”,⁷⁰

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 210, datë 6.4.2022, Strategjia e Shëndetësisë 2021–2030,⁷¹

- Plani Kombëtar i Veprimit për mbështetjen e gruas sipërmarrëse (2014–2020),⁷²

- VKM-ja nr. 692, datë 26.10.2022, “Për miratimin e strategjisë kombëtare të rinisë dhe planit të veprimit 2022–2029”,⁷³

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 701, datë 18.11.2021, “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e romëve dhe egjiptianëve, 2021–2027”, që përfshin në objektivin 5 arritjen e barazisë gjinore,⁷⁴

- Plani Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI (2021–2027),⁷⁵

- Programi i Reformës Ekonomike 2022–2024, me 15 masa reforme përfshirë punësimin dhe përfshirjen sociale, trajnimet dhe aftësimin profesional, etj.,⁷⁶

- Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2019–2022, që parashikon buxhetimin e përgjigjshëm gjinor,⁷⁷

- Nënshkrimi i Kartës Evropiane për Barazi të Burrave dhe Grave në Jetën Vendore nga bashkitë,⁷⁸

- Plane Vendore të Veprimit për Barazinë Gjinore, në përputhje me zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi të Burrave dhe Grave në Jetën Vendore.⁷⁹

Në kuadër të këtyre akteve janë ngritur struktura të posaçme institucionale, përfshirë:

- Këshillat e sigurisë në njësitë e vetëqeverisjes vendore,

- Shërbimi i këshillimit për djemtë dhe burrat në disa bashki të vendit,

- Strehëzat emergjente në disa bashki të vendit,

- Linja Kombëtare e Këshillimit për viktimat e dhunës në familje,

- Zyra e Koordinimit kundër Dhunës në Familje pranë Ministrisë së Drejtësisë,

- Qendra e parë e trajtimit të krizës së sulmeve seksuale “Lilium”,

- Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH),

- Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, ASPA, e cila zbaton një program të posaçëm trajnimi “Drejtësia Gjinore dhe Mosdiskriminimi”.

1.3 Rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve

⁶² Shih në: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/11/10/670>

⁶³ Shih në: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/12/24/1139>

⁶⁴ Shih në: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/12/24/1140>

⁶⁵ Shih në: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/02/06/50>

⁶⁶ Shih në: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2015/11/18/930>

⁶⁷ Shih në: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/02/22/88>

⁶⁸ Shih në: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/10/10/659>

⁶⁹ Shih në: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/12/24/866>

⁷⁰ Shih në: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/12/24/864>

⁷¹ Shih në: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/04/06/210>

⁷² <https://old.shgpaz.al/sq/eplatform/per-gruan-sipermarrese/materjale/384-plani-i-veprimit-per-mbeshtetjen-e-gruas-sipermarrese-ne-shqiperi-2014-2020>

⁷³ Shih në: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/10/26/692>

⁷⁴ Shih në: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/11/18/701>

⁷⁵ Shih në: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/LGBTI-NAP-2021-2027-AL-final.pdf>

⁷⁶ Shih në: <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/ERP-2022-2024.pdf>

⁷⁷ Shih në: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/12/18/824>

⁷⁸ Shih më lart për më shumë informacion Strategjinë për Barazi Gjinore 2021–2030.

⁷⁹ Po aty.



Plani i Veprimit është një angazhim i qeverisë shqiptare qendrore të larta politikëbërëse në vend, që veprojnë në fushën e sigurisë dhe të ruajtjes së paqes, çështjeve gjinore, si dhe që adresojnë angazhimet ndërkombëtare të vendit. Plani i Veprimit është një politikë gjithëpërfshirëse e të gjithë qeverisë, e të përfshijë të gjithë ministrinë që identifikojnë çështje të lidhura me rendin dhe sigurinë në këndvështrim gjinor, në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Një nga parimet themelore për hartimin e planit të ri të veprimit është gjithëpërfshirja. Plani i Veprimit të zbatimit të Rezolutës 1325, bazuar në urdhrin nr. 330, datë 26.5.2022, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, koordinohet nga kjo ministri dhe ka përfaqësues nga;

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS),
- Ministria e Drejtësisë (MD),
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ),
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE),
- Ministria e Brendshme (MB), e cila ka dedikuar një prej zëvendësministrave të ndjekë zbatimin e R1325,⁸⁰
- Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS),
- Ministria e Mbrojtjes (MM),
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit,
- INSTAT-i.

Ky urdhër parashikon se në mbledhjet e Grupit Ndërinstitucional të Punës, në varësi të çështjeve që do të diskutohen, ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të institucioneve të tjera, pjesëmarrëse ose jo në këtë grup pune, përfshirë edhe përfaqësues të institucioneve të pavarura si Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe grupet e interesit. Përfshirja e ministrive bazohet në fushën e tyre të përgjegjësisë referuar vendimeve të Këshillit të Ministrave për këtë çështje. Plani i Veprimit është një angazhim i qeverisë shqiptare, kryesisht i atyre institucioneve që veprojnë në fushën e sigurisë dhe të ruajtjes së paqes, çështjeve gjinore, si dhe që adresojnë angazhimet ndërkombëtare të vendit. Institucionet kryesore të mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të njeriut në vend kanë qenë pjesë e takimeve përgjatë hartimit të Planit të dytë të Veprimit. Hartimi i Planit u

mbështet në udhëzimet nga Agjencia Shtetërore për Programimin dhe e Strategjive dhe Bashkërendimin e Ndhmës. Pjesëmarrja e institucioneve të pavarura si Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ishte po me aq rëndësi në procesin e hartimit të aktit nga grupet e institucioneve të angazhuara në çështjet e të drejtave të njeriut.

Realizimi i takimeve konsultuese me grupet e interesit, përfshirë edhe shoqërinë civile, për prezantimin e projekt-Planit, si dhe përmirësimi i cilësisë së tij bazuar në komentet, sugjerimet dhe rekomandimet e konsultimeve u vlerësua si qasje e domosdoshme. Situatat e përgjithshme të emergjencës kanë vënë në pah se zhvillimet janë të shumta dhe të panjohura, dhe e gjithë shoqëria është e nevojshme të kontribuojë në zhvillimet aktuale të saj. Prandaj, bashkëpunimi dhe ndërveprimi me shoqërinë civile vijoi në kuadër të Planit të 2të të Veprimit, sidomos me përfaqësues të Koalicionit Gruaja Paqja Siguria. Përfshirja e OSHC-ve që kanë agjendën GPS objekt të veprimtarisë së tyre është qasur si pasqyrim i rolit parësor që ato kanë në zhvillimin dhe zbatimin e politikave në vend dhe si monitoruese e tyre.

PJESA II. Qëllimi i politikave, objektivat specifikë dhe masat parësore të zbatimit të planit të veprimit

2.1 Vizioni i strategjisë

Vizioni dhe misioni i këtij Plani veprimi reflekton të njëjtën qasje të qeverisë si dhe në Planin e Veprimit 2018–2020, për zbatimin e Rezolutës 1325, duke garantuar kështu vijimësinë politike të vendit, si vijon:

Vizioni: Një shoqëri shqiptare ku gratë e vajzat kanë një rol të përforcuar dhe janë pjesëmarrëse aktive në ruajtjen e paqes, parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, si dhe një shoqëri me kontribut të qëndrueshëm në nivel ndërkombëtar në garantimin e të drejtave të grave të përfshira në situatat e konfliktit.

Misioni: rritja e përfaqësimit dhe e angazhimit të grave e vajzave në sektorin e sigurisë, duke reduktuar stereotipat gjinorë lidhur me përfshirjen e grave në proceset dhe pozitat vendimmarrëse në fushën e sigurisë dhe përforcimi i kontributit të vendit në një politikë ndërkombëtare garantuese të të drejtave të

⁸⁰ Urdhri nr. 27, i ministrit – Fusha e veprimtarisë së Zv.ministrave 19.1.2021. Shih në: <https://mb.gov.al/en/fusha-e-veprimtarise-se-zv-ministrave/>



grave e vajzave të përfshira në situata konflikti dhe post-konflikt.

2.2 Qasja Politike

Qasja politike e qeverisë shqiptare në këndvështrimin e agjendës GPS është ajo e një shoqërie të angazhuar për të përfshirë, mbështetur e fuqizuar gratë dhe vajzat në arritjen apo ruajtjen e paqes dhe sigurisë së qëndrueshme në vend e më gjerë. Në kuadër të zbatimit të Rezolutës 1325 dhe qasjes së qëndrueshme politike, fushat politike të Planit të dytë të Veprimit përfshijnë:

1. Pjesëmarrja, që synon rritjen e pjesëmarrjes së grave në poste drejtuese dhe pjesëmarrje duke forcuar lidhshimin e grave e vajzave në të gjitha fushat që lidhen me paqen e sigurinë;

2. Ndërgjegjësim dhe ekspertizë e thelluar për agjendën GPS, përfshirë sigurimin e personelit të kualifikuar për rastet e viktimave të dhunës, përfshirë dhunën seksuale dhe ngacmimin seksual në të gjitha fazat dhe në fushat e zgjidhjes së konflikteve, ndihmës humanitare dhe procedurave të azilit, etj., trajnimin për zgjidhjen e konflikteve dhe dhënien e ndihmës humanitare, si dhe informimin e publikut në lidhje me agjendën GPS, dhe mbështetje për aktivitetet e organizatave joqeveritare aktive në fushën e agjendës GPS. Kjo do të thotë edhe integrim gjinor në çdo politikë që parandalon konfliktet, përfshirë politikat mjedisore dhe fushën digjitale;

3. Parandalimi, që synon parandalimin e situatave të konfliktit në vend e më gjerë duke monitoruar e raportuar shkeljet e të drejtave të njeriut të lidhura me konfliktin kundër grave dhe vajzave dhe promovimin e politikave të tolerancës zero ndaj dhunës, përfshirë asaj seksuale, për të ndihmuar në përfundimin e mosndëshkimit dhe sjelljen e autorëve të krimeve të tilla para drejtësisë;

4. Mbrojtja, duke promovuar mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave, si dhe rritjen e aksesit të tyre në drejtësi në nivele vendore, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare

5. Lehtësimi dhe Rimëkëmbja në situata konflikti dhe pas konflikti, përfshirë ato natyrore, që plotësojnë nevojat e grave dhe vajzave duke fuqizuar më tej bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar.

Objektivat kryesorë janë të lidhur ngushtësisht me:

- Përmirësimin e dokumenteve të politikave në përputhje me agjendën grua, paqja, siguria;

- Marrjen e masave për një njohje, monitorim dhe raportim më të mirë të Rezolutës 1325;

- Uljen e pengesave për pjesëmarrje kuptimplotë të grave në fushën e paqes dhe sigurisë brenda e jashtë vendit, si dhe menaxhimin e krizave;

- Krijimin e një kuadri rregullator dhe kapacitete që mundësojnë parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, mbrojtje dhe rehabilitim më të mirë të grave në fushën e paqes dhe sigurisë.

Masat që vendi synon të realizojë përmes këtij Planit Veprimi përfshijnë:

- Rishikimin e politikave për të përfshirë dimensionin gjinor në sektorët e sigurisë;

- Nxitjen e këmbimit të eksperiencës në nivele të ndryshme rajonale, kombëtare, dhe ndërkombëtare;

- Adresimin me aktivitete të përbashkëta për rritjen e ndërgjegjësimit të rolit të grave në ruajtjen e paqes dhe adresimin e situatave postkonflikt: debate publike, fushata, tryeza të rrumbullakëta dhe forma të tjera të informimit publik;

- Rritjen e përfshirjes dhe e rolit të grave në politikat e sigurisë dhe pjesëmarrjen e eksperteve gra në aktivitetet politike në sigurinë paqeruajtëse, bashkëpunimin rajonal në misionet paqeruajtëse, menaxhimin e krizave, etj., si dhe forcimin e kapaciteteve në këtë drejtim;

- Bashkëpunimin me shoqërinë civile për zbatimin e Rezolutës 1325;

- Nxitjen e interesit të përgjithshëm për Rezolutën 1325.

PJESA III. Qëllimet strategjike

Objektivi kryesor i këtij Planit Veprimi është që, përmes pasqyrimin të rëndësisë kritike të pjesëmarrjes së plotë, të barabartë dhe kuptimplotë të grave e vajzave në të gjitha aspektet e paqes dhe stabilitetit, të zbatohet dhe monitorohet zbatimi i Rezolutës 1325 në nivel vendor, kombëtar, si dhe rajonal e ndërkombëtar. Objektivi i kësaj politike është përparimi shoqëror lidhur me barazinë gjinore përmes parimeve udhëzuese të integritetit, gjithëpërfshirjes dhe integritetit. Planit synon konsolidimin e arritjeve të Planit të parë të Veprimit 2018–2020 dhe vënien në zbatim të rekomandimeve nga ai Plan dhe synimeve të qeverisjes shqiptare për arritje të barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave edhe në sektorin e sigurimit e paqes.

Fusha politike 1 – Pjesëmarrja

Objektivi themelor në kuadër të kësaj fushe është rritja e pjesëmarrjes së grave në pozicione drejtuese dhe në proceset vendimmarrëse duke forcuar rolin



dhe lidhshin e grave në të gjitha fushat që lidhen me paqen e sigurinë.

Objektivi 1.1: Rritja e pjesëmarrjes së grave në pozicione drejtuese dhe pjesëmarrje në vendimmarrje duke forcuar lidhshin dhe rolin e grave në të gjitha fushat që lidhen me paqen e sigurinë

Masa 1: Rritja e numrit të grave, në pozicione të ndryshme dhe role drejtuese, në strukturat e policisë dhe forcat ushtarake

Masa 2: Rritja e numrit të punonjësve gra në strukturat operacionale të hetimit të krimit

Masa 3: Rritja e numrit të policeve gra në sistemin penitenciar në Shqipëri

Masa 4: Rritja e numrit të grave në fushën e kërkimit shkencor dhe akademik në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë

Masa 5: Rritja e pjesëmarrjes së grave në Këshillat e Sigurisë në nivel vendor

Objektivi 1.2: Rritja e përfaqësimit të grave në shërbimin diplomatik, mekanizma rajonale e ndërkombëtarë, dhe procese që lidhen me sigurinë dhe ruajtjen e paqes

Masa 1: Rritja e numrit të grave në shërbimin diplomatik të vendit dhe pozicione drejtuese në to (misionet e përhershme dhe ambasadat e RSH-së)

Masa 2: Rritja e numrit të grave përfaqësuese të Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare që adresojnë çështje të sigurisë ndërkombëtare dhe struktura të NATO-s

Masa 3: Rritja e pjesëmarrjes së grave të Forcave të Armatosura në misionet paqeruajtëse jashtë vendit

Fusha politike 2 – Ndërgjegjësim dhe ekspertizë e thelluar për agjendën Gruaja Paqja Siguria

Objektivi themelor në kuadër të kësaj fushe është njohja e mëtejshme dhe krijimi e përforcimi i ekspertizës për agjendën GPS si në mesin e profesionistëve që angazhohen në sektorë të lidhur me sigurinë, ashtu edhe në shoqërinë civile.

Objektivi 2.1: Forcimi i kapaciteteve të administratës për agjendën GPS

Masa 1: Trajnime për konceptin dhe agjendën kombëtare “Gruaja Paqja Siguria” për punonjësit e administratës shtetërore dhe njësi vendore të përfshirë në hartimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 në vend

Masa 2: Trajnime me fokus tek çështjet gjinore në operacionet ushtarake

Masa 3: Përfshirja e agjendës GPS në kurrikulën arsimore të Akademisë së Sigurisë dhe Akademisë së Forcave të Armatosura

Objektivi 2.2: Integrimi i agjendës GPS në veprimtari në sektorët e sigurisë

Masa 1: Realizimi i veprimtarive ndërgjegjësuese për agjendën GPS në strukturat e policisë, forcat ushtarake, shërbimin diplomatik, dhe këshillat vendorë të sigurisë

Masa 2: Pjesëmarrja e punonjësve të strukturave të policisë dhe forcave ushtarake në konferenca, seminare, në punëtori për agjendën GPS

Masa 3: Rritja e numrit të aktiviteteve në Kuvend për agjendën GPS

Masa 4: Realizimi i pyetësorit për ngacmimin seksual në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Brendshme, strukturat e policisë dhe forcat ushtarake

Objektivi 2.3: Forcimi i kapaciteteve në zgjidhjen e integruar gjinore të konflikteve, dhënien e ndihmës humanitare dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm

Masa 1: Rritja e numrit të veprimtarive trajnuese për zgjidhjen e konflikteve dhe dhënien e ndihmës humanitare dhe aspektet gjinore, për punonjësit e strukturave të policisë, forcave ushtarake, shërbimit diplomatik, të angazhuar në proceset e azilit dhe të strukturave kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm

Masa 2: Rritja e numrit të veprimtarive trajnuese për punonjësit e ushtrisë për rastet e viktimave të dhunës në situata konflikti dhe pas konfliktit, krizës, dhe të emergjencave civile, për situatat e emergjencave

Objektivi 2.4: Forcimi i kapaciteteve të punonjësve në sektorë të sigurisë në vend për barazinë gjinore, mosdiskriminimin dhe dhunën seksuale dhe ngacmimin seksual

Masa 1: Rritja e numrit të veprimtarive trajnuese për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin për punonjës të sistemit të drejtësisë, punonjës të rendit dhe sigurisë, shërbimit diplomatik dhe punonjësit e angazhuar në proceset e azilit

Masa 2: Forcimi i kapaciteteve për dhunën seksuale dhe ngacmimin seksual të punonjësve të strukturave të policisë dhe forcave të armatosura, shërbimit diplomatik dhe punonjësit e angazhuar në proceset e azilit

Objektivi 2.5: Forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për agjendën GPS



Masa 1: Mbështetje financiare e OSHC-ve për agjendën GPS

Masa 2: Hartimi i një manuali trajnimi për agjendën GPS, në bashkëpunim me shoqërinë civile, për OSHC-të

Masa 3: Trajtime për agjendën GPS për koalicionin/et e OSHC-ve që veprojnë në fushën e agjendës GPS dhe shoqatat e ushtarakëve dhe të grave të strukturave të policisë

Objektivi 2.6: Rritje e ndërgjegjësimit të publikut për agjendën GPS

Masa 1: Aktivitete informuese me të rinj dhe në institucionet e

arsimit të lartë për njohjen e agjendës GPS

Masa 2: Rritje e ndërgjegjësimit të të rinjve/rejave për R1325 dhe angazhimin e grave në sektorët e sigurisë dhe në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe Akademinë e Sigurisë

Masa 3: Emisione e programe televizive në media, si dhe artikuj në shtypin e shkruar, për agjendën GPS dhe për gratë e vajzat në role drejtuese në strukturat e policisë dhe forcat ushtarake, kontribuuese në organizata dhe misione paqeruajtëse jashtë vendi

Fusha politike 3 – Parandalimi

Objektivi: Synon parandalimin e situatave të konfliktit në vend e më gjerë duke monitoruar e raportuar shkeljet e të drejtave të njeriut të lidhura me konfliktin kundër grave dhe vajzave dhe promovimin e politikave të tolerancës zero ndaj dhunës, përfshirë asaj seksuale, për të ndihmuar në përfundimin e mosndëshkimit dhe sjelljen e autorëve të krimeve të tilla para drejtësisë

Objektivi 3.1: Përmirësimi i kuadrit politik e rregullator në sektorët e sigurisë në vend, me qëllim integrimin gjinor në fushën e paqes dhe sigurisë

Masa 1: Përafrimi i legjislacionit për sigurinë kufitare dhe për të huajt me legjislacionin e BE-së dhe për çështjet e azilit

Masa 2: Rishikim i akteve rregullatore me qëllim hartimin e planeve periodike trajnuese për gratë në fushën e paqes dhe sigurisë dhe për çështje të sigurisë dhe barazisë gjinore në strukturat e policisë, forcat ushtarake, strukturat e shërbimit diplomatik, dhe strukturat që trajtojnë çështjet e azilit

Masa 3: Përfshirja në planet e veprimit të sektorëve të sigurisë, si policia e ushtria, e vlerësimit të zhvillimit të të dhënave administrative si dhe e statistikave gjinore në sektorin e sigurisë

Masa 4: Përfshirja e shoqërisë civile në proceset e hartimit dhe rishikimit të politikave në zbatim të agjendës GPS në vend

Objektivi 3.2: Ndjeshmëri më e lartë gjinore në politikat urbanistike, mjedisore e digjitale

Masa 1: Vlerësim i integritit gjinor në politikat mjedisore

Masa 2: Vlerësim i integritit gjinor në politikat parandaluese të situatave të konfliktit në fushën digjitale

Masa 3: Kryerja e studimeve dhe fushatave ndërgjegjësuere për qytete të sigurta në nivelin vendor

Objektivi 3.3. Ndërmarrja e veprimtarive parandaluese të konflikteve në vend

Masat 1: Studime për ndikimin e situatave të konfliktit tek gratë dhe vajzat në RSH

Masa 2: Ndërgjegjësimi i grave dhe vajzave e reja me synim parandalimin e kriminalitetit dhe emigrimit ilegal

Masa 3: Rritja e ndërgjegjësimit për minat, bombat, eksplozivët e tjerë të mbetura pas situatave të konfliktit

Masa 4: Veprimtari ndërgjegjësuere për mbledhjen e armëve të shpërndara në kundërshtim me ligjin në popullatë dhe fushata për mbledhjen e tyre.

Fusha politike 4 – Mbrojtja

Objektivi: Promovimi i mbrojtjes së të drejtave të grave dhe vajzave, si dhe rritje e aksesit të grave dhe vajzave në drejtësi në nivele vendore, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare

Objektivi 4.1: Përforsimi i masave mbrojtëse në sektorët e mbrojtjes dhe sigurisë për gratë dhe vajzat viktime të dhunës dhe dhunës kibernetike me bazë gjinore

Masa 1: Analizë e sistemit aktual të aksesit në drejtësi të grave dhe vajzave të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore, dhe shfrytëzimit seksual, dhe çdo formë të dhunës për përmirësimin e aksesit të tyre në drejtësi

Masa 2: Masa në kuadër të parandalimit dhe denoncimit të dhunës fizike, emocionale, seksuale si dhe në kuadër të sigurisë kibernetike me bazë gjinore, përgatitjen e materialeve të sponsorizuara të formateve të përshtatshme për televizion si dhe rrjetet sociale, spotet për të nxitur raportimin e rasteve, veprave të ndryshme sipas Kodit Penal, ngacmimeve, shantazhimeve, vjedhjeve të identitetit, etj.



Masa 3: Ofrimi i ndihmës juridike parësore e dytësore nga ofruesit e ndihmës juridike parësore për gratë dhe vajzat refugjate dhe azilkërkuese viktime apo të mbijetuara refugjate dhe azilkërkuese të DHBGJ, shfrytëzimit dhe abuzimit seksual

Masa 4: Ndërgjegjësimi i grave dhe vajzave refugjate dhe azilkërkuese të DHBGJ, abuzimit dhe shfrytëzimit seksual, lidhur me të drejtat që disponojnë në kuadër të aksesit në drejtësi

Masa 5: Ofrimi i shërbimeve mbështetëse nga mjekë të specializuar dhe përgatitja e raportit të ekspertimit në rastin e grave dhe vajzave viktime apo të mbijetuara të DHBGJ, shfrytëzimit dhe abuzimit seksual

Objektivi 4.2: Promovim i mbrojtjes së grave dhe vajzave viktime të dhunës me bazë gjinore në situatat e konflikteve të armatosura dhe postkonflikte në vende të tjera

Masa 1. Ndërgjegjësim për zero tolerancë ndaj abuzimit dhe shfrytëzimit seksual në strukturat e policisë dhe forcat ushtarake

Masa 2: Veprimtari për rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të grave dhe vajzave, si dhe rritjes së aksesit të grave dhe vajzave në drejtësi në nivele vendore, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare

Masa 3: Marrja e masave në strukturat e policisë dhe forcat ushtarake në lidhje me nevojat specifike dhe mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave në të gjitha fazat dhe fushat e zgjidhjes së konflikteve

Objektivi 4.3: Fuqizimi i mekanizmave të sigurisë në nivel vendor për mbrojtjen e grave dhe vajzave viktime të dhunës me bazë gjinore

Masa 1: Krijimi i Këshillave të Sigurisë në çdo NJVV dhe trajnimi i të gjithë anëtarëve të tyre për R1325 dhe dhunën me bazë gjinore

Masa 2: Miratimi i akteve/planeve vjetore në NJVV për mbrojtjen e grave dhe vajzave viktime të dhunës me bazë gjinore

Objektivi 4.4: Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore

Masa 1: Studim për pasojat tek gratë e vajzat i fatkeqësive natyrore /emergjenca civile dhe rreziqe të tjera që lidhen me sigurinë njerëzore

Masa 2: Realizimi i programeve me ndjeshmëri gjinore si pjesë e mbrojtjes civile për të përmirësuar veprimet dhe përgjigjet në situatë krize dhe emergjence civile

Fusha politike 5 – Lehtësimi dhe Rimëkëmbja

Objektivi: Nevojat e grave dhe vajzave të jenë të plotësuara në situata konflikti dhe pas konflikti, përfshirë ato natyrore, duke fuqizuar më tej bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar.

Objektivi 5.1: Lehtësimi dhe Rimëkëmbja në situata konflikti dhe pas konflikti, përfshirë ato natyrore, që plotësojnë nevojat e grave dhe vajzave

Masa 1: Garantimi i lehtësimit dhe rimëkëmbje efektive për gratë e vajzat në raste emergjencash civile apo konflikti

Masa 2: Programe me temë siguria, reforma sektoriale, çarmatimi, çmobilizimi dhe riintegrimi, ndihma humanitare, qeverisja e mirë, të drejtat e njeriut, drejtësia tranzicionale, në të cilat ka dimension gjinor, etj.

Masa 3: Ofrimi i shërbimit të kujdesit shëndetësor për situata konflikti dhe pas konflikti

Masa 4: Programe rehabilitimi (për nevojat e ndryshme) të ish-ushtarakëve burra dhe gra pjesëmarrës në operacione paqeruajtëse për nevojat e familjarëve të tyre

Objektivi 5.2: Fuqizimi psikologjik, social-ekonomik i grave e vajzave të prekura nga konflikti apo situata fatkeqësish

Masa 1: Mbështetje psikologjike për gratë dhe vajzat e prekura nga konflikti apo situata fatkeqësish/emergjenca civile

Masa 2: Mbështetja e grave/vajzave nga NJVV për fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave të prekura nga konflikti apo emergjencat civile

Objektivi 5.3: Përmirësimi i bashkëpunimit për zbatimin dhe monitorimin e Rezolutës 1325

Masa 1. Këmbimi i eksperiencës në nivel kombëtar lidhur me Rezolutën 1325, përmes organizimit të konferencave apo aktiviteteve të tjera në rajon

Masa 2: Numri i aktiviteteve në RSH që pasqyrojnë mbështetje për agjencitë e OKB-së, në veçanti UN WOMEN, NATO-s, etj., në zbatimin e agjendës GPS

Masa 3: Bashkëpunimi dhe transferimi i informacionit ndërmjet vendeve partnere për agjendën GPS

Masa 4: Hartimi i raporteve vjetore dhe publikimi i raportimit përfundimtar të zbatimit të Planit të Veprimit për Rezolutën 1325



PJESA IV. Burime financiare

Plani i Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të KSKB-së do të zbatohet në periudhën 2022–2027. Për të mbështetur zbatimin e tij është parashikuar kostoja për secilin: masë, objektiv specifik, synim strategjik dhe fushë politike. Totali i fondeve që nevojiten për të financuar këtë plan për pesë vite është 127,254,605.36 lekë, nga të cilat: 47,684,605 lekë janë paga dhe sigurime për stafet e institucioneve qendrore dhe pjesa tjetër, 79,570,000 lekë, janë trajnime/takime apo asistencë teknike. Hendeku i financimit është 16% ose 20,325,000.00 lekë, duke qenë se ende nuk janë marrë angazhime konkrete nga donatorët për zhvillimin e disa prej aktiviteteve që kanë lidhje me konferenca apo vizita studimore.

Kostimi i planit të veprimit u realizua mbështetur në koston e secilës masë të pasqyruar në planin e veprimit dhe kohështirjen e tij, si dhe treguesit për monitorimin e planit të veprimit. Metodologjia e përdorur për kostimin është një metodologji e kombinuar, për shkak të larmisë së sektorëve dhe institucioneve, si dhe të masave. Ky kostim përfshin një periudhë 5-vjecare, 2023–2027. Metodologjia kryesore e përdorur është kostimi i bazuar në aktivitete, por ndërkohë janë marrë parasysh për shumë veprimtari shpenzimet mesatare sipas PBA 2023–2027 për aktivitete që janë përfshirë në buxhet dhe për aktivitete të ngjashme, është mbajtur parasysh niveli i pagave në sektorët e përfshirë në planin e veprimit etj.

Kostimi i Planit do të rishikohet në përfundim të vitit 2027, për periudhën në vijim të kohëzgjatjes së këtij Plani Veprimi deri në vitin 2027.

Plani i Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Mbi gruan, paqen dhe sigurinë” 2023–2027, është hartuar nga një grup pune në të cilin u përfaqësuan institucionet qendrore pjesëmarrëse në zbatimin e këtij plani. Ky plan është një vazhdim i planit të mëparshëm, ndaj pjesa më e madhe e objektivave/masave/aktiviteteve janë përsëritje apo edhe vazhdim i parashikimeve të planit të mëparshëm.

Metodologjia i kostimit të këtij plani është ajo e kostove inkrementale, pra janë parashikuar vetëm kostot shtesë të nevojshme për zbatimin e tij. Përlllogaritjet u bazuan në:

- Metodologjinë e miratuar nga SASPAC;
- Informacionin e përfshirë në planin e veprimit;

- Diskutimet në grupin e punës;
- Informacionin financiar të përfshirë në Programin Buxhetor Afatmesëm 2023–2027;
- Informacionin e përfshirë në Strategjinë e Barazisë Gjinore;
- Të dhëna të tjera në dispozicion.

Për shkak të ndryshimeve të fundit në sistemin e pagave në administratën shtetërore dhe pamundësisë së përcaktimit të gradave të specialistëve që do të përfshihen në zbatimin e këtij plani, procesi i kostimit është kryer duke aplikuar një tolerancë në ditët e punës së nevojshme apo numrit të specialistëve. Kjo metodologji do të mundësojë planifikimin e fondeve nga institucionet brenda tavaneve buxhetore.

Plani i Veprimit është parashikuar të zbatohet në 5 vite, duke filluar nga viti 2023 deri në vitin 2027. Duke qenë se pjesa më e madhe e masave përsëriten në të trija vitet, si dhe për faktin se asistencë teknike e nevojshme është thujse e gjitha e përqendruar në ofrimin e trajnimeve, organizimin e takimeve apo konferencave, për të pasur mundësinë e sigurimit të fondeve të mjaftueshme, janë parashikuar për të gjitha vitet e Planit.

Duke qenë se ky Plan bazohet edhe në Strategjinë e Barazisë Gjinore, disa prej masave, kryesisht ato të Qëllimit 5, janë parashikuar edhe në këtë strategji. Për të shmangur kostimin e dyfishtë dhe pamundësinë e buxhetimit, këto masa janë konsideruar me kosto 0.

Po ashtu, masat e parashikuara në Qëllimin I (Pjesëmarrja: Rritja e pjesëmarrjes së grave në pozicione drejtuese dhe në proceset vendimmarrëse duke forcuar rolin dhe lidhësinë e grave në të gjitha fushat që lidhen me paqen e sigurinë), ka kosto 0, pasi të gjitha masat e parashikuara në këtë qëllim kanë të bëjnë me aktivitetin rutinë të institucioneve, siç është përzgjedhja e kandidatëve në bazë të parimeve të barazisë gjinore.

Qëllimi II, III dhe IV janë ato që kanë kostot më të larta, pasi kanë të bëjnë me masat që duhen marrë për rritjen e ndërgjegjësimit apo kapaciteteve të administratës publike, lidhur me çështjet e pabarazive gjinore që hasen në konflikte/luftëra. Edhe në këto qëllime, ka masa të cilat janë parashikuar në plane të tjera veprimi, si p.sh. ai i CVE apo i asistencës ndaj të kthyerve. Për këtë arsye nuk janë kostuar për të shmangur kostimin e dyfishtë dhe pamundësinë e buxhetimit.



Duke qenë se të gjitha aktivitetet do të kryhen nga struktura aktuale, pra nuk ka nevojë për ngritjen e strukturave të reja, apo investimeve, kostot kanë të bëjnë me:

- pagat dhe sigurimet për stafet aktuale;
- trajnime;
- takime;
- asistencë teknike.

Aktivitetet që kanë të bëjnë me trajnimet, takimet dhe asistencë teknike në përgjithësi pritet të

financohen nga donatorë. Pavarësisht se nuk ka një angazhim konkret nga asnjë donator, duke pasur parasysh bashkëpunimin e deritanishëm si dhe interesin e shprehur sidomos nga BE, UN Women dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, hendeku i financimit të këtij plani është planifikuar të jetë vetëm 16% për çdo vit. Më poshtë jepet një përmbledhje e të dhënave financiare për çdo vit:

Viti 2023

| Paga dhe sigurime | Kosto korrente | Investime | Totali i kostove | Nga buxheti i shtetit | Donatore të tjerë | Hendeku i financimit |
|-------------------|----------------|-----------|------------------|-----------------------|-------------------|----------------------|
| 9,536,921 | 15,914,000 | | 25,450,921 | 9,536,921 | 11,849,000 | 4,065,000 16% |

Viti 2024

| Paga dhe sigurime | Kosto korrente | Investime | Totali i kostove | Nga buxheti i shtetit | Donatore të tjerë | Hendeku i financimit |
|-------------------|----------------|-----------|------------------|-----------------------|-------------------|----------------------|
| 9,536,921 | 15,914,000 | | 25,450,921 | 9,536,921 | 11,849,000 | 4,065,000 16% |

Viti 2025

| Paga dhe sigurime | Kosto korrente | Investime | Totali i kostove | Nga buxheti i shtetit | Donatore të tjerë | Hendeku i financimit |
|-------------------|----------------|-----------|------------------|-----------------------|-------------------|----------------------|
| 9,536,921 | 15,914,000 | | 25,450,921 | 9,536,921 | 11,849,000 | 4,065,000 16% |

Viti 2026

| Paga dhe sigurime | Kosto korrente | Investime | Totali i kostove | Nga buxheti i shtetit | Donatore të tjerë | Hendeku i financimit |
|-------------------|----------------|-----------|------------------|-----------------------|-------------------|----------------------|
| 9,536,921 | 15,914,000 | | 25,450,921 | 9,536,921 | 11,849,000 | 4,065,000 16% |

Viti 2027

| Paga dhe sigurime | Kosto korrente | Investime | Totali i kostove | Nga buxheti i shtetit | Donatore të tjerë | Hendeku i financimit |
|-------------------|----------------|-----------|------------------|-----------------------|-------------------|----------------------|
| 9,536,921 | 15,914,000 | | 25,450,921 | 9,536,921 | 11,849,000 | 4,065,000 16% |

PJESA V. Llogaridhënia, monitorimi dhe analiza vlerësuese e Planit të Veprimit

Procesi i monitorimit të zbatimit të këtij Plani veprimi është një proces ndërsektorial, i cili

ushqen orientimin e politikave në Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI) në vend. Raporti në kuadër të këtij Plani Veprimi do të dërgohet pranë Grupit të Integruar të Menaxhimit të Politikave,



përkatësisht nëngrupit tematik për Sektorin e Punësimit dhe atë Social, i ngritur me urdhër të Kryeministrit, nr. 129, datë 21.9.2015, “Për marrjen e masave institucionale dhe operacionale për zbatimin e qasjes sektoriale dhe krijimin e grupeve të menaxhimit të integruar të politikave”. Raporti paraqitet për miratim pranë Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore. MSHMS-ja ka rol koordinues dhe bashkërendues mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Veprimit.

Në nivel operacional, përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit janë nëpunësit e barazisë gjinore në ministrinë e linjës dhe institucionet e ngarkuara me zbatimin e këtij Planit Veprimi, të cilët mbledhin të dhëna dhe identifikojnë boshllëqet e informacionit që nevojitet. MSHMS-ja do të koordinojë procesin e mbledhjes së të dhënave nga të gjithë nëpunësit gjinorë në institucionet e përfshira.

Monitorimi i këtij Planit Veprimi do të realizohet nga një Grup Zbatimi dhe Koordinimi (GZK), i cili do të monitorojë dhe do të raportojë lidhur me Planin e Veprimit çdo vit kalendarik. GZK-ja përbëhet nga përfaqësues teknikë të

ministrive të linjës, institucioneve përgjegjëse për zbatimin e këtij Planit Veprimi. Në takimet e saj, GZK-ja mund të ftojë të jenë pjesëmarrës edhe përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile të angazhuara me agjendën grua, paqja, siguria.

Planit i Veprimit parashikon monitorimet vjetore përmes raportimeve vjetore të GZK-së. Gjetjet e raporteve vjetore bëhen me dije Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore (KKBGj-së) përgatitjen e raporteve vjetore dhe botimin e raportit përfundimtar të monitorimit, i cili përfshihet në programin e transparencës së MSHMS-së.

Cikli i vlerësimit të këtij Planit Veprimi përfshin vlerësimin e progresit në përfundim të planit dhe rishikimin dhe përditësimin masave në përfundim të vitit 2027 të zbatimit të tij. Raporti i vlerësimit botohet në programin e transparencës së MSHMS-së. Ky raport do të shërbejë si bazë për rishikimin e masave të veprimit dhe kostimit të Planit të Veprimit për periudhën e mbetur të realizimit të Planit të veprimit deri në vitin 2027



Shtojca 1: Plani i Veprimit 2023-2027

I. QËLLIMI STRATEGJIK: Krijimi i një shoqërie shqiptare ku gratë e vajzat kanë një rol të përforcuar dhe janë pjesëmarrëse aktive në ruajtjen e paqes, parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, dhe me kontribut të qëndrueshëm në nivel ndërkombëtar në garantimin e të drejtave të grave të përfshira në situatat e konfliktit.

II. QËLLIMI I POLITIKËS: Pjesëmarrja

Rritja e pjesëmarrjes së grave në pozicione drejtuese dhe në proceset vendimmarrëse duke forcuar rolin dhe lidhshërinë e grave në të gjitha fushat që lidhen me paqen e sigurinë

III. PROGRAMI BUXHETOR QË KONTRIBUON PËR QËLLIMIN E POLITIKËS (Burimet financiare përcaktohen në bazë të planit të veprimit që shoqëron këtë strategji në aneksin 1, në përputhje me kostimin e tyre. Gjithashtu, janë marrë në konsideratë edhe burimet e tjera financiare, si: donacionet apo dhe huat, nëpërmjet të cilave parashikohet të mbulohen boshllëqet financiare.)

| Nr. | Masat për çdo objektiv | Institucionet përgjegjëse | | Afatet për zbatimin | |
|---|---|--|---|---------------------|------------------|
| | | Institucioni udhëheqës | Institucion kontribues (nëse ka) | Afati fillimit | Afati i mbarimit |
| Objektivi 1.1 Rritja e pjesëmarrjes së grave në pozicione drejtuese dhe pjesëmarrje në vendimmarrje duke forcuar lidhshërinë dhe rolin e grave në të gjitha fushat që lidhen me paqen e sigurinë | | | | | |
| 1.1.1 | Masa 1. Rritja e numrit të grave, në pozicione të ndryshme dhe role drejtuese, në strukturat e policisë dhe forcat ushtarake | Policia e Shtetit, FA | MM, MB, MSHMS, Organizata Ndërkombëtare/Prezenca e OSBEsë në Shqipëri | 2023 | 2027 |
| 1.1.2 | Masa 2. Rritja e numrit të punonjëseve gra në strukturat operacionale të hetimit të krimin | Policia e Shtetit, FA | MM, MB, MSHMS | 2023 | 2027 |
| 1.1.3 | Masa 3: Rritja e numrit të policeve gra në sistemin penitenciar në Shqipëri | Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Shërbimi i Provës | MD, MSHMS | 2023 | 2027 |
| 1.1.4 | Masa 4: Rritja e numrit të grave në fushën e kërkimit shkencor dhe akademik dhe në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë | MM, AFA dhe KMS, MB, Akademia e Sigurisë | MSHMS | 2023 | 2027 |
| 1.1.5 | Masa 5: Rritja e pjesëmarrjes së grave në Këshillat e Sigurisë në nivel vendor | NJVV, OSHC | MB, AMVV, MSHMS | 2023 | 2027 |
| Objektivi 1.2 Rritja e përfaqësimit të grave në shërbimin diplomatik, mekanizma rajonale e ndërkombëtarë, dhe procese që lidhen me sigurinë dhe ruajtjen e paqes | | | | | |
| 1.2.1 | Masa 1. Rritja e numrit të grave në shërbimin diplomatik të vendit dhe pozicione drejtuese në to (misionet e përhershme dhe ambasadat e RSH-së) | MEPJ | Presidenca, MSHMS | 2023 | 2027 |
| 1.2.2 | Masa 2. Rritja e numrit të grave përfaqësuese të Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare që adresojnë çështje të sigurisë ndërkombëtare dhe struktura të NATO-s | Kuvendi, MM, SHPFA + Komandat Kryesore | MEPJ | 2023 | 2027 |
| 1.2.3 | Masa 3. Rritja e pjesëmarrjes së grave të Forcave të Armatosura në misionet paqeruajtëse jashtë vendit | MM, SHPFA + Komandat Kryesore | MEPJ | 2023 | 2027 |

II. QËLLIMI I POLITIKËS: – Ndërgjegjësim dhe ekspertizë e thelluar për agjendën Gruaja Paqja Siguria



Njohja e mëtejshme dhe krijimi e përforcimi i ekspertizës për agjendën GPS si në mesin e profesionistëve që angazhohen në sektorë të lidhur me sigurinë, ashtu edhe në shoqërinë civile

III. PROGRAMI BUXHETOR QË KONTRIBUON PËR QËLLIMIN E POLITIKËS (Burimet financiare përcaktohen në bazë të planit të veprimit që shoqëron këtë strategji në aneksin 1, në përputhje me kostimin e tyre. Gjithashtu, janë marrë në konsideratë edhe burimet e tjera financiare, si: donacionet apo dhe huat, nëpërmjet të cilave parashikohet të mbulohen boshllëqet financiare.)

| Nr. | Masat për çdo objektiv | Institucionet përgjegjëse | | Afatet për implementimin | |
|---|---|---|--|--------------------------|----------------|
| | | Institucioni udhëheqës | Institucion kontribues (nëse ka) | Afati i fillimit | Afati mbarimit |
| Objektivi 2.1: Forcimi i kapaciteteve të administratës për agjendën GPS | | | | | |
| 2.1.1 | Masa 1: Trajnime për konceptin dhe agjendën kombëtare “Gruaja Paqja Siguria” për punonjësit e administratës shtetërore dhe njërive vendore të përfshirë në hartimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 në vend | MSHMS, ASPA, | Organizata Ndërkombëtare, MB, MM, MEPJ, OSHC | 2023, 2024 | 2027 |
| 2.1.2 | Masa 2: Trajnime me fokus tek çështjet gjinore në operacionet ushtarake | AFA, KMS | SHPFA dhe komandat kryesore | 2023 | 2027 |
| 2.1.3 | Masa 3: Përfshirja e agjendës GPS në kurrikulën arsimore të Akademisë së Sigurisë dhe Akademisë së Forcave të Armatosura | Akademia e Sigurisë dhe Akademia e Forcave të Armatosura | MM, MB | 2023 | 2027 |
| Objektivi 2.2: Integrimi i agjendës GPS në veprimtari në sektorët e sigurisë | | | | | |
| 2.2.1 | Masa 1: Realizimi i veprimtarive ndërgjegjësuere për agjendën GPS në strukturat e policisë dhe forcave ushtarake, shërbimin diplomatik, dhe këshillat vendore të sigurisë | SHPFA dhe komandat kryesore Policia e Shtetit, MEPJ, NJVV | MM, MB, MSHMS, OSHC | 2023 | 2027 |
| 2.2.2 | Masa 2: Pjesëmarrja e punonjësve të strukturave të ushtrisë dhe policisë në konferenca, seminare, në punëtori për agjendën GPS | Policia e Shtetit, AFA, KMS | MB MM, SHPFA dhe komandat kryesore | 2023 | 2027 |
| 2.2.3 | Masa 3: Rritja e numrit të aktiviteteve në Kuvend për agjendën GPS | Kuvend (Komisioni i Sigurisë, etj.) | Organizata Ndërkombëtare, MSHMS | 2023, 2024 | 2027 |
| 2.2.4 | Masa 4: Realizimi i pyetësorit për ngacmimin seksual në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Brendshme, strukturat e policisë dhe forcave ushtarake | MM, MB, Policia e Shtetit | MSHMS, Organizata Ndërkombëtare/Prezenca e OSBE-së në Shqipëri | 2023 | 2027 |
| Objektivi 2.3: Forcimi i kapaciteteve në zgjidhjen e integruar gjinore të konflikteve, dhënien e ndihmës humanitare dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm | | | | | |
| 2.3.1 | Masa 1: Rritja e numrit të veprimtarive trajnuese për zgjidhjen e konflikteve dhe dhënien e ndihmës humanitare dhe aspektet gjinore, për punonjësit e strukturave të policisë, forcave | MM, AFA, KMS Akademia e Diplomacisë Akademia e Sigurisë, QKEDH | SHPFA dhe komandat kryesore MEPJ, MB | 2023 | 2027 |



| | | | | | |
|--|---|--|--|------|------|
| 2.3.2 | ushtarake, shërbimit diplomatik, të angazhuar në proceset e azilit dhe të strukturave kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm Masa 2: Rritja e numrit të veprimtarive trajnuese për punonjësit e ushtrisë për rastet e viktimave të dhunës në situata konflikti dhe pas konfliktit, krizës, dhe të emergjencave civile, për situatat e emergjencave | MM, AFA, KMS Akademia e Sigurisë | SHPFA dhe komandat kryesore MB | 2023 | 2027 |
| Objektivi 2.4: Forcimi i kapaciteteve të punonjësve në sektorë të sigurisë në vend për barazinë gjinore, mosdiskriminimin dhe dhunën seksuale dhe ngacmimin seksual | | | | | |
| 2.4.1 | Masa 1: Rritja e numrit të veprimtarive trajnuese për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin për punonjës të sistemit të drejtësisë, punonjës të rendit dhe sigurisë, shërbimit diplomatik dhe punonjësit e angazhuar në proceset e azilit | Akademia e Forcave të Armatosura, Akademia e Sigurisë, Akademia e Diplomacisë, Shkolla e Magjistraturës, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi | Forcat e Armatosura, Policia e Shtetit, MB, MSHMS, Organizata Ndërkombëtare/Prezenca e OSBE-së në Shqipëri | 2023 | 2027 |
| 2.4.2 | Masa 2: Forcimi i kapaciteteve për dhunën seksuale dhe ngacmimin seksual të punonjësve të strukturave të policisë dhe forcave të armatosura, shërbimit diplomatik dhe punonjësit e angazhuar në proceset e azilit | Akademia e Forcave të Armatosura, Akademia e Sigurisë, Akademia e Diplomacisë | Forcat e Armatosura, Policia e Shtetit, MB, MSHMS | 2023 | 2027 |
| Objektivi 2.5: Forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për agjendën GPS | | | | | |
| 2.5.1 | Masa 1: Mbështetje financiare e OSHC-ve për agjendën GPS | AMSHC | Kryeministria, MSHMS | 2023 | 2027 |
| 2.5.2 | Masa 2: Hartimi i një manuali trajnimi për agjendën GPS, në bashkëpunim me shoqërinë civile, për OSHC-të | OSHC/Koalicioni 1325 | MM, MB, MSHMS | 2024 | 2027 |
| 2.5.3 | Masa 3: Trajnime për agjendën GPS për koalicionin/et e OSHC-ve që veprojnë në fushën e agjendës GPS dhe shoqatat e ushtarakëve dhe të grave të strukturave të policisë | OSHC/Koalicioni 1325 / Shoqata e Grave në Polici | MM, MB, MSHMS | 2024 | 2027 |
| Objektivi 2.6: Rritje e ndërgjegjësimit të publikut për agjendën GPS | | | | | |
| 2.6.1 | Masa 1: Aktivitete informuese me të rinj dhe në institucionet e arsimit të lartë për njohjen e agjendës GPS. | OSHC/Koalicioni 1325, IAL | MB, MM, MSHMS | 2023 | 2027 |
| 2.6.2 | Masa 2: Rritje e ndërgjegjësimit të të rinjve/rejave për R1325 dhe angazhimin e grave në sektorët e sigurisë dhe në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe Akademinë e Sigurisë. | Akademia e Forcave të Armatosura, Akademia e Sigurisë, Zyrrat Vendore të Arsimit Parauniversitar | MM, MB, MAS, MSHMS, OSHC | 2023 | 2027 |



| | | | | | |
|-------|--|--------------------------------|---|------|------|
| 2.6.3 | Masa 3: Emisione e programe televizive në media, si dhe artikuj në shtypin e shkruar, për agjendën GPS dhe për gratë e vajzat në role drejtuese në strukturat e policisë dhe forcat ushtarake, kontribuese në organizata dhe misione paqeruajtëse jashtë vendi | SHPFA dhe komandat kryesore MB | MM, MEPJ MSHMS, OSHC, Koalicioni 1325 | 2023 | 2027 |
|-------|--|--------------------------------|---|------|------|

III. QËLLIMI I POLITIKES: – Parandalimi
Parandalimi i situatave të konfliktit në vend e më gjerë duke monitoruar e raportuar shkeljet e të drejtave të njeriut të lidhura me konfliktin kundër grave dhe vajzave dhe promovimin e politikave të tolerancës zero ndaj dhunës, përfshirë asaj seksuale, për të ndihmuar në përfundimin e mosndëshkimit dhe sjelljen e autorëve të krimeve të tilla para drejtësisë

23. Neni 34/a § 2 i KPP-së, në fuqi më 1 gusht 2017, parashikon se autoritetet duhet t'i japin të dyshuarit “letrën e të drejtave” në formë të shkruar ku gjendet informacion për të drejtat e tij ose të saj për t'u mbrojtur, duke përfshirë të drejtën për të heshtur dhe të drejtën për një avokat të përzgjedhur nga vet i dyshuari ose për ndihmë juridike falas sipas disa kushteve të caktuara, përpara se të zhvillohet seanca e parë e marrjes në pyetje.

24. Neni 49 §§ 1 dhe 2 i KPP-së, në fuqi më 1 gusht 2017, parashikonte:

“1. I pandehuri që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose që ka mbetur pa të, ndihmohet nga një mbrojtës i caktuar nga organi që procedon, në qoftë se e kërkon atë.

2. Kur i pandehuri është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç ose me të meta fizike a psikike që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes, ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme.”

25. Pjesa përkatëse e nenit 49 § 1 e KPP-së, në fuqi prej datës 1 gusht 2017, parashikon:

“1. Organi procedues i siguron menjëherë një mbrojtës të paguar nga shteti të pandehurit që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose ka mbetur pa të kur:

...

ç) është akuzuar për një vepër penale, për të cilën ligji parashikon dënim në maksimum jo më pak se 15 vjet me burgim;”.

26. Neni 151 § 4 i KPP-së në fuqi, në periudhën përkatëse parashikonte se mbledhja e provave në mënyrë të paligjshme nuk mund të përdorej në gjykatë, dhe një përjashtim i tillë, duke përfshirë edhe vet mocionin e gjykatës, mund të bëhej në çdo moment të procesit.

27. Neni 158 § 1 i KPP-së, në fuqi në periudhën përkatëse, parashikonte:

“Nuk janë të detyruar të dëshmojnë:

a) individët që janë në një lidhje të afërt gjaku me të pandehurin...”

28. Neni 296 § 1 i KPP-së, në fuqi më 1 gusht 2017, e bënte të detyrueshme praninë e një avokati gjatë marrjes në pyetje të një individi nën hetim nga një oficer i policisë gjyqësore. Në përputhje me të njëjtin parashikim, kur nuk mund të gjendet një avokat, ose kur avokati nuk ndjek marrjen në pyetje, prokurorit i kërkohet të caktojë një avokat të financuar nga shteti për të dyshuarin.

VLERËSIMI I GJYKATËS

I. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 6 §§ 1 DHE 3 (c) TË KONVENTËS

29. Kërkuari u ankua se dënimi i tij ishte mbështetur, midis të tjerash, në deklaratat e tij të datës 27 qershor 2004, që ishin marrë në mungesë të një avokati, në shkelje të të drejtave të tij për një gjykim të drejtë dhe për ndihmë juridike sipas nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) të Konventës.

A. Pranueshmëria

30. Kjo ankesë nuk është qartazi e pambështetur në fakte, sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës ose e papranueshme për ndonjë shkak tjetër. Për këtë arsye, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Meritat

31. Parimet e përgjithshme në lidhje me të drejtën për një avokat, për të heshtur, për privilegjin ndaj vetinkriminimit, për të hequr dorë nga e drejta për ndihmë juridike dhe për marrëdhënien e këtyre të drejtave ndaj drejtësisë së përgjithshme në proces sipas aspektit penal të nenit 6 të Konventës mund të gjenden, midis të tjerash, në vendimin *Ibrahim dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* ([DHM], nr.



50541/08 dhe 3 të tjerë, §§ 249–74, 13 shtator 2016); *Simeonovi kundër Bullgarisë* ([DHM], nr. 21980/04, §§ 110–20, 12 maj 2017); dhe *Beuze kundër Belgjikës* [DHM], nr. 71409/10, §§ 119–50, 9 nëntor 2018).

1. Nëse kërkuesi hoqi dorë nga e drejta e tij për ndihmë juridike

32. Gjykata ka vendosur se në mënyrë që të pretendohet për heqje dorë nga e drejta për këshillim për të respektuar standardin e “dijenisë dhe inteligjencës”, kërkuesi duhet të bëhet me dije për të drejtat e tij (shih *Ibrahim dhe të Tjerë*, § 272, dhe *Simeonovi*, § 115, të dy cituar më sipër).

33. Gjykata thekson se detyrimi i autoriteteve sipas ligjit vendas për t’i pajisur të pandehurit me “letrën e të drejtave”, që përmban informacione për të drejtat e tyre, duke përfshirë të drejtën e tyre për të heshtur dhe për të pasur një avokat të përzgjedhur prej tyre ose ndihmë juridike falas me përmbushjen e disa kushteve, hyri në fuqi vetëm më 1 gusht 2017 (shih paragrafin 23 më sipër). Për këtë arsye, kërkuesi nuk u pajis me “letrën e të drejtave” përpara seancës së parë të marrjes në pyetje.

34. Në vijim, Gjykata vëren se kërkuesi ishte vënë në dijeni në lidhje me nenin 158 të KPP-së (shih paragrafët 6 dhe 27 më sipër) për të drejtën e tij për të mos dëshmuar ndaj një personi me të cilin kishte lidhje, më konkretisht me kushëririn e tij E., dhe në po të njëjtën fjalë, kërkuesi ishte vënë në dijeni për të drejtën e tij “për të dhënë shpjegime ose për të mos e bërë këtë gjë” (shih paragrafin 6 më sipër). Është e dyshimtë nëse ky formulim ishte mjaftueshëm i qartë që kërkuesi të kuptonte se kishte të drejtën për të heshtur në lidhje me akuzat ndaj tij.

35. Teksa kërkuesi u informua, edhe pse në mënyrë të përmbledhur, për “të drejtën e tij për një avokat”, nuk ishte e qartë nëse bëhej fjalë për një avokat të përzgjedhur prej tij, apo për një avokat të garantuar nga autoritetet falas. Si përgjigje ndaj kësaj, kërkuesi deklaroi se ai nuk kishte një avokat dhe se do t’i kërkonte babait të tij që të siguronte një avokat më vonë (shih paragrafin 6 më sipër). Sipas këndvështrimit të Gjykatës, mbetet e dyshimtë nëse kjo përgjigje provonte zgjedhjen me dijeni të të pandehurit për të hequr dorë nga e drejta e tij për këshillim, apo nëse ajo reflektonte faktin se në praktikë ai e kishte të pamundur për të marrë ndihmë juridike sipas zgjedhjes së tij në atë moment specifik.

36. Gjykata nuk anashkalon faktin se në periudhën konkrete neni 49 § 2 i KPP-së

parashikonte për një përfaqësim juridik të detyrueshëm vetëm për të miturit, apo se përfaqësimi i detyrueshëm për veprat penale me një dënim minimal prej pesëmbëdhjetë vitesh hyri në fuqi vetëm më 1 gusht 2017 (shih paragrafin 25 më sipër). Në periudhën e marrjes së tij në pyetje, kërkuesi sapo kishte mbushur tetëmbëdhjetë vjeç dhe kishte arsim të kufizuar dhe asnjë eksperiencë profesionale. Ai po përballej me një dënim me njëzet vite burgim ose me burgim të përjetshëm (shih paragrafin 22 më sipër), dhe është i dyshimtë fakti nëse ai mund të parashikonte pasojat e pretendimit për heqjen dorë nga e drejta e tij për ndihmë juridike (shih *Simeonovi*, cituar më sipër, § 115, me referenca të tjera). Gjykata vëren se gjykata fillestare apo gjykatat në proceset e mëpasshme nuk u përfshinë me problematikat e mësipërme, pavarësisht kundërshtimeve specifike të kërkuesit në apel (shih *Rodionov kundër Rusisë*, nr. 9106/09, § 167, 11 dhjetor 2018, për detyrimin e gjykatës vendase për të shqyrtuar rrethanat në lidhje me heqjen dorë të një të pandehuri nga të drejtat e tij për mbrojtje). Në fakt, ato u mbështetën ekskluzivisht dhe pa bërë hetime të tjera në procesverbalin e datës 27 qershor 2004, dhe në faktin se ai nuk kishte kërkuar shprehimisht për një avokat pasi ishte konstatuar se ai kishte hequr dorë nga e drejta e tij për ndihmë juridike (shih, veçanërisht, paragrafin 21 më sipër).

37. Në lidhje me sa është konstatuar në paragrafin 35 më lart, Gjykata nuk mund të arrijë në përfundimin se gjykatat vendase kanë vendosur në një mënyrë bindëse nëse heqja dorë e kërkuesit për ndihmë juridike ishte bërë në mënyrë vullnetare ose jo (shih *Bozškaya kundër Turqisë*, nr. 46661/09, §§ 49–51, 5 shtator 2017). Duke qenë se kërkuesi nuk ishte informuar se ai mund t’i kërkonte autoriteteve që të siguronin një avokat për të, Gjykata nuk mundet t’i japë një peshë vendimtare faktit se ai nuk e bëri këtë kërkesë në rrethanat e çështjes.

38. Në këtë mënyrë, Gjykata vendos se e drejta e kërkuesit për ndihmë juridike ishte kufizuar.

2. Nëse ekzistonin “arsye bindëse” që justifikonin kufizimin

39. Gjykata thekson se kufizimet për të pasur një avokat për arsye bindëse, në fazën paraprake lejohen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, duhet të jenë të një natyre të përkohshme dhe duhet të mbështeten në një vlerësim individual të rrethanave specifike të çështjes (shih *Simeonovi*, § 130, cituar më sipër).



40. Qeveria nuk ka provuar ekzistencën e ndonjë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonte kufizimet ndaj të drejtës së kërkuesit. Rrjedhimisht, kufizimet konkrete nuk justifikoheshin mbështetur në ndonjë arsye bindëse.

3. Drejtësia e përgjithshme e procedurave

41. Në vijim, Gjykata duhet të përcaktojë nëse pavarësisht kufizimit të së drejtës së kërkuesit për një avokat, gjë që krijon prezumimin se procedurat nuk ishin të drejta sipas interpretimit të nenit 6 § 1 të Konventës (shih *Ibrahim dhe të Tjerë*, cituar më sipër, § 273, dhe *Schmid-Laffer kundër Zvicrës*, nr. 41269/08, §§ 36–40, 16 qershor 2015), ekziston arsyeja për të vendosur se procesi në tërësi ishte i drejtë. Përgjegjësia bie mbi qeverinë që të provojë bindshëm se përse, në mënyrë përjashtimore dhe në rrethanat specifike të çështjes, drejtësia e përgjithshme e gjykimit nuk ishte paragjykuar në mënyrë të pakthyeshme nga kufizimi i dhënies së këshillimit juridik (shih *Ibrahim dhe të Tjerë*, §§ 264–65, dhe *Simeonovi*, § 118, të dy cituar më sipër), dhe sipas parimeve të përcaktuara në vendimin *Ibrahim* (§274).

42. Qeveria nuk bëri asnjë parashtrim në lidhje me sa më sipër.

43. Tashmë Gjykata ka vlerësuar se kërkuesi sapo kishte mbushur tetëmbëdhjetë vjeç dhe kishte pasur arsim të kufizuar dhe asnjë eksperiencë profesionale, gjithashtu, ajo tashmë ka konstatuar se ai nuk u informua në mënyrën e duhur për të drejtat për ndihmë juridike dhe për të heshtur (shih paragrafët 39 dhe 40 më sipër).

44. Gjithashtu, Gjykata vëren se deklarata e kërkuesit e datës 27 qershor 2004, ishte pranuar si provë përpara gjykatave vendase dhe se ishte vlerësuar prej tyre si e rëndësishme për çështjen. Gjykatat vendase konfirmuan bashkëpunimin e kërkuesit me E. kryesisht mbështetur në deklaratat dhënë nga dy të miturit, por gjithashtu ato e vlerësuan deklaratën e datës 27 qershor 2004 të rëndësishme për të vërtetuar disa zhvillime të caktuara përpara dhe pas të shtënave me armë. Në të vërtetë, Gjykata e Rrethit rezultoi se i dha shumë rëndësi faktit se kërkuesi kishte qenë i pranishëm dhe e kishte “shoqëruar” E. në planifikimin e vrasje, si edhe përshkrimin të detajuar të kërkuesit në deklaratat e tij të datës 27 qershor 2004 të rrethanave në të cilat ai kishte kaluar kohë me E. (shih paragrafin 16 më sipër). Kërkuesi kërkoi në mënyrë të vazhdueshme që deklaratat e tij të datës 27

qershor të hiqeshin nga dosja e çështjes, por gjykatat vendase e rrëzuan kërkesën e tij (shih paragrafin 13 më sipër). Kjo gjë sugjeron edhe se gjykatat vendase i konsideronin deklaratat e kërkuesit të datës 27 qershor 2004 si të rëndësishme për çështjen.

45. E drejta e kërkuesit për të mos u dënuar në mbështetje të deklaratave të tij dhënë pa ndihmë juridike nuk kufizohet në rrëfime konkrete apo në vërejtjet që janë drejtpërdrejtë inkriminuese; pasi në mënyrë që deklaratat të konsiderohen si vetëinkriminuese, është e mjaftueshme që ato të kenë ndikuar në mënyrë thelbësore në pozicionin e të akuzuarit (shih, *mutatis mutandis*, *Bjarki H. Diego kundër Islandës*, nr. 30965/17, § 58, 15 mars 2022). Në çështjen konkrete, edhe pse gjykatat kanë shqyrtuar prova të tjera të rëndësishme, qasja e autoriteteve ndaj hetimit dhe kualifikimi i veprimeve të kërkuesit janë ndikuar ndjeshëm nga deklaratat e detajuara prej tij më 27 qershor 2004, në lidhje me aktivitete e tij me E. përpara dhe pas vrasjes, dhe në këtë mënyrë kanë përbërë një pjesë integrale të provave mbi të cilat është mbështetur dënimi (shih *Sitnevskij dhe Chaykovskij kundër Ukrainës*, nr. 48016/06 dhe 7817/07, § 84, 10 nëntor 2016; *Mehmet Zeki Çelebi kundër Turqisë*; nr. 27582/07, § 71, 28 janar 2020; dhe *brus kundër Belgjikës*, nr. 18779/15, § 13, 14 shtator 2021).

46. Në këtë kontekst, qeveria nuk ka demonstruar, dhe as Gjykata nuk mund të arrijë në përfundimin, se drejtësia e përgjithshme e procesit nuk ishte paragjykuar nga deklaratat e bëra nga kërkuesi më 27 qershor 2004 në mungesë të një avokati.

47. Për këtë arsye, është shkelur neni 6 §§ 1 dhe 3 (c) i Konventës.

II. ANKESAT E TJERA

48. Kërkuesi u ankua edhe për faktin se mënyra me të cilën autoritetet kishin marrë në pyetje të miturit më 14 korrik 2004, dhe mënyra me të cilën ishin vlerësuar deklaratat e tyre nga gjykatat vendase, kishte shkaktuar shkelje të kërkesës për “gjykim të drejtë” sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Duke marrë në konsideratë faktet e çështjes, parashtrimet e palëve dhe konstatimet e saj si më lartë, Gjykata vlerëson se ajo ka trajtuar pyetjet kryesore juridike të ngritura nga çështja dhe se nuk është e nevojshme që të shqyrtohen ankesat e tjera (shih *Qendrën për Burime Juridike në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë* [DHM], nr. 47848/08, § 156, GJEDNJ 2014).



NENI 41 I KONVENTËS

A. Dëmi

49. Kërkuesi kërkoi 20,000 euro për dëmin jopasuror dhe nuk bëri asnjë kërkesë për dëm pasuror.

50. Qeveria parashtroi se kërkesa ishte e tepruar.

51. Gjykata nuk mund të spekulojë për rezultatin e procesit ndaj kërkuesit nëse nuk ka shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) të Konventës. Gjykata vlerëson se konstatimi i shkeljes përbën shpërblim mjaftueshëm të drejtë në çështjen konkrete. Për këtë arsye, ajo e rrezon kërkesën.

52. Megjithatë, forma më e përshtatshme e korrigjimit, në parim, do të ishte rihapja e procesit, nëse kjo gjë do të kërkohet.

B. Kostot dhe shpenzimet

53. Kërkuesi kërkoi 300,000 lekë (afërsisht 2,400 euro) për kostot dhe shpenzimet e bëra gjatë procesit në gjykatat vendase, dhe 3,710 euro për kostot e bëra në Gjykatë. Përfaqësuesi i tij paraqiti dy fatura të detajuara të nënshkruara prej tij dhe deklaroi se për shkak të rrethanave të vështira financiare të kërkuesit, ai nuk i kishte kërkuar kërkuesit të bënte parapagesë (shih paragrafin 10 më sipër).

54. Qeveria i kundërshtoi të dyja kërkesat.

55. Për shkak të mungesës së dokumenteve mbështetëse të nënshkruara nga kërkuesi dhe duke treguar se ai kishte ndërmarrë detyrimin për të paguar avokatin e tij, për këtë pjesë nuk u bë asnjë akordim.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. E deklaron kërkesën të pranueshme;

2. Gjykon se është shkelur neni 6 §§ 1 dhe 3 (c) i Konventës;

3. Gjykon se nuk është e nevojshme që të shqyrtohen meritat e ankesave të tjera;

4. Rrezon pretendimin e kërkuesit për shpërblim të drejtë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 14 nëntor 2023, sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

KRYETAR

Georgios A. Serghides

ZËVENDËSSEKRETARE

Olga Chernishova

VENDIM

Nr. 62, datë 20.11.2023

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | |
|---------------------|-----------|
| Holta Zaçaj | kryetare; |
| Marsida Xhaferllari | anëtare; |
| Fiona Papajorgji | anëtare; |
| Elsa Toska | anëtare; |
| Sonila Bejtja | anëtare; |
| Sandër Beci | anëtar; |
| Marjana Semini | anëtare; |
| Illir Toska | anëtar, |

me sekretare Blerina Basha, në datat 10.10.2023 dhe 6.11.2023, mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 3 (K) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, i përfaqësuar nga Erida Skëndaj, me autorizim.

- Civil Rights Defender, dega Tiranë, i përfaqësuar nga Erida Skëndaj, me deklaram në seancë.

- Këshilli Shqiptar i Medias, i përfaqësuar nga Erida Skëndaj, me deklaram në seancë.

- Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT, të përfaqësuar nga Erida Skëndaj, me prokurë të posaçme.

Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative, Shqipëri – Ballkan, i përfaqësuar nga Erida Skëndaj, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Mimoza Arbi, me autorizim, Këshilli i Ministrave, i përfaqësuar nga avokatja e shtetit Irma Qosja, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i pikës 2, të nenit 5, për sa i përket delegimit të dhënë Këshillit të Ministrave; nenit 8; fjalëve “ose me emra që janë në kundërshtim me rendin ose me dispozitat urdhëruese të ligjit”, në pikën 1, të nenit 9; shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 17; shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 20; neneve 26, 28, pika 6 dhe 32, që lidhen me pozitën e kancelarit; fjalëve “kancelari/ose kancelari” në nenet përkatëse ku përcaktohen; pikës 1 të nenit 29; pikave 1 dhe 2, të nenit 36; pikave 2–6 të nenit 49; pikës 5, të nenit 50, të ligjit nr. 80/2021, datë 24.5.2021, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, si të



papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 18, 46, 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pikat 1, shkronja “h” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 11 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 28, 29, 30, 47, 49, 50 dhe 51, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi pretendimet e kërkuësve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) dhe Këshillit të Ministrave, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e opinionit *amicus curiae* të Avokatit të Popullit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), me ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar (*ligji nr. 8788/2001*), ka përcaktuar rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse, kurse me ligjin nr. 8789, datë 7.5.2001, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, të ndryshuar (*ligji nr. 8789/2001*) ka përcaktuar procedurat e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse, si dhe rregullat për mbajtjen e regjistrit të tyre (neni 1). Sipas këtij ligji, rregullat për formën e organizimit, të themelimit, të veprimtarisë dhe të funksionimit të organizatave jofitimprurëse përcaktohen me ligj (neni 2). Në nenin 3 të tij parashikohet se shoqatat, fondacionet dhe format e tjera të organizatave jofitimprurëse, që mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe fitojnë cilësinë e personit juridik vetëm pas regjistrimit në gjykatë, caktohen shprehimisht me ligj, kurse sipas nenit 4, regjistri i organizatave jofitimprurëse mbahet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Në vitin 2021 Kuvendi, në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1 dhe 83, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, ka miratuar ligjin nr. 80/2021, datë 24.6.2021, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse” (*ligji nr. 80/2021*). Ky ligj ka për objekt përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe rregullat për mbajtjen e regjistrit për organizatat jofitimprurëse, që kanë detyrimin për të regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, i cili përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e tyre (neni 1). Kurse qëllimi i ligjit është të lehtësojë procedurat e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse, duke krijuar një mjedis transparent dhe mundësues për zhvillimin e veprimtarisë së tyre (neni 2). Ligji nr. 80/2021 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 121, datë 2.8.2021 dhe ka hyrë në fuqi më 17.8.2021.

3. Referuar dispozitave të fundit të këtij ligji, të përfshira në kreun VII të tij, ai ka ndryshuar pikën 1 të nenit 22 të ligjit nr. 8789/2001 dhe ka shtuar, pas nenit 39 të atij ligji, kreun VII/1 “Kundërvajtjet administrative” (neni 51). Po kështu, neni 50, pika 1, ka parashikuar regjimin tranzitor, sipas të cilit deri në fillimin e funksionimit të regjistrit elektronik, procedurat e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse kryhen sipas parashikimeve të ligjit nr. 8789/2001. Neni 53 i ligjit nr. 80/2021 parashikon se: “Në datën e fillimit të funksionimit të regjistrit elektronik, ligji nr. 8789, datë 7.5.2001, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse” dhe aktet ligjore e nënligjore që bien në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen”, kurse sipas nenit 52, pika 3, dita e fillimit të funksionimit të regjistrit elektronik caktohet me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KLGF*), jo më vonë se data 30.8.2021.

4. Në zbatim të dispozitës së mësipërme, me vendimin nr. 35, datë 26.1.2022 (*vendimi nr. 35/2022*) *KLGF*-ja, ka vendosur: “1. Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë krijohet Regjistri Elektronik i Organizatave Jofitimprurëse. 2. Funksionimi i regjistrit elektronik fillon në datën 30 dhjetor 2023”.

5. Në mbështetje të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 80/2021 dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore” (*ligji nr. 10325/2010*), Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 94, datë 9.2.2022, “Për miratimin e rregullave të detajuara për të dhënat parësore dhe dytësore, që regjistrohen në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse, për dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të



dhënave, si dhe për nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara” (VKM nr. 94/2022), i cili ka si objekt përcaktimin e rregullave të detajuara për të dhënat parësore dhe dytësore që regjistrohen në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse, për dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave, si dhe për nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse. Sipas pikës 3, regjistri elektronik i organizatave jofitimprurëse krijohet nga KLGJ-ja dhe administrohet e mirëmbahet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me parimet, kriteret e masat tekniko-organizative të zbatueshme për garantimin dhe menaxhimin e sigurisë në përpunimin e të dhënave personale, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Sipas pikës 5, regjistri elektronik përmban të dhëna që lidhen me themelimin, fushën e veprimtarisë dhe çregjistrimin e organizatave jofitimprurëse, çdo ndryshim në status dhe formën e organizimit të tyre, të dhëna që u përkasin atyre lidhur me përfaqësimin, si dhe të dhëna të tjera të parashikuara me ligj, duke i specifikuar ato në vijim. Po kështu, VKM-ja nr. 94/2022, ka përcaktuar bazat e tjera të të dhënave me të cilat ndërvepron ky regjistër (pika 10); cilët janë dhënësit e informacionit dhe subjektet e interesuara (pikat 11 dhe 12); nivelin e aksesit në sistemin dhe bazën e të dhënave të regjistrit elektronik (pika 13).

6. Në datën 17.1.2023, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), Civil Rights Defender, dega Tiranë (CRD), Këshilli Shqiptar i Medias (KSHM), Aleanca kundër Diskriminimit LGBT (Aleanca LGBT), Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative Shqipëri- Ballkan, (BIRN Albania) (kërkesit), i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë sipas objektit të saj, e cila, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 10.2.2023.

7. Kolegji i Gjykatës, në mbledhjen e datës 13.3.2023, bazuar në nenin 31, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit, me vendimin e datës 6.4.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike, duke përcaktuar subjektet e interesuara që do të thirren në gjykim, si edhe që të kërkohet mendim me shkrim nga Avokati i Popullit. Ky i fundit, edhe pse është njoftuar rregullisht nga

Gjykata, nuk ka paraqitur mendim *amicus curiae* në lidhje me këtë çështje.

II

Pretendimet e kërkuessve

8. **Kërkuessit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se dispozitat ligjore të kundërshtuara cenojnë këto të drejta dhe parime kushtetuese:

8.1. *Të drejtën kushtetuese për t'u organizuar, të parashikuar në nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 11 të KEDNJ-së*, në kundërshtim me kriteret e ndërhyrjes të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës, pasi nuk respektohet kufizimi me ligj në aspektin substancial. Organizatat luajnë rol kyç për arritjen e objektivave në interes të publikut dhe janë aktorë të rëndësishëm për promovimin, mbështetjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe zbatimin e angazhimeve që rrjedhin nga dokumentet ndërkombëtare. Udhëzuesi i përbashkët i Komisionit të Venecias dhe OSBE/ODHIR-it “Për të drejtën dhe lirinë e organizimit” ka evidentuar 11 parime për garantimin dhe promovimin e kësaj të drejte. Sipas tij, duhet të njihet një prezumim në favor të formimit të organizatës dhe ligjshmërisë së themelimit, statutit, qëllimeve, objektivave e veprimtarisë dhe çdo kufizim i së drejtës për t'u organizuar, duke përfshirë sanksionet, duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare, i parashikuar nga ligji dhe duhet të ketë një qëllim legjitim. Ligji duhet të jetë i përpiktë, i sigurt dhe i parashikueshëm, në veçanti për parashikimet që u njohin diskrecion autoriteteve shtetërore dhe kufizimet, duke përfshirë sanksionet, duhet të jenë proporcionalë me qëllimin që synohet të arrihet.

8.2. Delegimi që bën neni 5, pika 2, i ligjit për Këshillin e Ministrave krijon paqartësi dhe pasiguri lidhur me të dhënat që mbahen për organizatën dhe aksesin në këto të dhëna nga persona të tretë, ndërkohë që këto rregulla duhet të parashikoheshin nga vetë ligji në mënyrë shteruese. Delegimi nuk përmbush kërkesën që legjislacioni për regjistrimin, mbajtjen e të dhënave të organizatave jofitimprurëse (OJF) dhe aksesin në këto të dhëna të jetë i qartë dhe të mos krijojë hapësirë për ndërhyrje të papërshtatshme.

8.3. Po kështu, formulimi i nenit 8 e bën të detyrueshëm regjistrimin, duke nënkuptuar se nëse organizata jofitimprurëse nuk regjistrohet brenda 30 ditëve nga themelimi, ajo do të konsiderohet e



paligjshme dhe mund t'u nënshtrohet sanksioneve ligjore sipas nenit 49 të po këtij ligji. Sipas standardeve ndërkombëtare, legjislacioni duhet të njohë si organizatat formale, ashtu edhe ato informale ose të paktën t'i lejojë të veprojnë pa i konsideruar të paligjshme. Ai nuk duhet t'i detyrojë ato për të fituar personalitet juridik, por duhet të krijojë mundësinë për ta bërë këtë.

8.4. Fjalët “në kundërshtim me rendin” në pikën 1 të nenit 9 të ligjit nuk kanë një kuptim të qartë dhe të përcaktuar, duke lënë hapësirë dhe diskrecion për autoritetet, të cilat mund ta keqpërdorin për të refuzuar regjistrimin e një organizate në mënyrë të padrejtë, ndërkohë që parashikimi ndalues duhet të jetë i qartë dhe shterues.

8.5. Kërkesat e përcaktuara në nenin 17, pika 3, shkronja “a”, të ligjit, në veçanti ajo për pasqyrat financiare vjetore, krijojnë barrë për OJF-në dhe mund të krijojnë pengesë për lehtësimin dhe promovimin e së drejtës për t'u organizuar. Sipas standardeve ndërkombëtare burimet e marra nga organizata në mënyrë të ligjshme mund të jenë subjekt i kërkesave për raportime dhe transparencë, megjithatë nuk duhet të krijojnë një barrë të tepërt dhe të panevojshme dhe duhet të jenë në raport me madhësinë e organizatës dhe fushën e veprimtarisë, duke marrë në konsideratë vlerën, asetet dhe të ardhurat.

8.6. Neni 20, pika 2, shkronja “c”, i ligjit bën referencë në ligje të tjera në mënyrë të papërcaktuar dhe të paqartë, çka krijon pasiguri ligjore dhe mund të krijojë hapësirë për ndërhyrje të papërshtatshme në lirinë e organizimit.

8.7. Edhe parashikimet e neneve 26, 28, pika 6 dhe 32, të ligjit, ku përcaktohet kompetenca e kancelarit, nuk përmbushin garancitë dhe standardet ndërkombëtare, pasi ai nuk është autoritet vendimmarrës, i pavarur dhe i paanshëm.

8.8. Përmbajtja e nenit 29, pika 1, i ligjit, ka natyrë ngushtësisht formale dhe mund të çojë në pengesa në drejtim të lirisë së organizimit. Ligji nuk bën dallim midis kërkesave thelbësore për regjistrim, me natyrë serioze, dhe kërkesave të tjera me natyrë formale dhe jo të domosdoshme. Për më tepër, diskrecioni i pezullimit nuk mund t'i atribuohet kancelarit si një nëpunës gjyqësor, i cili nuk është një autoritet vendimmarrës i pavarur dhe i paanshëm, por duhet të jetë atribut ekskluziv i gjykatës.

8.9. Regjistrimi i njëkohshëm, i parashikuar në nenin 36, pikat 1 dhe 2, të ligjit duke qenë një

regjistrim i detyrueshëm, mund të përbëjë një barrë të parakohshme për organizatën, duke pasur parasysh të dhënat e detyrueshme që duhet të deklarohen sipas legjislacionit tatimor, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe atij të statistikave. Ky rregull, në vend që të jetë lehtësues, mund të kthehet në frenues për regjistrimin dhe ushtrimin në mënyrë të lirë të veprimtarisë së organizatave.

8.10. Përcaktimi në nenin 49 të ligjit se masa e gjobës nuk mund të jetë më e vogël se 30.000 lekë nuk e kufizon tavanin maksimal të saj, duke e lidhur me 1% të të ardhurave vjetore të organizatës. Ky formulim nuk përmbush kërkesat e qartësisë dhe të sigurisë juridike në formulimin dhe përcaktimin e sanksioneve ligjore dhe parashikimi në këto dispozita i kancelarit si autoriteti për vendosjen e gjobës, nuk përmbush kërkesat për pavarësi dhe paanshmëri të organit vendimmarrës.

8.11. Parashikimi i nenit 50, pika 5, të ligjit, përforcon edhe më shumë argumentet për kundërshtimin e nenit 8 të tij, lidhur me detyrimin për t'u regjistruar. Përveç sanksioneve të parashikuara, ai përcakton edhe një masë ekstreme, çregjistrimin e organizatës jofitimprurëse.

8.12. *Parimin e barazisë para ligjit, të parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës*, pasi neni 49, pikat 2 deri 6, të ligjit, duke e lidhur masën e gjobës me të ardhurat vjetore të deklaruara nga organizata, për të njëjtën shkelje parashikojnë masa të ndryshme gjobe, në varësi të të ardhurave vjetore.

9. Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, në prapësimet e tij ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

A) Për legjitimitimin e kërkuarve

9.1. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae* kërkuar nuk kanë argumentuar dëmin konkret dhe real të pësuar nga dispozitat e kundërshtuara në të drejtën kushtetuese për t'u organizuar të lidhur me sigurinë juridike, jetën private dhe barazinë. Pretendimet e tyre nuk janë konkrete, por bazohen në arsye teorike, çka konstatohet edhe nga përdorimi i fjalës “mund” në kërkesë, ndërkohë që mundësia ose jo e ardhjes së pasojave nuk përbën shkak për të provuar legjitimitimin në drejtim të interesit. Edhe për pretendimet për cenimin e grupeve informale nuk është arritur të provohet interesi i drejtpërdrejtë dhe vetjak, nisur nga fakti se kërkuar janë organizata të regjistruara në gjykatë.



B) Për themelën e pretendimeve

9.2. Në lidhje me cenimin e së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme për zbatim, aktet e Këshillit të Evropës dhe OSBE/ODHIR-it nuk janë të detyrueshme për zbatim dhe ato nuk mund të përdoren si bazë për shfuqizimin e një ligji.

9.3. Pretendimet për cenimin e së drejtës për t'u organizuar, në kundërshtim me kriteret e ndërhyrjes sipas nenit 17 të Kushtetutës, janë të pabazuara. Parashikimi i nenit 5, pika 2, të ligjit nr. 80/2021, është i lidhur me rolin që ka Këshilli i Ministrave sipas ligjit nr. 10325/2010, pasi regjistri elektronik i një organizate jofitimprurëse është një bazë e të dhënave shtetërore që krijohet me ligjin nr. 80/2021. Në vijim, ligji nr. 10325/2010, përcakton administrimin e bazës së të dhënave shtetërore (neni 5), të dhënat parësore dhe dytësore (neni 7) dhe rregullat bazë të koordinimit (neni 8). Ndërsa neni 10 parashikon se procedurat dhe rregullat e detajuara që lidhen me të dhënat shtetërore miratohen nga Këshilli i Ministrave.

9.4. Referuar nenit 8 të ligjit nr. 80/2021, detyrimi për regjistrim zbatohet vetëm për ato organizata të parashikuara shprehimisht me ligj dhe jo të gjitha llojet e organizatave. Për më tepër, ligji ka lejuar një afat 30-ditor të përshtatshëm për përgatitjen e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, duke pranuar kështu edhe sugjerimet e grupeve të interesit gjatë hartimit të tij. Për rrjedhojë, detyrimi brenda një afati të caktuar respekton parimin e sigurisë juridike.

9.5. Termi “rend” në nenin 9 të ligjit është i përcaktuar në gjuhën shqipe dhe atë juridike dhe ky rregullim synon të ndalojë përdorimin e emrave që cenojnë veprimtarinë e një shoqërie, rregullin shoqëror e qytetar dhe tërësinë e rregullave për të mbajtur dhe mbrojtur qetësinë, rregullin dhe moralin në marrëdhëniet shoqërore e qytetare, parashikim që gjendet edhe në ligje të tjera. Vlerësimi nëse emri i organizatës është në kundërshtim me rendin vlerësohet nga gjyqtari, duke u siguruar garancia maksimale.

9.6. Kurse në lidhje me nenin 17, pika 3, shkronja “a”, të ligjit nr. 80/2021, kërkuesit nuk kanë arritur të provojnë pasojat reale, të drejtpërdrejta dhe të verifikueshme që vijnë nga ky parashikim ligjor. Për më tepër, detyrimi i OJF-ve për të hartuar dhe mbajtur pasqyrat financiare buron nga ligji nr. 25/2018, datë 10.5.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” (ligji nr. 25/2018), ndaj

publikimi i tyre nuk përbën barrë të rëndë dhe të papërballueshme.

9.7. Referimi në nenin 20, pika 2, shkronja “g”, të ligjit, ka natyrë të përgjithshme dhe lidhet me diskrecionin që ka ligjvënësi për të parashikuar me ligj të posaçëm rastet kur një OJF mund të çregjistrohet. Një përkufizim i tillë gjendet edhe në ligjin nr. 9754, datë 14.6.2007, “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë” dhe ligjin nr. 110/2016, “Për falimentimin”, që zbatohet për çdo person juridik, përfshirë edhe OJF-të, përderisa ky lloj organizimi nuk parashikohet edhe si rast përjashtimor.

9.8. Në lidhje me pretendimet për nenet 26, 28, pika 6 dhe 32, të ligjit, që kanë të bëjnë me kompetencat e kancelarit, kërkuesit nuk kanë arritur të analizojnë normat juridike që kanë të bëjnë me emërimin e kancelarit dhe shkarkimin e tij, megjithëse ligji nr. 98/2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 98/2016) ka garantuar pavarësinë dhe paanësinë e tij. Qëllimi i ligjvënësit në rastin konkret ka qenë efektiviteti i procesit, ulja e barrës së procedurës gjyqësore, lehtësimi i veprimeve etj.

9.9. Edhe pretendimi për nenin 29 të ligjit nuk qëndron, pasi këto raste janë përcaktuar në mënyrë taksative dhe kanë të bëjnë me mungesën e elementeve të anës formale të kërkesës, parashikim që gjendet edhe në ligje të tjera.

9.10. Rregullimi i nenit 36, pikat 1 dhe 2, të ligjit, synon lehtësimin e veprimtarisë së organizatave, duke mundësuar zhvillimin e dy procedurave për regjistrim në të njëjtin moment. Referuar parashikimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore” (ligji nr. 9920/2008), OJF-të kanë pasur detyrim që menjëherë pas regjistrimit në gjykatë të bënë regjistrimin në organet tatimore. Ndërkohë që pretendimi i kërkuesve se ky regjistrim mund të sjellë evazion fiskal nuk ka bazë ligjore.

9.11. Edhe në lidhje me nenin 50, pika 5, të ligjit, pretendimi i kërkuesve është i paanalizuar dhe vjen në kundërshtim me detyrimin ligjor që ato kanë për të kryer këtë regjistrim.

9.12. Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë para ligjit, nga përmbajtja e nenit 49, pikat 2-6, të ligjit, është i pabazuar, pasi parashikimet e kësaj dispozite respektojnë parimin e proporcionalitetit dhe janë në përputhje me nenin 10, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet



administrative” (*ligji nr. 10279/2010*), i cili parashikon se masa e dënimit mund të jetë fikse ose e përcaktuar me kufij minimalë dhe maksimalë. Në çdo rast i takon gjykatës të zbatojë pikën 2 të atij neni. Nga ana tjetër, masa e dënimit nga 0.1% deri në 1% është proporcionale dhe nuk mund të konsiderohet e ekzagjeruar. Ajo garanton parimin e barazisë, pasi zë të njëjtën peshë për të gjitha subjektet dhe dënimi nuk matet nga vlera sasiore, por përqindja reale që zë në secilën organizatë.

10. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, ka prapësuar si vijon:

A) Për legjitimitimin e kërkesve

10.1. Kërkesit nuk kanë provuar lidhjen dhe interesin e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin janë krijuar ose veprimtarisë që kryejnë dhe pasojave negative të ardhura ose të pritshme që rrjedhin nga dispozitat e kundërshtuara. Pretendimet e tyre nuk janë ngritur në nivel kushtetues, duke mos arritur të argumentojnë mënyrën se si këto dispozita cenojnë lirinë e organizimit.

B) Për themelin e pretendimeve

10.2. *Pretendimet për cenimin e lirisë së organizimit janë të pabazuara.* Në lidhje me nenin 5, pika 2, të ligjit nr. 80/2021, kërkesit nuk kanë argumentuar se si delegimi për Këshillin e Ministrave prek interesat e tyre ose cenon këtë liri. Në bazë të autorizimit ligjor është miratuar VKM-ja nr. 94/2022, e cila ka detajuar elementet që duhet të përmbajë regjistri elektronik. Kërkesit nuk kanë argumentuar se si ky delegim krijon paqartësi dhe pasiguri lidhur me të dhënat që mbahen për organizatën dhe aksesin te këto të dhëna nga të tretët dhe se si ky delegim krijon hapësirë për ndërhyrje të papërshtatshme. Nisur nga fakti se regjistri elektronik krijohet si bazë e të dhënave shtetërore, këto të fundit rregullohen nga ligji nr. 10325/2010, i cili e ka lënë në diskrecion të ligjvënësit të vendosë nëse kjo bazë do të krijohet me ligj ose VKM.

10.3. Për sa i përket nenit 8 të ligjit, ai nuk lë hapësirë për interpretim lidhur me fushën e zbatimit, duke iu referuar vetëm organizatave që sipas ligjit nr. 8788/2001, kanë detyrimin për regjistrim. Edhe referuar standardeve të OSBE/ODHIR-it për fitimin e personalitetit juridik, shoqata mund të informojë autoritetet për formimin e saj dhe të kalojë një proces formal që përfshin regjistrimin. Përderisa Kushtetuta parashikon regjistrimin e organizatave jofitimprurëse dhe ligji nr. 8788/2001, përcakton cilat organizata e kanë këtë detyrim, ligji

nr. 80/2021, rregullon regjistrimin dhe parashikon sanksionet përkatëse për shkeljen e detyrimeve që burojnë nga ligji për OJF-të.

10.4. Për sa i përket konceptit të rendit publik në nenin 9 të ligjit, ai nuk është shterues dhe interpretohet rast pas rasti, duke qenë një term që gjendet edhe në ligje të tjera. Kërkesit nuk kanë sjellë asnjë shembull se si ky togfjalësh mund të interpretohet në mënyrë të ndryshme nga ato të parashikuara nga vetë Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi, dhe ky pretendim gjen zgjidhje nëpërmjet interpretimit pajtues.

10.5. Në lidhje me nenin 17, pika 3, shkronja “a”, të ligjit, organizatat jofitimprurëse kanë të drejtë të kryejnë veprimtari ekonomike me qëllim nxjerrjen e të ardhurave, me kusht që kjo të mos përbëjë qëllimin parësor. Këto organizata janë subjekt i ligjit nr. 25/2018 dhe kanë detyrimin për të hartuar dhe mbajtur pasqyrat financiare, ndaj ky detyrim nuk buron nga ligji nr. 80/2021. Legjislacioni ka parashikuar lehtësi, në mënyrë që regjistrimi i pasqyrave financiare të mos përbëjë barrë të tepërt. Ato janë pjesë e dokumenteve financiare dhe të kontabilitetit dhe shërbejnë si bazë për llogaritjen e detyrimeve tatimore. Regjistrimi rrit standardin e ushtrimit të veprimtarisë së këtyre organizatave, duke i bërë më transparente dhe duke parandaluar korrupsionin.

10.6. Në nenin 20, pika 2, shkronja “g”, të ligjit, përdorimi i referencave në ligje të tjera i mundëson ligjvënësit sigurimin e koherencës ndërmjet akteve ligjore dhe nënligjore dhe nuk sjell pasiguri juridike, por garanton rregullimin e çështjes në përputhje me të gjithë legjislacionin. Në rastin konkret, referenca kryhet në akte ligjore dhe nuk lihet në diskrecion të organeve publike kompetente.

10.7. Kurse në lidhje me pretendimet për nenet 26, 28, pika 6 dhe 32, të ligjit, kompetencat e kancelarit të gjykatës janë parashikuar nga ligji nr. 98/2016 dhe nisur nga fakti se ato lidhen me procedura të thjeshtuara për depozitim të akteve, kanë qëllim të mos mbingarkojnë gjykatën me çështje për të cilat nuk nevojitet një shqyrtim i thelluar. Nga ana tjetër, regjistrimi nga ana e kancelarit sjell përfitime, pasi procesi realizohet në një periudhë kohore më të shkurtër. Për sa i përket paanshmërisë dhe pavarësisë së kancelarit, dispozitat ligjore në fuqi parashikojnë garancitë për heqjen dorë ose përjashtimin e tij nga shqyrtimi i kërkesës. Për rrjedhojë, argumentet e kërkesve nuk janë



ngritur në nivel kushtetues, duke mos argumentuar se si cenohet liria e organizimit.

10.8. Pretendimi për nenin 29 të ligjit është subjektiv dhe i paelaboruar, pasi as vetë kërkuesit nuk e kanë të qartë kuptimin dhe dallimin e kërkesave serioze nga ato formale. Në kuptim të ligjit nr. 80/2021 të gjitha kërkesat për regjistrim kanë të njëjtën rëndësi dhe synojnë pasqyrimin e saktë të të dhënave në regjistrin elektronik të organizatave. Pezullimi i kërkesës i lejon subjektit kërkues të plotësojë kërkesën me elementet e nevojshme sipas ligjit. Për sa i përket diskrecionit të kancelarit, ligji ka parashikuar një pozicion të njëjtë me gjyqtarin në drejtim të përgjegjësisë, paanshmërisë dhe pavarësisë së tij. Kushtet e parashikuara nga ligji lidhen me regjistrimin e organizatave dhe jo me organizimin e tyre, për rrjedhojë nuk e cenojnë këtë liri.

10.9. Pretendimi për nenin 36, pikat 1 dhe 2, të ligjit, është i pabazuar, pasi detyrimi për t'u regjistruar pranë administratës tatimore buron nga ligji nr. 9920/2008. Gjithashtu, ligji nr. 8788/2001 ka parashikuar detyrimin e organizatave jofitimprurëse të ruajnë të dhënat tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor dhe të kontrollohen prej organeve tatimore. Ligji nr. 80/2021 ka synuar lehtësimin e procedurës së regjistrimit, uljen e kostove dhe eliminimin e burokracive, duke parashikuar regjistrimin e njëkohshëm në administratën tatimore qendrore dhe vendore, në skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe pranë inspektoratit të punës. Ligjvënësi e ka parashikuar si shkelje administrative moszbatimin e detyrimit për regjistrim, ndërsa mospagimin e taksave dhe tatimeve si vepër penale.

10.10. Në lidhje me nenin 50, pika 5, kërkuesit nuk kanë sjellë asnjë argument, duke mos e ngritur në nivel kushtetues pretendimin e tyre. Detyrimi për regjistrimin në organizatën tatimore është detyrim ligjor dhe për më tepër jemi para një dispozite kalimtare që tashmë ka përmbytur efektet e saj.

10.11. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë para ligjit nga përmbajtja e nenit 49, pikat 2-6, argumentet nuk janë ngritur në nivel kushtetues, pasi kundërvajtjet dhe sanksionet administrative janë përcaktuar në përputhje me ligjin nr. 10279/2010, kurse mënyra e zbatimit të tyre nuk përbën juridiksion kushtetues. Përmes kësaj dispozite garantohet që e njëjta shkelje të marrë sanksionin e duhur administrativ, pa e lidhur atë me

një shumë fikse. Kjo sepse një gjobë me shumë fikse për një organizatë që ka burime të mëdha financimi, nuk ka të njëjtin efekt ndaj një tjetre me burime më të pakta, madje për këtë të fundit mund të përbëjë pengim në ushtrimin e veprimtarisë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesve

11. Çështjen e legjitimitimit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet e kushtëzuara, që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur.

12. Gjykata vëren se në nenin 131 të Kushtetutës janë parashikuar kompetencat e saj, mes të cilave edhe ajo për kontrollin e pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën (*pika 1, shkronja "a"*), ndërsa në nenin 134 parashikohen subjektet që mund ta vënë në lëvizje atë, ku përfshihen edhe organizatat (*pika 1, shkronja "b"*). Këto të fundit, sipas nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, mund të bëjnë kërkesë vetëm nëse provojnë interesin në lidhje me çështjen kushtetuese të ngritur. Përmbajtja e kësaj dispozite kushtetuese është zbrërthyer në nenin 49, të ligjit nr. 8577/2000, i cili në pikat 3, shkronja "d" dhe 4 parashikon se organizatat kanë detyrimin të provojnë në çdo rast se çështja lidhet drejtpërdrejt me të drejtat dhe liritë e parashikuara nga Kushtetuta ose me qëllimet e veprimtarisë së tyre.

13. Vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së saj dhe normës që kundërshton. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se interesi për të vepruar i subjekteve të kushtëzuara duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premisat teorike për antikushtetutshmërinë e normës që ka cenuar interesin. Vetëm fakti se dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë pasur një efekt çfarëdo për kërkuesin nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar



nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se ato rregullojnë marrëdhënie që përfshihen në qëllimin e veprimtarisë së tij, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*shih vendimet nr. 39, datë 15.12.2022; nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 20, datë 20.4.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Kërkuesit kanë parashtruar se ata legjitimohen t'i drejtohen Gjykatës, bazuar në nenin 134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës, pasi gëzojnë personalitet juridik dhe janë subjekte të ligjit nr. 80/2021, dispozitat e kundërshtuara të të cilit krijojnë hapësirë për ndërhyrje të papërshtatshme nga autoritetet shtetërore në ushtrimin në mënyrë të pavarur të veprimtarisë së këtyre organizatave dhe i pengojnë në përmbushjen e misionit të tyre dhe promovimin e mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

15. Në lidhje me kërkuesin KSHH-në, ai është regjistruar si person juridik me vendimin nr. 17/1, datë 12.1.1991, të ministrit të Drejtësisë dhe më pas me vendimin nr. 2/1, datë 19.7.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas këtyre vendimeve dhe përmbajtjes së nenit 2 të statutit, KSHH-ja është një organizatë jofitimprurëse që ka për qëllim dhe objekt të veprimtarisë, mes të tjerash, vëzhgimin e gjendjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të minoriteteve dhe të komuniteteve të tjera, si dhe zbatimin e parimeve të shtetit ligjor, denoncimin e çdo shkeljeje që bie ndesh me legjislacionin shqiptar dhe normat e së drejtës ndërkombëtare të njohura përgjithësisht etj.

16. Me vendimin nr. 3595, datë 30.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar si person juridik dega në Shqipëri e CRD-së, e cila, sipas nenit 1 të statutit, ka për qëllim të mbrojtë të drejtat civile dhe politike të individëve, në përputhje me aktin përfundimtar të Helsinkit të vitit 1975 dhe aktet e tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, si dhe të fuqizojë mbrojtësit vendorë dhe rajonalë të të drejtave të njeriut. Kurse në lidhjen me kërkuesin tjetër, KSHM-në, Gjykata vëren se ai është regjistruar si person juridik me vendimin nr. 5206, datë 11.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe referuar këtij vendimi, si edhe nenit 6, të statutit, qëllimi i veprimtarisë së shoqatës është, mes të tjerash, ruajtja dhe përmirësimi i lirisë së shprehjes dhe informimit, liria dhe pluralizmi i medias, lëvizja e lirë e informacionit dhe ideve dhe formimi i lirë i mendimeve etj.

17. Kërkuesi Aleanca LGBT është regjistruar si person juridik me vendimin nr. 567, datë 10.11.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe sipas nenit 3 të statutit, për të mbështetur vizionin e saj për një shoqëri të lirë, të hapur dhe të barabartë, shoqata përpiqet të mbështesë, fuqizojë dhe rrisë dukshmërinë e komuniteteve të homoseksualëve, biseksualët dhe transgjinerët, duke rritur ndërgjegjësimin dhe nivelin e informimit të publikut mbi çështjet e orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Kërkuesi tjetër, BIRN Albania, është një organizatë jofitimprurëse, e regjistruar si person juridik me vendimin nr. 554, datë 7.10.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, sipas neneve 5 dhe 6 të statutit, synon të ndihmojë në zhvillimin e gazetarisë investigative në Shqipëri, si edhe të promovojë dhe mbështesë lirinë e medias, të shprehjes dhe të informimit, etj.

18. Ligji nr. 80/2021 parashikon procedurat e regjistrimit dhe ato për mbajtjen e regjistrimit për organizatat jofitimprurëse që kanë detyrimin për t'u regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, që përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e tyre, me synimin për të lehtësuar procedurat e regjistrimit dhe për të krijuar një mjedis transparent dhe mundësues për zhvillimin e kësaj veprimtarie. Gjykata vëren se kërkuesit janë subjekte të ligjit nr. 80/2021, për sa kohë që regjistri elektronik, si bazë e të dhënave, përfshin edhe të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me organizatat e regjistruara tashmë sipas legjislacionit në fuqi, për rrjedhojë kërkuesit i nënshtrohen si regjistrimit fillestar (në kuptim të nenit 50 të ligjit) e në vijim edhe regjistrimeve të tjera, sipas kërkesave të tij, të fakteve, akteve dhe informacioneve të detyrueshme. Në këtë mënyrë, shoqatat kërkuese duhet të plotësojnë kërkesat e reja ligjore me qëllim vijimin e veprimtarisë së tyre. Po ashtu, kërkuesit kanë detyrimin që të organizohen dhe funksionojnë sipas legjislacionit në fuqi, përfshi rregullat e ligjit të kundërshtuar. Bazuar në këto konsiderata, Gjykata vlerëson se kërkuesit justifikojnë interesin e drejtpërdrejtë dhe vetjak në çështjen e parashtruar, në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja "h" dhe pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 3, shkronja "d", të ligjit nr. 8577/2000, ndaj legjitimohen *ratione personae*.

19. Në vijim, Gjykata, bazuar në nenin 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, çmon se kërkuesit legjitimohen *ratione temporis*, pasi kërkesa është



paraqitur brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e ligjit të kundërshtuar nr. 80/2021. Konkretisht, ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 121, datë 2.8.2021 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit, ndërsa kërkesa për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të dispozitave të tij është paraqitur në datën 17.1.2023, pra brenda afatit ligjor.

20. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkesit kanë pretenduar se dispozitat e kundërshtuara cenojnë të drejtën kushtetuese për t'u organizuar, të parashikuar në nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 11 të KEDNJ-së, në kundërshtim me kriteret e ndërhyrjes të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës, si edhe parimin e barazisë para ligjit, të parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës. Gjykata, duke çmuar se këto pretendime të kërkesve hyjnë në juridiksionin kushtetues, në vijim do të shqyrtojë bazueshmërinë e tyre në themel. Po kështu, bazuar në natyrën dhe thelbin e këtyre pretendimeve, ato në vijim do të analizohen në këndvështrim të lirisë së organizimit, e parashikuar nga neni 46 i Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

21. Kërkesit kanë pretenduar se duhet të njihet një prezumim në favor të formimit të organizatës dhe ligjshmërisë së themelimit, statutit, qëllimeve, objektivave e veprimtarisë dhe çdo kufizim i së drejtës për t'u organizuar, duke përfshirë sanksionet, duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare, i parashikuar nga ligji dhe duhet të ketë një qëllim legjitim. Ligji duhet të jetë i përpiktë, i sigurt dhe i parashikueshëm, në veçanti për parashikimet që u njohin diskrecion autoriteteve shtetërore dhe kufizimet, duke përfshirë sanksionet, duhet të jenë proporcionale me qëllimin që synohet të arrihet. Sipas kërkesve, parashikimet e dispozitave të kundërshtuara nuk përmbushin këto kërkesa, pasi krijojnë paqartësi dhe pasiguri dhe disa prej tyre nuk kanë një kuptim të qartë dhe të përcaktuar, duke lënë hapësirë dhe diskrecion për autoritetet. Ato krijojnë një barrë për organizatën jofitimprurëse dhe mund të krijojnë pengesë për lehtësimin dhe promovimin e së drejtës për t'u organizuar. Po kështu, ata kanë pretenduar edhe se parashikimet që u njohin kompetenca të caktuara kancelarit nuk përmbushin garancitë dhe standardet ndërkombëtare, pasi ai nuk është autoritet vendimmarrës, i pavarur dhe i paanshëm.

22. Sipas subjekteve të interesuara, Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave, pretendimet për cenimin e së

drejtës për t'u organizuar në kundërshtim me kriteret e ndërhyrjes sipas nenit 17 të Kushtetutës janë të pabazuara. Dispozitat e kundërshtuara respektojnë parimin e sigurisë juridike dhe ato nuk vendosin barrë të rëndë dhe të papërballueshme për organizatat. Ligji nuk krijon paqartësi dhe pasiguri lidhur me të dhënat që mbahen për organizatën dhe aksesin të këto të dhëna nga të tretët dhe as hapësirë për ndërhyrje të papërshtatshme. Dispozitat e kundërshtuara nuk lënë hapësira për interpretim dhe përdorimi i referencave në ligje të tjera i mundëson ligjvënësit sigurimin e koherencës ndërmjet akteve ligjore dhe nënligjore dhe nuk sjell pasiguri juridike, por garanton rregullimin e çështjeve në përputhje me të gjithë legjislacionin.

23. Kushtetuta në nenin 46 parashikon: *“1. Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm. 2. Regjistrimi në gjykatë i organizatave ose i shoqatave bëhet sipas procedurës së parashikuar me ligj. 3. Organizatat ose shoqatat që ndjekin qëllime antikushtetuese janë të ndaluara sipas ligjit.”*. Kjo dispozitë kushtetuese ka të bëjë me lirinë e organizimit kolektivisht, që përbën një prej lirive më të rëndësishme në një shoqëri demokratike. Liria e organizimit, si një liri negative e garantuar nga Kushtetuta, ka për qëllim dhënien e mundësisë shtetasve për t'u grumbulluar dhe organizuar të lirë dhe sipas preferencës për synime dhe objektiva të përbashkëta (*shih vendimet nr. 38, datë 9.12.2022; nr. 3, datë 5.2.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), referuar nenit 11 të KEDNJ-së, liria e organizimit është një e drejtë themelore në një shoqëri demokratike dhe ashtu si liria e shprehjes është një nga bazat e një shoqërie të tillë. Aftësia për të formuar një person juridik për të vepruar kolektivisht në një fushë me interes të ndërsjellë është një nga aspektet më të rëndësishme të lirisë së organizimit, pa të cilën ajo do të privohej nga çdo kuptim. Mënyra se si legjislacioni kombëtar e parashikon këtë liri dhe zbatimin e saj praktik nga autoritetet tregojnë gjendjen e demokracisë në atë vend. Sigurisht që shtetet kanë të drejtë të binden që qëllimi dhe aktivitetet e një shoqate janë në përputhje me rregullat e përcaktuara nga legjislacioni, por ato duhet ta bëjnë këtë në një mënyrë që pajtohet me detyrimet e tyre sipas Konventës dhe që i nënshtrohen rishikimit nga institucionet e Konventës (*shih Koretskyy dhe të tjerë kundër Ukrainës, nr. 40269/02, datë 3.4.2008, § 32*).



25. Ndërveprimi harmonik i personave dhe grupeve me identitete të ndryshme është thelbësor për arritjen e kohezionit social. Është e natyrshme që kur një shoqëri civile funksionon në mënyrë të shëndetshme, pjesëmarrja e qytetarëve në procesin demokratik arrihet në një masë të madhe përmes përkatësisë në shoqata, në të cilat ata mund të integrohen me njëri-tjetrin dhe të ndjekin objektiva të përbashkët kolektivisht (*shih Ecodefence dhe të tjerë kundër Rusisë, datë 14.6.2022, § 123; Gorzelik dhe të tjerë kundër Polonisë [DhM], nr. 44158/98, datë 17.2.2004, §§ 91, 92*).

26. Megjithatë, kjo e drejtë nuk është absolute dhe mund të jetë objekt i kufizimeve. Në jurisprudencën kushtetuese janë analizuar kriteret e parashikuara nga neni 17 i Kushtetutës për kufizimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë. Kriteri i kufizimit me ligj nuk kërkon vetëm që masa e kundërshtuar të jetë e parashikuar me ligj, por, gjithashtu, i referohet edhe cilësisë së ligjit në fjalë. Qëllimi i këtij kriteri është ofrimi i garancive sa më të plota në rastin e kufizimeve dhe, për këtë shkak, vetëm organi më i lartë ligjvënës duhet të jetë kompetent (*shih vendimet nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 20, datë 4.4.2014; nr. 20, datë 11.7.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Gjykata ka theksuar se kur kontrollohet kushtetutshmëria e ndërhyrjeve në të drejtat e njeriut, vlerësimi i kriterit “*kufizimi vetëm me ligj*” analizohet si në aspektin formal, pra nëse ndërhyrja parashikohet nga ligji i miratuar nga Kuvendi, ashtu edhe në aspektin substancial, pra se sa ligji ofron garancitë e mjaftueshme për ndërhyrjen (*shih vendimin nr. 30, datë 5.7.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i takon aspektin substancial, Gjykata ka pohuar se ligji që kufizon të drejtat kushtetuese duhet të përmbushë kërkesat e cilësisë: ai duhet të jetë i aksesueshëm për të interesuarin (në kuptim të marrjes djepi) dhe i parashikueshëm për efektet e tij. Po kështu, ligji duhet të jetë mjaftueshëm i qartë, me qëllim që t’u japë qytetarëve një tregues të përshtatshëm për rrethanat dhe kushtet në të cilat autoritetet publike janë të autorizuar të ndërhyjnë në të drejtat kushtetuese të tyre (*shih vendimet nr. 30, datë 2.11.2022; nr. 30, datë 5.7.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo e lidhur edhe me parimin e sigurisë juridike, që ka si kërkesë të domosdoshme që ligji në tërësi ose dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme (*shih vendimet nr. 24, datë 4.5.2021; nr. 9,*

datë 26.2.2007, të Gjykatës Kushtetuese). Një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t’i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma (*shih vendimet nr. 10, datë 26.2.2015; nr. 36, datë 15.10.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, gjatë kontrollit të akteve të pushtetit publik, sa herë që vihet në diskutim një e drejtë kushtetuese ose liri themelore, është me rëndësi të verifikohen parimet që lidhen me cilësinë e ligjit, parashikueshmërinë, sigurinë juridike dhe barazinë para ligjit, pasi janë pikërisht ato që mbrojnë individin nga arbitrariteti, veçanërisht në marrëdhëniet ndërmjet tij dhe shtetit (*shih vendimin nr. 30, datë 2.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Lidhur me kriteret që lejojnë kufizimin e lirisë së organizimit, GJEDNJ-ja ka theksuar se në çështjet që prekin të drejtat themelore do të ishte në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës, një nga parimet bazë të një shoqërie demokratike, që një diskrecion ligjor i dhënë ekzekutivit të shprehet në termat e një pushteti të pakufizuar. Për rrjedhojë, ligji duhet të tregojë me qartësi të mjaftueshme qëllimin e një diskrecioni të tillë dhe mënyrën e ushtrimit të tij. Niveli i saktësisë i kërkuar nga legjislacioni i brendshëm varet në një shkallë të konsiderueshme nga përmbajtja e instrumentit në fjalë, fusha që synon të mbulojë dhe numri e statusi i subjekteve të cilave u adresohet (*shih Jafarov dhe të tjerë kundër Azerbajxhanit, datë 25.7.2019, § 63*).

29. Ligji nr. 8788/2001 ka përcaktuar rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse që ndjekin qëllime të mira dhe në interes të publikut, kurse me ligjin nr. 8789/2001, janë parashikuar procedurat e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse, si dhe rregullat për mbajtjen e regjistrit të tyre. Në datën 24.6.2021, ligjvënësi ka miratuar ligjin nr. 80/2021, i cili përcakton procedurat e regjistrimit dhe ato për mbajtjen e regjistrit për organizatat jofitimprurëse që kanë detyrimin për t’u regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, si dhe rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e tyre, me synimin për të lehtësuar procedurat e regjistrimit dhe për të krijuar një mjedis transparent dhe mundësues për zhvillimin e kësaj veprimtarie. Dispozitat e kundërshtuara të ligjit nr. 80/2021 kanë për objekt përcaktimin e të dhënave që regjistrohen



(neni 5, pika 2), detyrimin për regjistrim (neni 8), rregullat e emërimit (neni 9, pika 1), regjistrimet e tjera të detyrueshme (neni 17, pika 3, shkronja “a”), çregjistrimin e subjektit (neni 20, pika 2, shkronja “c”), kompetencat e kancelarit (neni 26, neni 28, pika 6 dhe neni 29, pika 1), regjistrimin e njëkohshëm (neni 36, pikat 1 dhe 2); kundërvajtjet administrative (neni 49, pikat 2 deri 6); regjimin tranzitor (neni 50, pika 5). Po kështu, kërkuesit kanë kërkuar edhe shfuqizimin e fjalëve “kancelari/ose kancelari” përveç sa më sipër edhe në nenet 29, pika 1, 30, 33, pikat 2 dhe 6, 34, 35, pika 1, 41, 44, pika 3 dhe 46, pika 1, të ligjit nr. 80/2021.

30. Gjykata vëren se ndërhyrjet në lirinë e organizimit përfshijnë një shumëllojshmëri masash, të cilat mund të shfaqen në formën e formaliteteve të regjistrimit, kushteve ligjore, kufizimeve ose edhe masave ndëshkuese. Për rrjedhojë, në vijim Gjykata do të vlerësojë nëse dispozitat e kundërshtuara përbëjnë kufizim të lirisë së organizimit dhe nëse ky kufizim plotëson kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, i cili është edhe testi që duhet të gjejë zbatim për çdo ndërhyrje në të drejtat dhe liritë themelore të individit që mund të kufizohen. Në analizë të këtyre kriterëve, Gjykata vlerëson t’i referohet edhe parimit të sigurisë juridike, që, veç të tjerash, ka si kërkesë të domosdoshme që ligji ose dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme.

B.1. Për cenimin e lirisë së organizimit të lidhur me parimin e sigurisë juridike

B.1.1. Për përmbajtjen e nenit 8 të ligjit nr. 80/2021

31. Sipas kërkuesve, formulimi i nenit 8 të ligjit e bën të detyrueshëm regjistrimin, duke nënkuptuar se nëse organizata jofitimprurëse nuk regjistrohet brenda 30 ditëve nga themelimi, ajo do të konsiderohet e paligjshme dhe mund t’u nënshtrohet sanksioneve ligjore sipas nenit 49 të po këtij ligji. Sipas standardeve ndërkombëtare, legjislacioni duhet të njohë si organizatat/shoqatat formale ashtu edhe ato informale ose të paktën t’i lejojë të veprojnë pa i konsideruar të paligjshme. Ligji nuk duhet t’i detyrojë ato për të fituar personalitet juridik, por duhet të krijojë mundësinë për ta bërë këtë. Në rastin konkret nuk bëhet asnjë diferencim midis konceptit të OJF-ve dhe grupimeve informale, të cilat mund të zgjedhin të organizohen dhe funksionojnë në një nga format e organizatave jofitimprurëse, por dallimi është se nuk mund të gëzojnë personalitet juridik nëse nuk

regjistrohen në gjykatë. Ato që zgjedhin të fitojnë personalitet juridik kanë si detyrim të përmbushin të gjitha kriteret dhe kërkesat ligjore për themelimin dhe regjistrimin e tyre.

32. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se detyrimi për regjistrim në nenin 8 të ligjit zbatohet vetëm për ato organizata të parashikuara shprehimisht me ligj dhe jo për të gjitha llojet e tyre. Për më tepër, ligji ka lejuar një afat 30-ditor të përshtatshëm për përgatitjen e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, duke pranuar kështu edhe sugjerimet e grupeve të interesit gjatë hartimit të ligjit, ndaj ai respekton parimin e sigurisë juridike. Sipas subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, kjo dispozitë nuk lë hapësira për interpretim lidhur me fushën e zbatimit, duke iu referuar vetëm organizatave që sipas ligjit nr. 8788/2001 kanë detyrimin për regjistrim. Edhe referuar standardeve të OSBE/ODHIR për fitimin e personalitetit juridik, shoqata mund të informojë autoritetet për formimin e saj dhe të kalojë një proces formal që përfshin regjistrimin. Përderisa Kushtetuta parashikon regjistrimin e organizatave jofitimprurëse dhe ligji nr. 8788/2001 përcakton cilat organizata e kanë këtë detyrim, ligji nr. 80/2021 rregullon regjistrimin dhe parashikon sanksionet përkatëse për shkeljen e detyrimeve që burojnë nga ligji për OJF-të.

33. Gjykata vëren se sipas nenit 8 të ligjit nr. 80/2021: “Organizatave jofitimprurëse, të cilat kanë detyrimin për t’u regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, që përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse, janë të detyruara të paraqesin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën për regjistrim fillestar ose për regjistrime të tjera të detyrueshme brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e themelimit ose nga data e ngjarjes së rrethanës faktike dhe/ose hartimit të aktit të detyrueshëm për t’u regjistruar.”.

34. Sipas GJEDNJ-së, shtetet mund të vendosin në legjislacionin e tyre rregulla dhe kërkesa për subjektet juridike dhe organet drejtuese, si dhe të sigurojnë përputhjen me to. Në fakt, ligjet e brendshme të shumë shteteve anëtare të Këshillit të Evropës parashikojnë rregulla dhe kërkesa të tilla, me shkallë të ndryshme rregullimi (*shih Ecodefence dhe të tjerë kundër Rusisë, datë 14.6.2022, § 152*). Ndërsa shtetet kanë të drejtë t’u kërkojnë organizatave që kërkojnë regjistrim zyrtar që të përmbushin formalitetet e arsyeshme ligjore, një kërkesë e tillë



gjithmonë i nënshtrohet kriterit të proporcionalitetit (*shih Organizata e Bashkuar Maqedonase Ilinden dhe të tjerë kundër Bullgarisë (nr. 2), datë 18.10.2011, § 40*). Masa në fjalë duhet t'i përgjigjet një "nevoje urgjente sociale" dhe të jetë në përpjesëtim me "qëllimin legjitim" dhe arsyet e paraqitura nga autoritetet kombëtare për ta justifikuar atë duhet të jenë "relevante dhe të mjaftueshme". Ndërsa shtetet mund të kenë arsye legjitime për të monitoruar operacionet financiare në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, me synimin për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe ekstremizmit, aftësia e një shoqate për të kërkuar, marrë dhe përdorur fonde në mënyrë që të jetë në gjendje të promovojë dhe mbrojë kauzat e saj përbën një pjesë integrale të lirisë së organizimit (*shih Aliyev kundër Azerbajxhanit, nr. 68762/14 dhe 71200/14, datë 20.9.2018, § 212*).

35. Objektivi për të rritur transparencën e financimit të shoqatave, edhe pse legjitim, nuk mund të justifikojë legjislacionin që bazohet mbi prezumime, të bëra parimisht dhe të zbatuara pa dallim, se çdo mbështetje financiare nga një subjekt jo kombëtar dhe çdo organizatë e shoqërisë civile që merr një mbështetje të tillë financiare janë në thelb përgjegjës për të rrezikuar interesat politikë dhe ekonomikë të shtetit dhe aftësinë e institucioneve të tij për të vepruar të lira nga ndërhyrjet. Një kuadër rregullator duhet të korrespondojë me skenarin e një kërcënimi mjaft serioz ndaj një interesi themelor të shoqërisë, të cilin këto detyrime supozohet ta parandalojnë (*shih Ecodefence dhe të tjerë kundër Rusisë, datë 14.6.2022, § 166*).

36. Sipas nenit 46 të Kushtetutës, procedura për regjistrimin e organizatave ose shoqatave bëhet sipas ligjit, por norma kushtetuese nuk parashikon asnjë detyrim përveçse organit kompetent për regjistrimin. Ndërkohë, sipas nenit 26 të Kodit Civil (KC), persona juridikë privatë janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji, kurse neni 29 i KC-së përcakton si moment të fitimit të zotësisë juridike të personit juridik çastin e krijimit, dhe kur ligji e parashikon si detyrim, atë të regjistrimit të tij. Sipas nenit 3, pika 5, të ligjit nr. 80/2021, "organizata jofitimprurëse" ka të njëjtin kuptim si në ligjin që përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse. Referuar nenit 2, pikat

3 dhe 4, të ligjit nr. 8788/2001, me "organizata jofitimprurëse" kuptohen shoqatat, fondacionet dhe qendrat, veprimtaria e të cilave zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe pa u ndikuar nga shteti dhe "veprimtari jofitimprurëse" kuptohet çdo veprimtari ekonomike ose joekonomike, me kusht që të ardhurat ose pasuritë e organizatave jofitimprurëse, kur ka të tilla, të përdoren vetëm për realizimin e qëllimeve të përcaktuara në statutin e organizatës. Neni 13, i ligjit nr. 8788/2001 parashikon se OJF-të fitojnë personalitetin juridik pasi të jenë themeluar dhe regjistruar në gjykatë, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Themeluesit e organizatës jofitimprurëse mblidhen dhe miratojnë aktin e themelimit dhe statutin e saj, si dhe mund të autorizojnë një a më shumë persona për të kryer veprimet për regjistrim. Kurse sipas nenit 3 të ligjit nr. 8789/2001, shoqatat, fondacionet dhe format e tjera të OJF-ve, që mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe fitojnë cilësinë e personit juridik vetëm pas regjistrimit në gjykatë, caktohen shprehimisht me ligj.

37. Në vlerësimin e Gjykatës, detyrimi i organizatave jo fitimprurëse për regjistrimin fillestar, detyrim i cili kur nuk përmbushet cilësohet si kundërvajtje administrative në kuptim të nenit 49 të ligjit nr. 80/2021 dhe dënohet me gjobë, përbën një prej formave të ndërhyrjes në lirinë e organizimit. Legjislacioni në fuqi, ndërsa parashikon format e organizimit, regjistrimin formal në gjykatë e ka lidhur vetëm me fitimin e personalitetit juridik, duke qenë ky momenti nga i cili lindin edhe detyrimet për personin juridik privat. Gjykata vëren se liria e organizimit, sipas nenit 46 të Kushtetutës, nënkupton edhe lirinë e qytetarëve për të vendosur për shkallën e ushtrimit të kësaj lirie, çka do të thotë se këto organizime vullnetare mund të jenë formale ose informale. Ndërkohë, neni 8 i ligjit rregullon regjistrimin fillestar, duke u shprehur se organizatat, të cilat kanë detyrimin për t'u regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, janë të detyruara të regjistrohen. Ky formulim i normës jo vetëm që i detyron qytetarët të regjistrohen në gjykatë pavarësisht vullnetit të tyre, por në thelb rezulton të jetë detyrim i ri, i krijuar pikërisht nga ligji nr. 80/2021, pasi nuk parashikohet si i tillë nga legjislacioni në fuqi, konkretisht ligjet nr. 8788/2001 dhe nr. 8789/2001. Në rast se organizimet e paformalizuara, për aq kohë sa, për shkaqe të ndryshme, vlerësojnë ose nuk janë në kushtet që të



mund të kërkojnë regjistrimin sipas ligjit, ato kanë të drejtë të organizohen vetëm në formën e një grupimi informal, pa pasur në kuptim të ligjit personalitet juridik të organizatave formale. Aftësia për të formuar një person juridik, me qëllimin për të vepruar kolektivisht në një fushë me interes të përbashkët, si një nga aspektet e rëndësishme të lirisë së organizimit, lidhet pikërisht me krijimin e atyre kushteve që jo vetëm lehtësojnë regjistrimin dhe ushtrimin e veprimtarisë, por i lejojnë një organizimi të caktuar të marrë kohën e nevojshme për të vlerësuar dhe përgatitur dokumentacionin e nevojshëm ligjor në këtë drejtim.

38. Parashikimi i nenit 8 të ligjit nr. 80/2021, i cili, për nga mënyra se si është formuluar e lidh detyrimin për regjistrim fillestar me miratimin e aktit të themelimit, i detyron grupimet jo formale që të ndryshojnë sjelljen dhe qasjen e tyre për të evituar rrezikun e përbashkët me ndëshkime ligjore, të cilat, për këtë shkak, mund të përbëjnë edhe një barrë të tepruar financiare. Gjykata ka theksuar se një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t'i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma (*shih vendimet nr. 10, datë 26.2.2015; nr. 36, datë 15.10.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Për shkak të fushës që rregullon ligji nr. 80/2021 dhe veçanërisht dispozita e kundërshtuar, është e nevojshme një shkallë e arsyeshme saktësie ndërkohë që, për nga përmbajtja, kjo dispozitë nuk është e tillë që të mos lejojë zbatimin ose interpretimin arbitrar të saj. Duke pasur parasysh jo vetëm mungesën e një detyrimi ligjor për regjistrim, por, nga ana tjetër, edhe procedurat që duhet të ndiqen deri në paraqitjen e një kërkesë në gjykatë për regjistrimin fillestar, ashtu edhe nevojën për përgatitjen dhe plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, efekti i këtij detyrimi konsiderohet se sjell një “efekt frenues” të rëndësishëm në zgjedhjen e grupimeve për t'u formalizuar dhe regjistruar sipas ligjit. Kjo mund të rezultojë *de facto* në pamundësinë e këtyre grupimeve që të fitojnë personalitet juridik, për rrjedhojë që të ushtrojnë veprimtarinë për të cilën janë themeluar.

39. Për sa kohë që, siç u theksua më sipër, Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi nuk parashikojnë dhe nuk përcaktojnë detyrime në lidhje me formën e organizimit, formal ose informal, deri në marrjen e vendimit për regjistrim ligji nuk mund

të përcaktojë asnjë detyrim për të filluar procedura ligjore dhe për të veshur këto organizime me një status të caktuar ligjor. Për sa më sipër, detyrimi për regjistrim fillestar, duke e lidhur këtë me OJF-të që sipas ligjit kanë detyrimin për regjistrim, nuk plotëson kriterin e “cilësisë së ligjit” të kërkuar nga neni 17 i Kushtetutës dhe parimi i sigurisë juridike.

40. Edhe pse në vlerësimin e Gjykatës mosplotësimi i njërit prej kriterëve të kufizimit në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës është i mjaftueshëm në nivel kushtetues për të konsideruar normën ligjore jokushtetuese, ajo vlerëson të theksojë edhe se subjektet e interesuara nuk arritën të argumentonin se detyrimi i vendosur për organizatat që krijohen rishtazi për paraqitjen e kërkesës për regjistrim fillestar brenda një afati 30-ditor është një masë që i përgjigjet një nevoje urgjente dhe në përpjesëtim me qëllimin që kërkohet të arrihet. Ky detyrim, siç u theksua më sipër, jo vetëm që nuk buron si i tillë nga legjislacioni në fuqi, por, nga njëra anë, sjell detyrime të tjera shtesë për këto subjekte, dhe, nga ana tjetër, mosrespektimi i tij sjell pasoja ligjore, për sa kohë që konsiderohet shkelje administrative dhe shoqërohet me gjobë. Ky parashikim, për sa kohë që mund të sjellë efektin e kundërt nga ai që synohet të arrihet, duke bërë të vështirë ose të pamundur regjistrimin fillestar të OJF-ve, konsiderohet se përbën një pengesë në drejtim të lirisë së organizimit. Gjykata nuk konstatoi arsye të rëndësishme dhe të mjaftueshme në vendosjen e një kërkesë të tillë, e cila kufizon lirinë e organizimit në një mënyrë të paparashikueshme dhe disproporcionale.

41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se parashikimet e nenit 8 të ligjit për detyrimin për regjistrim fillestar, për sa kohë që nuk janë të qarta dhe të parashikueshme, nuk plotësojnë kriteret e nenit 17 të Kushtetutës për kufizimin me ligj dhe as kërkesat e parimit të sigurisë juridike.

B.1.2. Për kompetencat e kancelarit sipas dispozitave të kundërshtuara të ligjit nr. 80/2021

42. Po në këndvështrim të lirisë së organizimit, kërkuesit kanë kërkuar edhe shfuqizimin e fjalëve “kancelari/ose kancelari” në nenet përkatëse ku ato gjenden, konkretisht nenet 26, 28, pika 6, 29, pika 1, 30, 32, 33, pikat 2 dhe 6, 34, 35, pika 1, 41, 44, pika 3 dhe 46, pika 1, të ligjit nr. 80/2021. Sipas tyre, këto parashikime nuk përmbushin garancitë dhe standardet ndërkombëtare, pasi ai nuk është autoritet vendimmarrës, i pavarur dhe i paanshëm.



Ligji nuk bën dallim midis kërkesave thelbësore për regjistrim, me natyrë serioze, dhe kërkesave të tjera me natyrë formale dhe jo të domosdoshme. Për më tepër, diskrecioni i pezullimit nuk mund t'i atribuohet kancelarit si një nëpunës gjyqësor, i cili nuk është një autoritet vendimmarrës i pavarur dhe i paanshëm, por duhet të jetë atribut ekskluziv i gjykatës.

43. Në lidhje me këto pretendime, subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se ligji nr. 98/2016 ka garantuar pavarësinë dhe paanësinë e këtij funksionari. Qëllimi i ligjvënësit në rastin konkret ka qenë efektiviteti i procesit, ulja e barrës së procedurës gjyqësore, lehtësimi i veprimeve etj. Kurse sipas subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, kompetencat e kancelarit janë parashikuar nga ligji nr. 98/2016 dhe nisur nga fakti se ato lidhen me procedura të thjeshtuara për depozitimin e akteve, kanë qëllim të mos mbingarkojnë gjykatën me çështje për të cilat nuk nevojitet një shqyrtim i thelluar. Nga ana tjetër, regjistrimi nga ana e kancelarit sjell përfitime, pasi procesi realizohet në një periudhë kohore më të shkurtër. Për sa i përket paanshmërisë dhe pavarësisë së kancelarit, dispozitat ligjore në fuqi parashikojnë garancitë për heqjen dorë ose përjashtimin e tij nga shqyrtimi i kërkesës.

44. Gjykata vëren se në nenin 4, si dhe në preambulën e Kushtetutës deklarohet parimi i shtetit të së drejtës, i cili është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Si i tillë, ai është një normë e pavarur kushtetuese, prandaj shkelja e tij përbën në vetvete bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji si antikushtetues. Ky parim nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Parimi i shtetit të së drejtës nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative (*shih vendimet nr. 55, datë 27.7.2016; nr. 16, datë 10.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuptim të këtij parimi, përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet, duke u dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës, detyrim që rrjedh nga përmbajtja e nenit 4, pika 3, të Kushtetutës. Për çdo rast, kur rregullimi kushtetues parashikohet shprehimisht prej saj, ai, detyrimisht,

do të zbatohet drejtpërdrejt. Për funksionet kushtetuese të organeve, atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund ta bëjë ligji (*shih vendimet nr. 55, datë 27.7.2016; nr. 22, datë 24.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Gjykata ka theksuar se është brenda hapësirës vlerësuese të ligjvënësit mënyra e rregullimit të një çështjeje të caktuar, ndërsa është detyrë e saj të kontrollojë nëse ky rregullim është bërë në përputhje me Kushtetutën dhe parimet themelore të saj (*shih vendimin nr. 55, datë 27.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se neni 46 i Kushtetutës në mënyrë të qartë ka parashikuar se regjistrimi i organizatave ose shoqatave bëhet në gjykatë, duke përcaktuar kështu organin kompetent që vendos për regjistrimin, sipas një procedure e cila miratohet me ligj. Në këto kushte, për të arritur në një përfundim të drejtë në lidhje me dispozitat ligjore të kundërshtuara që parashikojnë kompetenca të veçanta për kancelarin, merr rëndësi përcaktimi i konceptit “regjistrim” sipas normës kushtetuese.

46. Referuar nenit 1, të ligjit nr. 8788/2001, ai përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse, kurse sipas nenit 13, regjistrimi i OJF-ve u jep atyre personalitet juridik. Nga ana tjetër, sipas neneve 1 dhe 2, të ligjit nr. 80/2021, ai përcakton procedurat e regjistrimit të OJF-ve dhe mbajtjen e regjistrimit të tyre, si dhe lehtësimin e procedurave të regjistrimit. Sipas nenit 25 të ligjit, vendimi për regjistrimin fillestar të OJF-ve, si dhe vendimi për çregjistrimin e tyre merret nga një gjyqtar i seksionit tregtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj, kurse sipas nenit 26, vendimi për regjistrimet e tjera, sipas përcaktimit të seksionit IV, të kreut II të këtij ligji, merret nga kancelari i asaj gjykate në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj. Gjykata vëren se ligji, në varësi të llojit të regjistrimit, ka përcaktuar edhe organin kompetent, duke parashikuar në kompetencë të gjyqtarit vetëm regjistrimin fillestar, që sipas nenit 3, pika 9, të ligjit është regjistrimi për herë të parë në regjistër, ndërkohë që kancelari është kompetent të vendosë për çdo regjistrim tjetër, që sipas pikës 10 të po këtij neni është çdo ndryshim, shtesë ose fshirje të dhënash në regjistër.

47. Referuar seksionit IV, të kreut II, të ligjit nr. 80/2021, ai ka të bëjë me regjistrimet e tjera të



detyrueshme dhe më konkretisht ato që parashikohen në nenin 17 dhe që janë detyrimi për të regjistruar çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara dhe në dokumentet shoqëruese që depozitohen në regjistrin elektronik, si dhe: a) pasqyrat financiare vjetore të mbajtura sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme; b) emërimin e likuidatorit, si dhe të dhënat e tij të identifikimit; c) aktet e prishjes, të mbylljes ose të shpërndarjes, aktet e transformimit, të bashkimit, të ndarjes, hapjes së procedurave të administrimit, likuidimit ose riorganizimit, si dhe aktet e tjera të ndërmjetme, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Për degët e organizatave jofitimprurëse të huaja regjistrohen edhe aktet e transformimit, të bashkimit, të ndarjes, të hapjes dhe të mbylljes së procedurave të likuidimit ose të falimentimit të organizatës jofitimprurëse të huaj; ç) vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia; d) kompetencat e përfaqësimit të organeve drejtuese ose të likuiduesve; dh) emri, mbiemri, datëlindja dhe vlera e kontributeve pasurore të fondit themelues (nëse ka të tilla); e) çdo regjistrim tjetër të detyrueshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi. Po në këtë seksion bëjnë pjesë edhe regjistrimet vullnetare të çdo të dhëne tjetër, të ndryshme nga të dhënat e përcaktuara në nenin 17 të këtij ligji, të cilat kanë lidhje me veprimtarinë e OJF-ve, që përfshijnë, por pa u kufizuar në: a) emërtimin ose shenjat e tjera dalluese të veprimtarisë (nëse është i/janë të ndryshëm nga emri i regjistruar i organizatës jofitimprurëse); b) faqen e internetit, adresën *email*-it, numrin e telefonit dhe faksit; c) vendimet e organeve drejtuese të organizatës jofitimprurëse, si vendimet e pezullimit të veprimtarisë ose vendimet e tjera të ndryshme nga vendimet e detyrueshme për regjistrim; ç) të dhëna të tjera të lidhura me veprimtarinë e organizatës jofitimprurëse (neni 18). Po kështu, përfshihen edhe regjistrimet e vendimeve gjyqësore për të dhënat e regjistruara ose veprimtarinë e organizatës jofitimprurëse, rast në të cilin kërkesës për regjistrim i bashkëlidhet vendimi përkatës (neni 19).

48. Gjykata vëren se edhe sipas pikës 11, të nenit 3, të ligjit nr. 80/2021, “regjistrim” është regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër, përfshirë edhe transformimin, bashkimin, çregjistrimin e subjektit nga regjistri. Në këto kushte, në lidhje me konceptin kushtetues “regjistrim”, Gjykata vlerëson se ai është akti/rezultati në fund të procedurës së parashikuar

me ligj, me të cilin organizata jofitimprurëse fiton personalitetin juridik, duke qenë e aftë të marrë përsipër të drejta dhe detyrime nga veprimtaria jofitimprurëse për qëllime të ligjshme.

49. Edhe pse ligji ka bërë dallim mes regjistrimit fillestar, përmes të cilit organizata fiton personalitet juridik sipas ligjit, dhe regjistrimeve të tjera, të cilat kryhen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, në thelb të gjitha këto veprime futen në konceptin kushtetues të regjistrimit. Regjistrimet e tjera sipas ligjit, për nga natyra e tyre, për sa kohë kanë të bëjnë me ndryshime, shtesa ose edhe fshirje të të dhënave të paraqitura në regjistrimin fillestar, sjellin të njëjtat pasoja që kanë të bëjnë me statusin ligjor të OJF-ve. Për rrjedhojë, këto veprime, pavarësisht nëse kryhen rishtazi ose përgjatë kohëzgjatjes së personit juridik, lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me fitimin e personalitetit juridik ose përfundimin e tij, si edhe me mënyrën e ushtrimit të kësaj veprimtarie jofitimprurëse, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej saj. Ato përfshijnë, gjithashtu, veprime që kërkojnë vlerësim ligjor dhe mund të passjellin edhe ndryshime në ato aspekte të regjistrimit për herë të parë, që janë vlerësuar tashmë nga ana e gjyqtarit në momentin e regjistrimit të organizatës në gjykatë. Në këtë kuptim, çdo veprim që kryhet në regjistrin elektronik për regjistrimin, pavarësisht se në çfarë momenti kryhet ai, para apo pas fitimit të personalitetit juridik, është në kompetencë ekskluzive të organit gjyqësor, i përcaktuar si i tillë nga norma kushtetuese.

50. Edhe në frymën e dispozitave kushtetuese për ndarjen dhe balancimin e pushteteve, kancelari i gjykatës, megjithëse ushtron detyrën pranë gjykatës, nuk përfshihet në konceptin kushtetues “gjykatë”, për sa u përket çështjeve që lidhen me regjistrimin e organizatave jofitimprurëse. Në kuptim të nenit 37, të ligjit nr. 98/2018, kryetari i gjykatës kujdeset për organizimin dhe funksionimin e administrimit gjyqësor në gjykatë në lidhje me veprimtaritë jogjyqësore nëpërmjet kancelarit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, kurse sipas nenit 39, kancelari është përgjegjës për menaxhimin e administrimit gjyqësor, duke përcaktuar edhe kompetencat që ai ushtron në këtë drejtim. Çështjet që kanë të bëjnë me regjistrimin e OJF-ve, për shkak të natyrës dhe pasojave të tyre, nuk përfshihen në konceptin e çështjeve jogjyqësore ose administrative, pra nuk janë të tilla që përfshihen në



fushën e kompetencave të menaxhimit dhe administrimit gjyqësor, sipas ligjit.

51. Për sa më sipër, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë edhe procedurën që përmban ligji për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, vlerëson se kompetencat që i janë dhënë kancelarit tejkalojnë kompetencat e menaxhimit dhe administrimit gjyqësor, duke pasur në vetvete natyrë gjyqësore dhe për këtë shkak duhet të ushtrohen nga gjyqtari/gjykata. Ligjvënësi, në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës, ka tejkalluar parashikimin kushtetues, që në mënyrë të qartë ka parashikuar se regjistrimi i organizatave ose shoqatave bëhet në gjykatë, e cila është organi i vetëm kompetent në lidhje me çdo veprim që kryhet nga organizata ose shoqata, si në lidhje me fitimin e personalitetit juridik ose përfundimin e tij, ashtu edhe me veprimet që lidhen me ushtrimin e kësaj veprimtarie, deri në vendosjen e pezullimit ose të gjobës, sipas ligjit. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se dispozitat e neneve 26, 28, pika 6, 29, pika 1, 30, pikat 1, 2 dhe 3, 32, 33, pikat 2 dhe 6, 34, 35, pika 1 dhe 46, pika 1, në atë pjesë që parashikojnë kompetencën e kancelarit për ushtrimin e kompetencave që sipas nenit 46 të Kushtetutës i përkasin ekskluzivisht organit gjyqësor, janë të papajtueshme me Kushtetutën. Në kuptim të sa më sipër, edhe parashikimi i kompetencës së kancelarit sipas nenit 49, pika 6, të ligjit nr. 80/2021, për vendosjen e gjobës në rast të kundërvajtjes administrative, nuk është i pajtueshëm me natyrën e këtij funksioni, për rrjedhojë edhe kjo dispozitë është e papajtueshme me Kushtetutën.

52. Gjykata vëren, gjithashtu, se edhe pse nuk janë kundërshtuar nga kërkuesit në mënyrë të shprehur në objekt të kërkesës, ata kanë kërkuar edhe verifikimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të neneve 41 dhe 44, pika 3, të ligjit nr. 80/2021, që parashikojnë se KLGJ-ja, me propozimin e kancelarit, miraton formatin dhe përmbajtjen e certifikatave të vërtetimeve dhe të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit, si dhe të ekstrakteve të regjistrit elektronik e të kërkesës për lëshimin e tyre. Në lidhje me këto parashikime, Gjykata vlerëson se këto aspekte nuk lidhen me konceptin kushtetues të regjistrimit, por kanë të bëjnë me çështje të menaxhimit dhe administrimit gjyqësor në kuptim të nenit 39, të ligjit nr. 98/2016, konkretisht me mirëmbajtjen dhe menaxhimin e regjistrit elektronik, të cilat, si veprime me natyrë

administrative, përfshihen në fushën e kompetencave të kancelarit. Për rrjedhojë, parashikimet e neneve 41 dhe 44, pika 3, të ligjit nr. 80/2021, nuk janë të papajtueshme me nenin 46 të Kushtetutës.

53. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesve është pjesërisht i bazuar.

B.2. Për cenimin e lirisë së organizimit të lidhur me parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes

54. Sipas kërkuesve, parashikimet e nenit 49 të ligjit nr. 80/2021, që përcaktojnë masën e gjobës për kundërvajtjet administrative, nuk përmbushin kërkesat e qartësisë dhe të sigurisë juridike në formulimin dhe përcaktimin e sanksioneve ligjore, ndërkohë që çdo kufizim në të drejtën për t'u organizuar, përfshirë sanksionet, duhet të jetë proporcional me qëllimet që synon të arrijë. Duke e lidhur masën e gjobës me të ardhurat vjetore të deklaruara nga organizata, këto dispozita, për të njëjtën shkelje, parashikojnë masa të ndryshme gjobe, në varësi të të ardhurave vjetore.

55. Në lidhje me këto pretendime, subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se parashikimet e nenit 49 respektojnë parimin e proporcionalitetit dhe janë në përputhje me nenin 10, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10279/2010. Masa e dënimit nga 0.1% deri në 1% është proporcionale dhe ajo nuk mund të konsiderohet e ekzagjeruar, por garanton parimin e barazisë, pasi zë të njëjtën peshë për të gjitha subjektet dhe dënimi nuk matet nga vlera sasiore, por përqindja reale që ajo zë në secilën organizatë. Kurse sipas subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, kundërvajtjet dhe sanksionet administrative janë përcaktuar në përputhje me ligjin nr. 10279/2010, kurse mënyra e zbatimit të tyre nuk përbën juridiksion kushtetues. Përmes kësaj dispozite garantohet që e njëjta shkelje të marrë sanksionin e duhur administrativ, pa e lidhur atë me një shumë fikse. Një gjobë me shumë fikse për një organizatë që ka burime të mëdha financimi, nuk ka të njëjtin efekt ndaj një tjetre me burime më të pakta, madje për këtë të fundit mund të përbëjë pengim në ushtrimin e veprimtarisë.

56. Gjykata vëren se dispozitat e kundërshtuara të nenit 49, të ligjit nr. 80/2021 parashikojnë se deklarimi në regjistrin elektronik i të dhënave të pavërteta, kur nuk përbën veprë penale, dhe moskryerja e detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme, brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, përbëjnë kundërvajtje



administrative dhe dënohen me gjobë nga 0.1% deri në 1% të të ardhurave vjetore të deklaruara nga organizata jofitimprurëse (pikë 2 dhe 3), masa e së cilës, në çdo rast, nuk mund të jetë më e vogël se 30.000 lekë (pika 4). Sipas pikës 5 të këtij neni, në rast se kancelari, kryesisht, konstaton që organizata jofitimprurëse ka deklaruar të dhëna të pavërteta ose nuk ka përmbushur detyrimet për regjistrim fillestar apo regjistrime të tjera të detyrueshme, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, përpara marrjes së vendimit njofton palët për paraqitjen e kërkesës për regjistrim ose korigjimin e të dhënave.

57. Referuar legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative, ligji nr. 10279/2010, përcakton rregullat për konstatimin dhe shqyrtimin e tyre, procedurat dhe afatet e ankimit ndaj akteve të organeve të administratës publike që vendosin dënime administrative, si dhe procedurat e ekzekutimit të sanksioneve administrative. Sipas nenit 10 të tij, masa e dënimit me gjobë përcaktohet nga ligji që ka parashikuar kundërvajtjen administrative dhe ajo mund të jetë fikse ose e përcaktuar me kufij minimalë dhe maksimalë. Sipas pikës 2 të këtij neni, në rastet kur ligji i posaçëm vendos kufij minimalë dhe maksimalë për vlerën e dënimit me gjobë, atëherë, për qëllim të marrjes së vendimit për kundërvajtjen administrative, organi administrativ kompetent për shqyrtimin e kundërvajtjes, përveç parimeve të parashikuara nga neni 18 i këtij ligji, miraton edhe metodikën ose parime të tjera shtesë, mbi të cilat mbështetet për përcaktimin e vlerës së gjobës, për rastet e kundërvajtjeve për të cilat parashikohet i njëjti dënim. Kurse sipas nenit 18 të po atij ligji, në përzgjedhjen e llojit të dënimit dhe në caktimin e masës së tij, në rastet kur ligji ka parashikuar kufij minimalë e maksimalë të vlerës së gjobës, organi që shqyrton kundërvajtjen administrative duhet të marrë parasysh: a) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes; b) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë; c) rëndësinë e kundërvajtjes; ç) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi.

58. Gjykata vëren se dispozitat e kundërshtuara të ligjit nr. 80/2021 kanë parashikuar dy koncepte në lidhje me masën e gjobës, duke e lënë atë në kufij minimalë dhe maksimalë të lidhur me të ardhurat vjetore të padeklaruara dhe në vijim duke e përcaktuar atë edhe në kufij fiks. Për rrjedhojë, Gjykata do të vlerësojë nëse masa e këtyre dënimeve

është proporcionale me qëllimin që ato synojnë të arrijnë.

59. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se parimi i proporcionalitetit nënkupton që ndërhyrja e ligjvënësit për kufizimin e një të drejte ose lirie të caktuar të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet. Përveç kësaj, përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, çka do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Kushti i përpjesëtimt të kufizimit me gjendjen që e ka diktuar konkretizohet në kërkesën e domosdoshmërisë, të dobishmërisë dhe të proporcionalitetit. Në thelb të këtij parimi qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre (shih vendimet nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 16, datë 1.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese).

60. Gjykata ka evidentuar se për vlerësimin e proporcionalitetit duhen mbajtur në konsideratë disa kritere: i. nëse objektivi i ligjvënësit është mjaftueshmërisht i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; ii. nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin, ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; iii. nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhet për të arritur objektivin e kërkuar - sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t'u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme. Proporcionaliteti i një kufizimi vlerësohet rast pas rasti, duke pasur parasysh që kriteret e mësipërme të mos analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra-tjetrën (shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 11, datë 9.3.2021; nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese).

61. Sipas GJEDNJ-së, kur ajo shqyrton nëse kufizimet e të drejtave ose lirive të garantuara nga Konventa janë “të nevojshme në një shoqëri demokratike”, shtetet palë gëzojnë një hapësirë të caktuar, por jo të kufizuar. Duke vepruar brenda kësaj hapësire, autoritetet kombëtare duhet të zbatojnë standarde që janë në pajtim me parimet e mishëruara në nenin 11 të Konventës dhe të bazojnë vendimet e tyre në një vlerësim të pranueshëm të fakteve, dështim që mund të konsiderohet shkelje e këtij neni (shih *Körtvélyessy kundër Hungarisë*, datë 5.4.2016, §§ 26–29). Për sa u përket sanksioneve të



vendosura nga autoritetet kombëtare, shtetet palë nuk gëzojnë liri të pakufizuar për të marrë çfarëdo mase që ata e konsiderojnë të përshtatshme dhe i takon Gjykatës të vlerësojë natyrën dhe ashpërsinë e dënimeve të vendosura për sjellje që përfshijnë njëfarë shkalle shqetësimi të rendit publik, me qëllim shqyrtimin e proporcionalitetit të një ndërhyrjeje në lidhje me qëllimin e ndjekur (*shih Ekrem Can dhe të tjerët kundër Turqisë, datë 8.3.2022, § 91*).

62. GJEDNJ-ja ka theksuar se ajo duhet të bindet se dënimi nuk përbën një formë censurimi dhe në të njëjtën mënyrë dënimi nuk duhet të jetë i tillë që të mund të pengojë OJF-të në kryerjen e detyrës së tyre si vëzhgues të pavarur dhe “rojtare publikë” (*shih Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë, nr. 37374/05, datë 14.4.2009, § 27; Magyar Helsinki Bizottság kundër Hungarisë [DhM], datë 8.11.2016, § 159*). Për të vënë në perspektivë ndikimin financiar të dënimeve, GJEDNJ-ja e ka konsideruar të përshtatshme që të përdorë si krahasues të përshtatshëm pagën minimale mujore, e cila përcaktohet dhe rishikohet (*shih Tolmachev kundër Rusisë, nr.42182/11, datë 2.6.2020, § 54*), për të arritur në përfundimin nëse vlera minimale e gjobës ishte në një nivel që tejkalonte pagën minimale mujore ose nëse ishte afërsisht e barabartë me të ardhurat e jetesës. Po kështu, ajo vlerëson, si mjet tjetër krahasues të përshtatshëm, edhe dënimet për lloje të tjera të kundërvajtjeve administrative. Në mënyrë që të jetë proporcionale, ndërhyrja duhet të korrespondojë me ashpërsinë e shkeljes dhe dënimi me peshën e shkeljes që synon të ndëshkojë (*shih Independent News and Media and Independent Newspapers Ireland Limited kundër Irlandës, nr. 55120/00, datë 16.6.2005, §§ 110-13; Gyrhyan kundër Rusisë, nr. 35943/15, datë 9.10.2018, § 28*).

63. Gjykata vëren se për nga natyra e tyre OJF-të janë subjekte, veprimtaria e të cilave zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe pa u ndikuar nga shteti dhe ajo përfshin çdo veprimtari ekonomike ose joekonomike me kusht që të ardhurat ose pasuritë, nëse ka të tilla, të përdoren vetëm për realizimin e qëllimeve të ligjshme të përcaktuara në statutin e organizatës. Për nga qëllimi dhe objekti i kësaj veprimtarie, parashikimet ligjore që përcaktojnë detyrime për këto subjekte, veçanërisht kur bëhet fjalë për masa që shoqërohen me pasoja financiare, duhet të jenë të tilla që të mos krijojnë një barrë të tepruar ndaj tyre.

64. Qëllimi i ligjvënësimit në miratimin e ligjit nr. 80/2021 ka qenë përmirësimi i kuadrit ligjor dhe parashikimi i një procedure transparente për regjistrimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së OJF-ve, modernizimin e shërbimeve dhe të databazës së të dhënave, për të mundësuar edhe një sistem për shkëmbimin e informacionit. Kjo nismë është ndërmarrë në zbatim të rekomandimeve të MONEYVAL, që kanë vlerësuar se Shqipëria nuk ka ndonjë politikë të qartë për të promovuar llogaridhënien, integritetin dhe besimin publik në administrimin dhe menaxhimin e OJF-ve, duke pasur një qasje të kufizuar ndaj këtij sektori dhe komunitetit të donatorëve për çështjet e financimit nga terrorizmi. Po ashtu, nisma është propozuar edhe në kuadër të detyrimeve të qeverisë shqiptare në përmbushje të qëllimit të udhërrëfyesit të shoqërisë civile, i miratuar me VKM-në nr. 539, datë 25.7.2019. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se ndërhyrja e ligjvënësimit i përgjigjet një interesi publik, që lidhen me përmirësimin e procedurave në drejtim të ushtrimit të veprimtarisë nga OJF-ve dhe transparencën në menaxhimin e të dhënave të regjistruara. Për rrjedhojë, Gjykata nuk vë në diskutim objektivin që ka synuar të arrijë ligjvënësi në këtë rast, por ajo synon të vlerësojë nëse mjetet e përdorura prej tij, në këtë rast masa e dënimeve administrative në raport me shkeljet që u atribuohen janë të ashpra dhe nëse lidhen në mënyrë të arsyeshme me këtë objektiv.

65. Gjykata vëren se sipas pikave 2 dhe 3, të nenit 49, të ligjit nr. 80/2021, si shkelje administrative konsiderohet deklarimi në regjistrin elektronik i të dhënave të pavërteta, kur kjo nuk përbën veprë penale, si dhe moskryerja e detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme brenda afateve të parashikuara nga ky ligj. Në lidhje me regjistrimin fillestar, për sa kohë që Gjykata vlerësoi se ky ligj nuk mund të përcaktojë një detyrim të tillë, edhe parashikimi i një shkeljeje për mosrespektimin e tij konsiderohet në të njëjtën mënyrë jokushtetues. Në lidhje me shkeljet e tjera administrative, duke pasur parasysh natyrën e këtyre shkeljeve, të cilat lidhen vetëm me deklarimin e të dhënave të regjistrin elektronik dhe pasojat që mund të sjellin ato, Gjykata vlerëson se këto mjete janë më të ashpra se sa duhet për të arritur objektivin e kërkuar.

66. Në lidhje me marzhin e përcaktuar nga 0.1% deri në 1%, ai nuk plotëson standardet lidhur me



qartësinë e normës juridike për sa i përket kuptimit dhe përlogaritjes së gjobave mbi të ardhurat vjetore të deklaruara të organizatave jofitimprurëse, duke i bërë këto ndëshkime për nga natyra e tyre arbitrare. Për nga formulimi i shkeljes këto parashikime janë, gjithashtu, të paparashikueshme, për sa kohë që nuk është e qartë se si do të zbatohen në drejtim të përcaktimit të shkeljes më të lehtë ose më të rëndë, në mungesë të faktorëve ose kriterëve të tjera që mund të çojnë në ndonjë ndryshim në masën e gjobës. Nga ana tjetër, edhe përcaktimi i gjobës në masën minimale prej 30.000 lekësh konsiderohet, për të njëjtat shkaqe, si një masë joproporcionale në lidhje me synimin që kërkohet të arrihet.

67. Referuar raportit të Komisionit të Ligjeve, në lidhje me masën e gjobës në rastet e kundërvajtjeve administrative, nga ekspertët e MONEYVAL dhe FATF-së është vënë në dukje që sanksioni duhet të jetë mjaftueshëm parandalues e ndëshkues, për të mos lejuar kryerjen e shkeljeve. Sipas këtij raporti, masat e gjobës, të cilat janë rishikuar në vijim të shqetësimeve të paraqitura nga OJF-të, respektojnë parimin e proporcionalitetit, që do të thotë se masa e gjobës vendoset në përputhje me të ardhurat vjetore të deklaruara nga organizata, duke u garantuar një balancë e duhur ndërmjet masës së gjobës si detyrim nga angazhimet në nivel ndërkombëtar dhe interesit të OJF-ve për të mos u gjobitur menjëherë, por vetëm nëse nuk kanë plotësuar detyrimin e njoftuar nga gjykata ose kancelari.

68. Në vlerësimin e Gjykatës, parashikimi i këtyre gjobave nuk konsiderohet se është i përshtatshëm me natyrën e kundërvajtjes administrative për të cilën janë parashikuar dhe as nuk konsiderohen të nevojshme e të domosdoshme për të justifikuar arritjen e qëllimit dhe objektivit për të cilin ato janë parashikuar, duke e shndërruar në arbitrar kufizimin e lirisë kushtetuese të organizimit. Në mënyrë që të jetë proporcionale, ndërhyrja duhet të korrespondojë me ashpërsinë e shkeljes dhe dënimi me peshën e kundërvajtjes që synon të ndëshkojë. Nga ana e subjekteve të interesuara nuk janë paraqitur arsye dhe argumente për të justifikuar vendosjen e këtyre masave për shkelje të këtij lloji dhe natyre dhe as ndikimin dhe efektet e tyre në aftësinë e OJF-ve për të ushtruar veprimtarinë e tyre për qëllime të ligjshme. Po kështu, ato nuk kanë paraqitur argumente në lidhje me parametrat e vlerësimit ose kriteret vlerësues mbi të cilat kanë

parashikuar masat e këtyre gjobave, si për sa i përket minimumit të masës, ashtu edhe marzheve mbi të ardhurat vjetore të deklaruara. Duke konsideruar si shkelje administrative deklarimin e të dhënave të pavërteta dhe regjistrimin e të dhënave të tjera tej afatit ligjor, masa e gjobës për këto raste nuk duket të korrespondojë me ashpërsinë e shkeljes, duke rrezikuar kështu të kthehet në një formë censurimi dhe pengesë për ushtrimin e veprimtarisë.

69. Për rrjedhojë, parashikimet e pikave 2 deri në 5 të nenit 49 të ligjit nr. 80/2021 nuk plotësojnë standardet e kërkuara për proporcionalitetin e kufizimit, duke mos respektuar kështu kriteret kushtetuese të kufizimit të lirisë së organizimit, ndaj duhet të shfuqizohen.

B.3. Për pretendimet e tjera

70. Në lidhje me pretendimet e kërkuesit për përmbajtjen e nenit 5, pika 2, nenit 9, pika 1, shprehja “ose me emra që janë në kundërshtim me rendin ose me dispozitat urdhëruese të ligjit”, nenit 17, pika 3, shkronja “a”, nenit 20, pika 2, shkronja “c”, nenit 36, pikat 1 dhe 2, dhe nenit 50, pika 5, të ligjit nr. 80/2021, Gjykata do të vlerësojë në vijim nëse këto parashikime sjellin kufizim ose ndërhyjnë në lirinë kushtetuese të organizimit.

71. Gjykata vëren se sipas pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr. 80/2021, regjistri përmban të dhëna parësore dhe dytësore, që i përkasin themelimit, veprimtarisë dhe çregjistrimit të organizatave jofitimprurëse, çdo ndryshim në statut dhe organizimin e subjektit, të dhënat që i përkasin në lidhje me përfaqësimin, si dhe të dhëna të tjera të parashikuara me ligj. Kurse në pikën 2 është parashikuar se Këshilli i Ministrave miraton rregulla të detajuara për të dhënat parësore dhe dytësore, që regjistrohen në regjistrin elektronik për dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave, si dhe për nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara. Në përputhje me parashikimet e pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 80/2021 dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325/2010, është miratuar VKM-ja nr. 94/2022, që ka për objekt përcaktimin e rregullave të detajuara për të dhënat parësore dhe dytësore, që regjistrohen në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse, për dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave, si dhe për nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse.

72. Gjykata vëren se pretendimi i kërkuesve për përmbajtjen e nenit 5, pika 2, në thelb, është i lidhur



me delegimin që norma e kundërshtuar ka bërë për rregullimin me akt nënligjor të të dhënave parësore dhe dytësore, por nuk ka arritur ta lidhë këtë pretendim me cenimin e lirisë së organizimit. Në jurisprudencën kushtetuese është argumentuar se subjektet e parashikuara në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës nuk legjitimohen të kërkojnë antikushtetutshmërinë e normës juridike duke paraqitur si argument ekzistencën e veseve formale, në qoftë se vetë norma nuk ka cenuar ndonjë të drejtë a liri kushtetuese nga ato që subjekti legjitimohet t'i mbrojë para Gjykatës (*sib vendimin nr. 25, datë 29.7.2008, të Gjykatës Kushtetuese*). Kërkuesit jo vetëm që nuk kanë argumentuar nga pikëpamja kushtetuese cenimin që sjell parashikimi i kundërshtuar, për më tepër kur rregullimi me akt nënligjor është bërë në përputhje me parashikimet e tjera ligjore, por ata nuk kanë kundërshtuar as parashikimet e VKM-së nr. 94/2022 në drejtim të rregullimeve që ka sjellë ky akt për sa i përket bazës së të dhënave dhe aksesit e ndërveprimit me to. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesve në këtë drejtim është i pabazuar.

73. Për pretendimin për shprehjen “ose me emra që janë në kundërshtim me rendin ose me dispozitat urdbëruese të ligjit”, në pikën 1 të nenit 9 të ligjit nr. 80/2021, Gjykata vlerëson se kërkuesit nuk kanë arritur të argumentojnë se për nga mënyra se si është formuluar dispozita e kundërshtuar, ajo mund t'u nënshtrohet interpretimeve të ndryshme. Ata nuk kanë argumentuar se ajo paraqet të tilla paqartësi që sjellin nevojën për interpretim të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm ose se mund të çojë në interpretim të gjerë dhe të paparashikueshëm nga organet shtetërore gjatë zbatimit të saj. Ky parashikim nuk mund të konsiderohet se u jep diskrecion autoriteteve (gjykatës) që të veprojnë në mënyrë të pakufizuar dhe as nuk mund të çojë në përfundim se e bën të pamundur për organizatat që dëshirojnë të regjistrohen që të parashikojnë se cilat janë ato emërtime (jo veprimtari në kuptim të nenit 46, pika 3, të Kushtetutës) të cilat nuk janë të lejueshme sipas ligjit. Fjala “rend” e përdorur në këtë dispozitë, në vlerësimin e Gjykatës, nuk duket se ka pasur për qëllim të sjellë një kuptim ose koncept tjetër të ndryshëm nga ai të cilit i referohet legjislacioni në tërësi.

74. Në lidhje me përmbajtjen e nenit 20, pika 2, shkronja “c”, të ligjit nr. 80/2021, Gjykata vëren se ajo parashikon çregjistrimin e OJF-ve edhe sipas

parashikimit të ligjeve të posaçme. Duke e parë përmbajtjen e nenit 20 në tërësinë e tij, rezulton se sipas pikës 1 të kësaj dispozite, organizatat çregjistrohen nga regjistri elektronik në rastet e parashikuara nga ligji që përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe veprimtarinë e tyre, në rastet kur ligji parashikon prishjen dhe pavlefshmërinë e personave juridikë dhe në çdo rast tjetër të parashikuar nga legjislacioni. Në vlerësimin e Gjykatës vetëm referimi në legjislacionin në fuqi nuk është i mjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese për të argumentuar këtë pretendim. Kërkuesit nuk kanë paraqitur argumente me natyrë kushtetuese në këtë drejtim, duke mos argumentuar se në ç'mënyrë ky parashikim sjell pasoja, pra ndërhyr në lirinë e organizimit. Përkundrazi, në ndryshim nga sa pretendojnë kërkuesit, referimi në akte të tjera ligjore në fuqi nuk lejon zbatimin e këtij parashikimi në mënyrë diskrecionare nga organi që e zbaton atë, duke qenë se çregjistrimi bëhet vetëm në ato raste shtetërore të parashikuara në mënyrë të qartë nga normat ligjore. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesve është i pabazuar.

75. Edhe në lidhje me parashikimet e nenit 17, pika 3, shkronja “a” dhe nenit 36, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 80/2021, Gjykata vëren se ato, në vetvete, nuk përcaktojnë detyrime të reja për OJF-të, por u referohen atyre detyrimeve që burojnë nga legjislacioni në fuqi dhe që kanë të bëjnë me pagimin e detyrimeve tatimore apo të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

76. Gjykata vëren se neni 17, i ligjit nr. 80/2021 parashikon se çdo organizatë jofitimprurëse që kryen regjistrimin fillestar mbart edhe detyrimin të regjistrojë çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara dhe në dokumentet shoqërore që depozitohen në regjistrin elektronik, sipas seksionit III të kreut II të këtij ligji (pika 1). Kurse sipas pikës 3 të këtij neni, përveç sa parashikohet në pikën 1 të tij, OJF-të duhet të regjistrojnë dhe të depozitojnë edhe aktet e përcaktuara në këtë dispozitë. Sipas nenit 36 të ligjit, regjistrimi në regjistrin elektronik përbën gjithashtu regjistrimin e njëkohshëm pranë administratës tatimore qendrore dhe vendore në skemën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe pranë Inspektoratit të Punës dhe OJF-të, për qëllimet e regjistrimit të pajisjes me certifikatën e regjistrimit fillestar, deklarojnë gjithashtu të dhënat e detyrueshme sipas legjislacionit tatimor, të



sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe atij të statistikave sipas formularëve përkatës (pikat 1 dhe 2).

77. Neni 17, pika 3, shkronja “a”, i ligjit nr. 80/2021 nuk ka shtuar të dhënat dhe informacionin që OJF-të duhet të paraqesin apo që duhet të bëjnë publike dhe as nuk ka rritur mënyrën ose formën apo numrin e raportimeve përgjatë vitit, pra nuk ka vendosur kërkesa dhe detyrime shtesë. Ky parashikim zbatohet ndaj atyre subjekteve që mbartin detyrimin sipas legjislacionit në fuqi, duke mos qenë për rrjedhojë një kriter i ri. Ai nuk ka shtuar detyrime ligjore për subjektet, duke mos vendosur një barrë të re financiare, qoftë për përgatitjen e pasqyrave, qoftë për mbajtjen e regjistrimit të tyre për kërkuesit apo për çdo organizatë tjetër që sipas legjislacionit nuk i nënshtrohet një detyrimi të tillë. Për rrjedhojë, ai nuk i vendos OJF-të në një situatë pasigurie juridike dhe nuk sjell kufizim ose mohim të ushtrimit të lirë të veprimtarisë prej tyre, as nuk rezulton t'i pengojë në atë masë që e bën të pamundur ushtrimin e kësaj veprimtarie.

78. Nga ana tjetër, detyrimi për regjistrim në administratën tatimore buron nga ligji nr. 9920/2008, i cili në nenin 40 parashikon edhe OJF-të, ku përfshihen fondacionet, shoqatat, qendrat, si dhe degët e OJF-ve të huaja të regjistruara në regjistrin e organizatave jofitimprurëse, kurse sipas nenit 42 të tij, organizatat jofitimprurëse regjistrohen në administratën tatimore, pasi kanë kryer më parë regjistrimin, në përputhje me legjislacionin e fushës dhe administrata tatimore mban një regjistër elektronik të veçantë për këto organizata. Kërkuesit nuk kanë argumentuar se në cilin aspekt kjo njëkohshmëri e regjistrimit sjell për ta një barrë të parakohshme, ndërkohë që detyrimet për regjistrim burojnë nga legjislacioni i posaçëm dhe jo nga ligji i kundërshtuar. Neni 36 i ligjit, ashtu siç kanë argumentuar edhe subjektet e interesuara, ka synuar të lehtësojë procedurat e regjistrimit për këto subjekte, por pa shtuar detyrime për to dhe as për mënyrën e zbatimit të ligjeve të posaçme në fushën e tatimeve dhe sigurimeve shoqërore.

79. Kurse në lidhje me përmbajtjen e pikës 5, të nenit 50, të ligjit nr. 80/2021, Gjykata vlerëson se kjo dispozitë jo vetëm që i ka përfunduar efektet e saj, por nuk është provuar të ketë sjellë ndonjë pasojë të drejtpërdrejtë dhe reale në ushtrimin e lirisë kushtetuese të organizimit.

80. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesve në lidhje me përmbajtjen e nenit 5, pika 2, nenit 9, pika 1, shprehja “ose me emra që janë në kundërshtim me rendin ose me dispozitat urdhëruese të ligjit”, nenit 17, pika 3, shkronja “a”, nenit 20, pika 2, shkronja “c”, nenit 36, pikat 1 dhe 2 dhe nenit 50, pika 5, të ligjit nr. 80/2021 janë të pabazuara.

81. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesve në lidhje me përmbajtjen e nenit 8 të ligjit nr. 80/2021, që parashikon regjistrimin fillestar brenda afatit 30-ditor, të neneve 26; 28, pika 6; 29, pika 1; 30, pikat 1, 2 dhe 3; 32; 33, pikat 2 dhe 6; 34; 35, pika 1; 46, pika 1, dhe 49, pika 6, që kanë të bëjnë me kompetencat e kancelarit, ashtu edhe të pikave 2–5 të nenit 49, që kanë të bëjnë me masën e gjobës për kundërvajtjet administrative, të ligjit nr. 80/2021, janë të bazuara sipas arsyesimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e shprehjes “për regjistrim fillestar” në nenin 8; e shprehjes “kancelari?” në nenin 26; e shprehjes “ose nga kancelari” në pikën 6, të nenit 28; e shprehjes “ose kancelari?” në pikën 1, të nenit 29 dhe në pikën 1, të nenit 30; e shprehjes “ose të kancelarit” në pikën 2, të nenit 30; e pikës 3, të nenit 30; e nenit 32; e shprehjes “të kancelarit” në pikën 2, të nenit 33; e pikës 6, të nenit 33; e shprehjes “ose i kancelarit” në nenin 34; e shprehjes “i kancelarit” në pikën 1 të nenit 35; e shprehjes “përfshirë këtu procedurën e ankimit ndaj vendimit të kancelarit, sipas nenit 33 të këtij ligji” në pikën 1 të nenit 46; e pikave 2 deri në 6, të nenit 49, të ligjit nr. 80/2021, datë 24.6.2021, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Rrëzimin e kërkesës për pjesën tjetër.



Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 20.11.2023.

Shpallur më 28.12.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Ilir Toska,

Anëtarë pjesërisht kundër: Marjana Semini, Elsa Toska

MENDIM I PJESSHËM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje për shfuqizimin e shprehjes “*kancelari*” në nenin 26; shprehjes “*ose nga kancelari*” në pikën 6, të nenit 28; shprehjes “*ose kancelari*” në pikën 1, të nenit 29 dhe në pikën 1, të nenit 30; shprehjes “*ose të kancelarit*” në pikën 2, të nenit 30; pikës 3, të nenit 30; nenit 32; shprehjes “*të kancelarit*” në pikën 2, të nenit 33; pikës 6, të nenit 33; shprehjes “*ose i kancelarit*” në nenin 34; shprehjes “*i kancelarit*” në pikën 1, të nenit 35; shprehjes “*përfshirë këtu procedurën e ankimit ndaj vendimit të kancelarit, sipas nenit 33 të këtij ligji*” në pikën 1, të nenit 46 të ligjit objekt kundërshtimi dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice.

2. Në mënyrë të përmbledhur, ne vlerësojmë se:

i. Dispozitat prezumohen kushtetuese derisa të provohet e kundërta nga kërkuesit. Kjo do të thotë se kompetencat e kancelarit prezumohen në përputhje me nenin 46, paragrafi 2, të Kushtetutës, për sa kohë që argumentet e kërkuesve nuk ishin ngritur në nivel kushtetues që ta përmbysnin këtë prezumim kushtetues.

ii. Bazuar në interpretimin origjinal, gjuhësor, sistematik dhe teleologjik të kapitullit mbi të drejtat e njeriut dhe specifikisht nenit 46, paragrafi 2, të Kushtetutës, nocioni kushtetues “në gjykatë”, duhet të kuptohet si institucion dhe jo *strictu sensu* si “gjyqtar/organ gjyqësor”.

iii. Kancelari kryen funksione administrative brenda gjykatës, për më tepër që disa nga kompetencat e tij lidhen me administrimin gjyqësor, ndaj dhe në këtë kontekst vendimmarrja e tij sipas ligjit objekt kundërshtimi nuk cenon kërkesat e

pavarësisë dhe të paanësisë brenda nocionit kushtetues “në gjykatë”.

iv. Ligjvënësi nuk ka cenuar standardin për respektimin e proporcionalitetit të vlerave kushtetuese, duke synuar eficiencë dhe efikasitet të sistemit gjyqësor, përmes uljes së barrës së procedurës gjyqësore, pa cenuar lirinë e organizimit të organizatave ose shoqatave, pasi vendimet e kancelarit për regjistrimet e tjera, ankimohen, ndaj dhe sistemi njeh dhe garanton korrigjimin e veprimeve të paligjshme të kancelarit nga gjyqtari/organi gjyqësor.

3. Për sa më lart, argumentet e detajuara do t'i parashtrijmë në vijim:

4. Në përputhje me parimin e shtetit të së drejtës, të parashikuar në nenin 4, paragrafi 1, të Kushtetutës, në të cilin përcaktohet se: “E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit”, ku as vetë Gjykata nuk përjashtohet nga respektimi i ndarjes së juridiksioneve dhe parimi i ndarjes së pushteteve. Po në këtë drejtim, ruajtja e balancës mes kreativitetit gjyqësor dhe qëllimit të parashikimeve kushtetuese është detyrim i Gjykatës, të cilin ajo e ka shprehur edhe përmes *parimit të vetëpërmbytjes (judicial self restraint)*.

5. Kushtetuta në nenin 131, pika 1, të saj, i ka dhënë juridiksion Gjykatës të vendosë, ndër të tjera, për: “a) pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën [...]”. Për të shmangur çdo mundësi për ndërhyrje në kompetencat e pushtetit ligjvënës, Gjykata nuk merr përsipër të kryejë rolin e legjislatorit, por synon t’u japë jetë normave kushtetuese përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre (*shih vendimet nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 29, datë 30.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Për më tepër, Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e kushtetutshmërisë së kufizimit të të drejtave dhe lirive individuale, ajo nisat nga prezumimi i kushtetutshmërisë së ligjit me Kushtetutën. Kjo do të thotë se Gjykata nuk ka autoritet të kontrollojë synimet dhe drejtësinë e zgjidhjeve të aplikuara nga ana e ligjvënësit. Detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të aplikuara nuk shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimin nr.16, datë 25.7.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Në drejtim të rolit të administratës gjyqësore, Gjykata është shprehur edhe më parë se: “[...] duke pasur parasysh frymën dhe përmbajtjen e neneve 7, 42, 144 dhe 145 të Kushtetutës, roli dhe funksionimi i administratës gjyqësore nuk mund të ndahet nga



funkcioni i dhënies së drejtësisë dhe përbën një element të rëndësishëm të pavarësisë organizative të pushtetit gjyqësor (*shih vendimin nr.19, datë 3.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Nga ana tjetër, Gjykata është shprehur se Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka detyrën për të realizuar “vetëqeverisjen” e gjyqësorit dhe, sipas neni 147 të Kushtetutës, është organi kushtetues i pozicionuar në majën e piramidës organizative të pushtetit gjyqësor. Për të realizuar vetëqeverisjen e gjyqësorit, KLD-ja përbëhet në shumicën e tij nga gjyqtarë, të cilët, duke ushtruar funksionet e tyre si të tillë, realizojnë lidhjen me korpusin gjyqësor. Frymën e vetëqeverisjes në KLD kushtetutëbërësi e ka përfshirë me qëllimin për ta bërë Gjykatën të pavarur nga ndërhyrjet e çdo pushteti tjetër (*shih vendimet nr.20, datë 9.7.2009; nr.11, datë 2.4.2008; nr.14, datë 22.5.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në vështrim të standardeve të mësipërme, do të duhej që nga ana e shumicës të analizoheshin roli dhe kompetencat e kancelarit brenda gjykatës në kuptim të pavarësisë dhe paanësisë së tij, veçanërisht pas rolit të ri që iu dha këtij pozicioni nga reforma në drejtësi e vitit 2016 me ligjin nr. 98/2016, që parashikon: i. Kancelari i gjykatës është anëtar i Këshillit Drejtues (*shih nenin 27, pika 2, shkronja “c”, të ligjit 98/2016*); ii. kompetencat e kancelarit (*shih nenin 39, të ligjit nr. 98/2016*); mënyrën e zgjedhjes dhe të shkarkimit nga detyra nga KLGJ-ja (*shih nenin 59 dhe nenin 69/2, të ligjit nr. 98/2016*), analizë që i mungon vendimit, për të arritur në konkluzionin se dhënia e kompetencës këtij organi për të kryer regjistrimet e tjera cenon lirinë e organizimit të organizatave ose shoqatave, deri në atë masë që e shuan thelbin e së drejtës për regjistrim.

9. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, argumentet e kërkuësve janë se parashikimet e neneve 26, 28, pika 6 dhe 32, ku përcaktohen kompetencat e kancelarit, nuk përmbushin garancitë dhe standardet ndërkombëtare, pasi ai nuk është autoritet vendimmarrës, i pavarur dhe i paanshëm (*shih paragrafin 8.7. të vendimit*). Prapësimet e subjektit të interesuar, Kuvendit, janë se në lidhje me pretendimet për nenet 26, 28, pika 6 dhe 32, që kanë të bëjnë me kompetencat e kancelarit, kërkuësit nuk kanë arritur të analizojnë normat juridike që kanë të bëjnë me emërimin dhe shkarkimin e tij, megjithëse ligji nr. 98/2016 ka garantuar pavarësinë dhe paanësinë e tij. Në rastin konkret, qëllimi i ligjvënësit ka qenë efektiviteti i procesit, ulja e barrës së

procedurës gjyqësore, lehtësimi i veprimeve, etj. (*shih paragrafin 9.8. të vendimit*).

10. Ndërkohë sipas shumicës: “[...] Edhe në frymën e dispozitave kushtetuese për ndarjen dhe balancimin e pushteteve, kancelari i gjykatës, megjithëse ushtron detyrën pranë gjykatës, nuk përfshihet në konceptin kushtetues “gjykatë”, për sa u përket çështjeve që lidhen me regjistrimin e organizatave jofitimprurëse. Në kuptim të nenit 37, të ligjit nr. 98/2018, kryetari i gjykatës kujdeset për organizimin dhe funksionimin e administrimit gjyqësor në gjykatë në lidhje me veprimtaritë jogjyqësore nëpërmjet kancelarit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, kurse sipas nenit 39, kancelari është përgjegjës për menaxhimin e administrimit gjyqësor, duke përcaktuar edhe kompetencat që ai ushtron në këtë drejtim. Çështjet që kanë të bëjnë me regjistrimin e OJF-ve, për shkak të natyrës dhe pasojave të tyre, nuk përfshihen në konceptin e çështjeve jogjyqësore ose administrative, pra nuk janë të tilla që përfshihen në fushën e kompetencave të menaxhimit dhe administrimit gjyqësor, sipas ligjit. (...) Për sa më sipër, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë edhe procedurën që përmban ligji për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, vlerëson se kompetencat që i janë dhënë kancelarit tejkalojnë kompetencat e menaxhimit dhe administrimit gjyqësor, duke pasur në vetvete natyrë gjyqësore dhe për këtë shkak duhej të ushtrohen nga gjyqtari/gjykata. Ligjvënësi, në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës, ka tejkaluar parashikimin kushtetues, që në mënyrë të qartë ka parashikuar se regjistrimi i organizatave ose shoqatave bëhet në gjykatë, e cila është organi i vetëm kompetent në lidhje me çdo veprim që kryhet nga organizata ose shoqata, si në lidhje me fitimin e personalitetit juridik ose përfundimin e tij, ashtu edhe me veprimet që lidhen me ushtrimin e kësaj veprimtarie, deri në vendosjen e pezullimit ose të gjobës, sipas ligjit. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se dispozitat e neneve 26, 28, pika 6, 29, pika 1, 30, pikat 1, 2 dhe 3, 32, 33, pikat 2 dhe 6, 34, 35, pika 1 dhe 46, pika 1, në atë pjesë që parashikojnë kompetencën e kancelarit për ushtrimin e kompetencave që sipas nenit 46 të Kushtetutës i përkasin ekskluzivisht organit gjyqësor, janë të papajtueshme me Kushtetutën. (*shih paragrafët 51 dhe 52 të vendimit*).



11. Në aspektin gjuhësor dhe teleologjik, duke iu referuar kapitullit për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duhet evidentuar se kur ka dashur kushtetutëbërësi ka përdorur termin “vendim gjyqësor” ose “gjyqtar”. Kështu, në nenin 26 ka përdorur termin “vendim gjyqësor”, në nenin 27 ka përdorur termin “urdhbra të ligjshëm të gjykatës”, në nenin 28/2 ka përdorur termin “përpara gjyqtarit”, në nenin 28/3 ka përdorur termin “gjyqtarit”, në nenin 43 “vendimin në një gjykatë më të lartë”, ndërsa në nenin 46 ka përdorur termin “në gjykatë”.

12. Sipas vlerësimit tonë, nenet e krahasuara kanë dallim në varësi të gjuhës kushtetuese të përdorur dhe garancive kushtetuese që ka dashur të japë kushtetutëbërësi sipas llojit të së drejtës dhe natyrës së mbrojtjes gjyqësore. Referuar Debatit Kushtetues, gjatë diskutimeve për hartimin e normës kushtetuese të lidhur me regjistrimin e organizatave, është evidentuar se: [...] parashikohet regjistrimi në gjykatë si një element shumë i rëndësishëm, e cila i kundërvihet ndonjë praktike të derisotme që regjistrimi bëhej në ndonjë ministri ose degë tjetër të ekzekutivit...”. (shih *Debatin Kushtetues, Diskutimet mbi hartimin e Projekt Kushtetutës, vëllimi I, faqja 103*). Në rastin konkret, termi kushtetues “në gjykatë” nuk ka pasur si qëllim njësimin me organin gjyqësor ose gjyqtarin, ose regjistrimin përpara gjyqtarit me vendim gjyqësor, por shmangien e përcaktimit me ligj të kompetencës së regjistrimit të ndonjë autoriteti ekzekutiv, sikundër rezultoi edhe nga interpretimi origjinal i normës, ndaj dhe qëndrimi i shumicës, që ua njeh kompetencat e regjistrimit për çdo të dhënë të organizatave ekskluzivisht gjyqtarit, ka tejkaluar përmbajtjen e normës kushtetuese dhe qëllimin e saj.

13. Për më tepër, vetë neni 46, pika 2, i Kushtetutës, referon regjistrimin sipas procedurës së parashikuar në ligj, që do të thotë se përmes rezervës ligjore, kushtetutëbërësi ia ka lënë ligjvënësit kompetencën për të përcaktuar modalitetet e regjistrimit, (çfarë do të konsiderohet regjistrim, llojet e regjistrimeve, procedura, afatet, organet kompetente, etj.). Shumica arsyeton se: “[...] sipas pikës 11, të nenit 3, të ligjit nr. 80/2021, “regjistrim” është regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër, përfshirë edhe transformimin, bashkimin, çregjistrimin e subjektit nga regjistri. Në këto kushte, në lidhje me konceptin kushtetues “regjistrim”, Gjykata vlerëson se ai është akti/rezultati në fund të procedurës së parashikuar

me ligj, me të cilin organizata jofitimprurëse fiton personalitetin juridik, duke qenë e aftë të marrë përsipër të drejta dhe detyrime nga veprimtaria jofitimprurëse për qëllime të ligjshme.” (shih *paragrafin 49 të vendimit*). Ky argumentim, që për të shpjeguar konceptin kushtetues “regjistrim”, i referohet ligjit objekt kundërshtimi, në vlerësimin tonë nuk i përgjigjet qëllimit të normës kushtetuese. Duke iu referuar po Debatit Kushtetues, theksohet se: “[...] gjykata duhet ta regjistrojë një organizatë për çdo qëllim të ligjshëm, por që nuk bie në kundërshtim me Kushtetutën. Në rast se konstaton një qëllim antikushtetues, gjykata nuk e regjistron” (shih *Debatin Kushtetues, Diskutimet mbi hartimin e Projekt Kushtetutës, vëllimi I, faqet 101–102*). Në interpretimin sistematik të nenit 46 të Kushtetutës, gjykata verifikon të drejtën e organizimit sipas një qëllimi të ligjshëm dhe po ashtu ajo mund të ndalojë organizatat ose shoqatat që ndjekin qëllime antikushtetuese. Në vështrimin qëllimor të dispozitës, kjo normë kushtetuese pohon për sa vijon: i. Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm; ii. regjistrimi në gjykatë i organizatave ose i shoqatave bëhet sipas procedurës së parashikuar me ligj; iii. organizatat ose shoqatat që ndjekin qëllime antikushtetuese janë të ndaluara sipas ligjit.

14. Për të gjitha sa më lart, shumica ka ngushtuar nocionet kushtetuese, në atë mënyrë që, në vlerësimin tonë, nisur nga metodat e interpretimit në kapitullin për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe nisur nga tërësia e vetë nenit 46 të Kushtetutës, as kushtetutëbërësi nuk e ka pasur si qëllim. Nëse shumica do të kishte përdorur teknikat e interpretimit ashtu siç duhet, duke afirmuar kuptimin që ka normës kushtetuese, ajo do të duhej që të arrinte në konkluzionin se ligji objekt kundërshtimi nuk ka cenuar nenin 46, pika 2, të Kushtetutës, në drejtim të kompetencave të dhëna kancelarit për regjistrimet e tjera.

15. Për më tepër, sikundër rezultoi në gjykimin kushtetues të kësaj çështjeje, qëllimi i ligjvënësit ka qenë ulja e volumit të ngarkesës së gjyqtarëve në rastin kur ato lidhen me verifikimin ose shqyrtimin e dokumentacionit, të fakteve apo ligjit, që nuk kanë nevojë për analizë të thelluar gjyqësore. Në këtë aspekt, në vlerësimin tonë, mjeti i zgjedhur nga ligjvënësi, pra vendimmarrja e kancelarit nuk përbën, në raport me qëllimin për të cilin është vendosur, një kufizim joproporcional. Zgjedhja e



ligjvënësit nuk u provua se është në atë nivel që të ketë prekur vlera kushtetuese që kanë lidhje me thelbin e lirisë së organizimit, madje, dukshëm, kërkuesit me argumentet e tyre nuk kanë arritur të përmbysin prezumimin e kushtetutshmërisë, pasi janë fokusuar në elementet e pavarësisë dhe të paanësisë së kancelarit, që nëse do të ishin analizuar nga shumica sipas standardeve kushtetuese, do të arrihej në konkluzionin që ky organ administrativ i përmbush ato në një masë të konsiderueshme. Nëse do të pranoheshin argumentet e kërkuesve dhe një sërë kompetencash të tjera të dhëna kancelarit me ligj, do të passillnin antikushtetushmërinë e rolit dhe funksioneve të tij brenda gjykatës në të gjithë sistemin e pushtetit gjyqësor. Kjo sepse, kancelari ka një sërë funksionesh dhe disa prej tyre lidhen me administrimin e drejtësisë, në veçanti, roli i tij i të qenit mbikëqyrës në procesin e organizimit dhe dokumentimit të ndarjes së çështjeve me short, si dhe të qenit përgjegjës për funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për teknologjinë dhe sigurinë e informacionit dhe mbikëqyrjen e mbledhjes dhe përpunimit të saktë të të dhënave, si dhe udhëzimin dhe mbikëqyrjen e punës së nëpunësve civilë gjyqësorë të gjykatës, pas këshillimit me Kryetarin e Gjykatës. (*shih nenin 39, pika 1, shkronja "a", si dhe pika 2, shkronjat "a" dhe "ç", të ligjit*). Po në këtë kontekst, argumentet e shumicës që analizojnë kompetencat e kancelarit sipas ligjit objekt kundërshtimi, si jo në përputhje me kompetencat e kancelarit të menaxhimit dhe administrimit gjyqësor, sipas ligjit nr. 98/2016, (*shih prg. 51 të vendimit*), nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, pasi sikundër kjo Gjykatë ka theksuar ndër vite, nuk është detyrë e saj shqyrtimi i përplasjeve dhe papajtueshmërive mes ligjeve. Po kështu, mënyra e harmonizimit ndërmjet dispozitave të ligjeve, me ligje të tjera, nuk janë çështje që i përkasin kontrollit kushtetues, e për rrjedhojë nuk janë objekt shqyrtimi nga Gjykata (*shih vendimet nr. 5, datë 5.2.2015; nr. 2, datë 3.2.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Nga ana tjetër, në vlerësimin tonë, nuk mund të mos merret në konsideratë aftësia e sistemit për të qenë korrigjues, pasi çdo veprim i kancelarit mund të ankimohet në rrugë gjyqësore, ndaj, edhe në këtë kuptim, ligjvënësi nuk ka cenuar ekuilibrin e parimeve kushtetuese, ku, nga njëra anë, t'i përgjigjet interesit publik të eficiencës së gjyqësorit

dhe mosrëndimit të gjyqtarëve me procedura shitesë, ndërsa, nga ana tjetër, në rast paligjshmërie nga veprimet e kancelarit, organizata ose shoqata ka të drejtën e ankimit në gjykatë, si për çdo lloj vendimi tjetër administrativ.

17. Si konkluzion, për të gjitha për sa më lart, nenet të cilat përcaktojnë kompetencat e kancelarit në lidhje me regjistrimet e tjera të organizatave ose shoqatave sipas ligjit objekt kundërshtimi, nuk u provuan gjatë gjykimit se cenojnë parimet dhe vlerat kushtetuese, ndaj edhe kjo pjesë e kërkimit duhej rrëzuar.

18. Përveç sa më lart, duam të theksojmë se kemi votuar për shfuqizimin e parashikimit të kompetencës së kancelarit, sipas nenit 49, pika 6, të ligjit nr. 80/2021, për vendosjen e gjobës në rast të kundërvajtjes administrative, por jo me argumentin e shumicës se nuk është i pajtueshëm me natyrën e këtij funksioni. (*shih prg. 52 të vendimit*). Sipas vlerësimit tonë, në vështrim të qartësisë juridike që e gjithë dispozita duhet të ketë, ku parashikohen llogaritja dhe masa e gjobave, (pika 2 deri 4), si dhe se kancelari sipas ligjit *krjesisht* bën konstatime për deklarimin e të dhënave të pavërteta ose se organizata nuk ka përmbushur detyrimet për regjistrim fillestar, ose regjistrime të tjera sipas ligjit (pika 5) dhe se vendos gjoba sipas kriterëve të legjislacionit për kundërvajtjet administrative, (pika 6) e bën dispozitën të detyrueshme për rishikim nga pikëpamja legjislative e qartësisë dhe saktësisë së normës juridike, për sa kohë që u shfuqizua e gjitha, përveç pikës 1 të saj.

Anëtarë: Marjana Semini, Elsa Toska



VENDIM
Nr. 64, datë 30.11.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

| | |
|---------------------|-----------|
| Holta Zaçaj | kryetare; |
| Fiona Papajorgji | anëtare; |
| Elsa Toska | anëtare; |
| Sonila Bejtja | anëtare; |
| Ilir Toska | anëtar; |
| Genti Ibrahim | anëtar; |
| Marjana Semini | anëtare; |
| Sandër Beci | anëtar; |
| Marsida Xhaferllari | anëtare, |

me sekretare Belma Lleshi, në datën 30.11.2023,
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të
dokumenteve çështjen nr. 2 (D) 2023 të Regjistrat
Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Durim Grabova

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e
Përgjithshme e Metrologjisë, përfaqësuar nga
drejtori i përgjithshëm Petrit Rama, Avokatura e
Shtetit, përfaqësuar nga Avokatja e Shtetit Irma
Qosja, me autorizim.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për
një proces të rregullt ligjor si pasojë e
mosekzekutimit të vendimit nr. 232, datë 1.2.2021,
të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë
Tiranë.

Konstatimi i cenimit të së drejtës për të mos u
diskriminuar, si pasojë e statusit si ish i përndjekur
politik nga regjimi komunist.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, pika 2, 42, pika 1,
44, 131, pika 1, shkronja “P”, 132, pika 1 dhe 134,
pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së
Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1 dhe 14 të
Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe
neni 1, i Protokollit nr. 12, të saj (*KEDNJ*); nenet 27,
71 dhe 71/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për
organizimin dhe funksionimin e Gjykatës
Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të
ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida
Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me

shkrim të kërkuarit Durim Grabova, i cili ka kërkuar
pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të
interesuara, Drejtorisë së Përgjithshme të
Metrologjisë (*DPM*) dhe Avokaturës së Shtetit, që
kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi
çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuar Durim Grabova, i cili ka statusin e
ish të përndjekurit politik gjatë regjimit komunist, ka
ushtruar detyrën e drejtorit të Burimeve Njerëzore
dhe Shërbimeve pranë subjektit të interesuar, DPM-
së, prej datës 24.12.2007. Në datën 26.9.2013,
drejtori i përgjithshëm i DPM-së ka urdhëruar
zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me motivin “Për
përmirësim të treguesve të punës”.

2. Kërkuar ka paraqitur padi në Gjykatën
Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (*Gjykata*
Administrative), duke kërkuar rikthimin në detyrën e
mëparshme dhe pagimin e pagave deri në momentin
e ekzekutimit të vendimit. Gjykata Administrative e
ka pranuar padinë e tij me vendimin nr. 79, datë
13.12.2013 (*vendimi nr. 79/2013*), i cili nuk është
ankimuar nga asnjë prej palëve dhe ka marrë formë
të prerë në datën 6.1.2014. Subjekti i interesuar,
DPM-ja, e ka ekzekutuar vendimin gjyqësor, duke e
rikthyer kërkuarin në detyrë në datën 26.1.2015, dhe
duke i paguar atij pagën e 16 muajve me këste.

3. Vepimtarja e subjektit të interesuar, DPM-së,
për vitet 2013–2014, është audituar nga Drejtoria e
Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Zhvillimit
Ekonomik, Turizmit dhe Sipërmarrjes, e cila ka
rekomanduar se kërkuar duhej t’i mbahej si shumë
e likuiduar tepër vlera prej 144.266 lekësh si përfitim
i padrejtë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor i vitit
2013. Rekomandimi është zbatuar nga subjekti i
interesuar me urdhrin e datës 14.9.2016. Disa ditë
më vonë, më 30.9.2016, DPM-ja ka ndërprerë
marrëdhënien e punës me kërkuarin për shkak të
mbushjes së moshës së pensionit.

4. Duke mos qenë dakord me mbajtjen e shumë
nga punëdhënësi, kërkuar ka paraqitur padi në
gjykatë për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të
urdhrit dhe kthimin e shumë. Gjykata
Administrative, me vendimin nr. 2335, datë
25.5.2017, ka vendosur pranimin e padisë. Me



arsyetimin se vlera e objektit të padisë ishte nën njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi, gjykata është shprehur në dispozitiv se ndaj vendimit nuk lejohej ankim. Në zbatim të këtij vendimi gjyqësor, DPM-ja ka nxjerrë urdhrin e shpenzimit të datës 17.11.2017, duke i kthyer kërkuesit shumën prej 144.266 lekësh.

5. Në datën 12.11.2016, kërkuesi ka paraqitur padinë tjetër në Gjykatën Administrative, përmes së cilës ka kërkuar detyrimin e subjektit të interesuar, DPM-së, që t'i paguajë interesat për vonesën e pagimit të pagave, të derdhë kontributin për sigurimin e tij shoqëror për periudhën 26.9.2013–20.1.2015, si dhe t'i kthejë shumën e mbajtur padrejtësisht si tatim mbi të ardhurat.

6. Në përfundim të gjykimit, Gjkata Administrative, me vendimin nr. 232, datë 1.2.2021 (*vendimi nr. 232/2021*), ka vendosur pranimin e padisë, duke detyruar subjektin e interesuar, DPM-në, që t'i paguajë kërkuesit shumën 261.753 lekë si interes për vonesën në pagimin e pagës së 16 muajve, si dhe të derdhë në llogarinë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) shumën 15.932 lekë si kontribut të punëdhënësit për ish-punonjësin për periudhën 26.9.2013–20.1.2015 dhe shumën 9.540 lekë si tatim mbi pagë. Në dispozitiv gjykata është shprehur se vendimi është i formës së prerë.

7. Për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor, kërkuesi, në datën 3.3.2021, i është drejtuar shoqërisë përmbarimore “Elite Bailiff’s Office” sh.p.k., e cila në datën 4.3.2021 ka lajmëruar subjektin e interesuar për ekzekutimin vullnetar, duke përllogaritur vlerën e përgjithshme të detyrimit prej 575.224,16 lekësh, nga e cila i duhej paguar kërkuesit shuma 261.753 lekë, tatimi mbi pagën e 16 muajve në shumën 152.640 lekë, të derdhej pranë ISSH-së kontributi i sigurimeve shoqërore në masën 16.7 % të pagës bruto për periudhën 26.9.2013–20.1.2015, të paguheshin shpenzimet gjyqësore në shumën 99.200 lekë dhe tarifa përmbarimore 61.631,16 lekë.

8. Në vijim, në datën 26.3.2021, shoqëria përmbarimore ka vendosur fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm dhe me shkresën e datës 8.4.2021, i ka kërkuar Degës së Thesarit Tiranë vendosjen e masës së sekuestros konservative ndaj llogarisë buxhetore të subjektit të interesuar, DPM-së. Dega e Thesarit Tiranë, pasi ka njoftuar subjektin e interesuar, DPM-në, për kërkesën në fjalë, në datën 29.4.2021, ka urdhëruar bllokimin e fondeve buxhetore në

artikullin nr. 602 të institucionit debitor për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, në favor të kërkuesit si palë kreditore.

9. Në kushtet që vendimi gjyqësor nr. 232/2021, nuk po ekzekutohej as përmes procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm, kërkuesi, në datën 21.7.2021, ka paraqitur në Gjykatën Administrative kërkesën me objekt urdhërimin e kryerjes së veprimeve të posaçme nga subjekti i interesuar, DPM-ja, për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, titull ekzekutiv. Në këtë gjykim, subjekti i interesuar ka prapësuar se detyrimi i tatimit mbi pagë, i përllogaritur nga shoqëria përmbarimore në shumën 152.640 lekë duhet të reduktohet në shumën 8.348 lekë, pasi kërkuesit i ishte paguar shuma e mbajtur padrejtësisht nga rekomandimi i auditit në vlerën 144.266 lekë. Gjkata Administrative, me vendimin nr. 53, datë 26.10.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës, duke urdhëruar subjektin e interesuar, DPM-në, që të kryejë veprimet për përfundimin e ekzekutimit për të gjitha pikat e vendimit gjyqësor brenda 1 muaji. Në dispozitivin e vendimit, gjykata është shprehur se ai ishte i formës së prerë dhe me ekzekutim të drejtpërdrejtë. Edhe pas përfundimit të afatit 1-mujor, vendimi gjyqësor në fjalë nuk u ekzekutua.

10. Në datën 17.11.2021, subjekti i interesuar, DPM-ja, ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Administrative, me objekt sqarimin dhe interpretimin e vendimit gjyqësor nr. 232/2021, me pretendimin se tatimi mbi pagën i ishte paguar kërkuesit dhe se dispozitivi i vendimit gjyqësor nuk përputhej me arsyetimin e tij. Me vendimin nr. (80-2022-6), datë 11.1.2022, Gjkata Administrative ka vendosur pushimin e gjykimit. Në datën 27.1.2022, DPM-ja ka paraqitur ankim të veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit. Çështja ende nuk është marrë në shqyrtim nga gjykata e apelit.

11. Në datën 3.3.2022, kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën Administrative kërkesën me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr. 232/2021, me pretendimin se kishte mbetur i paekzekutuar, ndonëse kishte kaluar një kohë shumë e gjatë. Sipas tij, duke qenë se prej 5 vjetësh ai përfiton pension pleqërie dhe në përcaktimin e masës së tij, nuk janë përfshirë edhe kontributet për periudhën 26.9.2013–20.1.2015, vonesa në ekzekutimin e vendimit i ka shkaktuar uljen e padrejtë të masës së pensionit.



12. Gjykata Administrative, me vendimin nr. 38, datë 7.9.2022, ka vendosur pranimin e kërkesës, duke konstatuar shkeljen e afatit të arsyeshëm 1-vjeçar në procedurën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor nga subjekti i interesuar, DPM-ja, dhe duke njohur të drejtën e kërkuarit që, sipas neneve 399/3 dhe 399/4, paragrafi i dytë, të Kodit të Procedurës Civile (KPC), t'i drejtohet gjykatës me padi për shpërblimin e dëmit. Edhe në këtë rast, gjykata është shprehur se vendimi ishte i formës së prerë.

13. Në këto rrethana, kërkuari, në datën 10.10.2022, ka paraqitur padi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me objekt shpërblimin e dëmit jopasuror në shumën 250.000 lekë të shkaktuar nga mosekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. 232/2021 nga DPM-ja.

14. Në datën 11.4.2023 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Kolegji i Gjykatës, në datën 24.5.2023, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

15. Pas kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare, shoqëria përmbarimore në datën 15.5.2023 i ka kërkuar sërish Degës së Thesarit Tiranë sekuestrimin e shumës 575.224 lekë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr. 232/2021 dhe pagimin e tarifave përmbarimore. Subjekti i interesuar, DPM-ja, në datën 29.6.2023 ka njoftuar me shkrim shoqërinë përmbarimore për vullnetin për të përbushur një pjesë të detyrimit, që lidhet me interesat për vonesën e pagimit të pagave në shumën 261.753 lekë, shpenzimet gjyqësore në shumën 99.200 lekë, si dhe tarifën përmbarimore në shumën 36.000 lekë. Për këtë qëllim, ai ka nxjerrë tre urdhra në të njëjtën datë 3.7.2023, "Për njohje si kreditor në shumën 360.953 lekë", "Për pagesë kreditori" dhe "Urdhër shpenzimi për shumën 360.953 lekë". Po kështu, subjekti i interesuar në datën 20.6.2023, i ka kërkuar Gjykatës Administrative të Apelit përshpejtimin e gjykimit të çështjes së ndreqjes, interpretimit dhe sqarimit të vendimit gjyqësor nr. 232/2021.

16. Gjithashtu, pas kalimit të çështjes në seancë plenare, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka përfunduar gjykimin për shpërblimin e dëmit të kërkuarit nga vonesa në ekzekutim (shih paragrafin 13 të vendimit më sipër). Me vendimin nr. 3416, datë 4.7.2023, gjykata ka

vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke urdhëruar shpërblimin e dëmit të kërkuarit me 240.000 lekë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim subjekti i interesuar, DPM-ja.

17. Në datën 6.9.2023, Avokati i Popullit ka lëshuar rekomandimin me shkrim drejtuar subjektit të interesuar, DPM-së, për të përbushur detyrimet e vendosura sipas vendimit nr. 232/2021. Në tekstin e këtij rekomandimi, Avokati i Popullit ka evidentuar se vendimi gjyqësor nuk ekzekutohet nga subjekti i interesuar, edhe pse nuk pretendohet se nuk disponon vlera në të holla për shlyerjen e detyrimeve financiare. Subjekti i interesuar, DPM-ja, i është përgjigjur me shkrim Avokatit të Popullit në datën 18.9.2023, duke e vënë në dijeni se ka ekzekutuar një pjesë të vendimit, që lidhet me interesat për vonesën e pagimit të pagave, por është në pamundësi të ekzekutojë detyrimin që lidhet me derdhjen e kontributeve pranë ISSH-së, për dy arsye: i. DPM-ja është në pritje të vendimmarrjes së Gjykatës Administrative të Apelit në çështjen gjyqësore që lidhet me kërkesën për korrigjimin e gabimeve materiale, interpretimin dhe sqarimin e vendimit gjyqësor nr. 232/20221; ii. nëse Gjykata Administrative e Apelit vendos në favor të DPM-së, vlera e detyrimit mund të zvogëlohet dhe nëse lëvrohet një vlerë më e madhe detyrimi, institucioni e ka të pamundur të shpallë debitor kërkuarin, i cili është pensionist.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

18. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

18.1. *E drejta për ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm*, për shkak të mosekzekutimit për më shumë se 5 vjet të vendimit gjyqësor nr. 232/2021, nga subjekti i interesuar, DPM-ja, me gjithë kërkesat dhe paditë gjyqësore të vijueshme të tij. Edhe padia për shpërblimin e dëmit nga zvarritja e ekzekutimit është në shqyrtim nga gjykata e shkallës së parë prej disa muajsh, duke tejkaluar afatin ligjor 3-mujor. Kërkuari ka dalë në pension që në vitin 2016 dhe mosekzekutimi i vendimit i ka sjellë pasoja të rënda në caktimin e masës së pensionit.

18.2. *E drejta për të mos u diskriminuar*, për shkak të statusit të tij si ish i përndjekur politik nga regjimi komunist. Organet e shtetit shqiptar kanë



ekzekutuar shumë vendime të tjera që janë me pasoja financiare më të rënda për buxhetin e shtetit sesa vlera e përcaktuar në vendimin e çështjes së tij.

19. **Subjekti i interesuar, DPM-ja**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar, si vijon:

19.1. Kërkuesi nuk legjitimohet për ngritjen e pretendimit për cenimin e së drejtës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor brenda afatit të arsyeshëm, sepse nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion. Vendimi gjyqësor është ekzekutuar pjesërisht, ndërsa pjesa që lidhet me detyrimin për derdhjen e kontributeve dhe tatimit mbi pagë nuk mund të ekzekutohet, pasi vendimi është i paqartë dhe kërkuesit i është paguar katër herë tatimi mbi pagë. Çështja e interpretimit dhe sqarimit të vendimit gjyqësor është ende në pritje për t'u shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit, ndaj kjo e fundit është shkaku i vonesës së ekzekutimit dhe jo DPM-ja. Vendimi nuk mund të ekzekutohet, pasi nëse gjykata e apelit e sqaron vendimin, atëherë DPM-ja nuk mund ta shpallë kërkuesin debitor, duke qenë se ai është në pension.

19.2. Pretendimi për *diskriminim* nuk bazohet në asnjë provë. Ky pretendim nuk është ngritur në asnjë proces gjyqësor të zhvilluar. Nuk ka asnjë dokument ose shkresë të lëshuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ku të jetë protokolluar një ankesë e tillë kundër DPM-së, ndaj Gjykata duhet ta thërrasë si person të tretë këtë institucion.

20. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar, si vijon:

20.1. Kërkuesi nuk legjitimohet në ngritjen e pretendimit për cenimin e së drejtës së afatit të arsyeshëm të ekzekutimit të çështjes së tij, pasi ai e ka realizuar efektivisht këtë të drejtë përmes vendimit të Gjykatës Administrative që ia ka konstatuar të cenuar atë, si dhe përmes paraqitjes së padisë tjetër në gjykatë për kërkimin e shpërblimit të drejtë. Ky pretendim në themel është i pabazuar, pasi kërkuesit i është kthyer tatimi mbi pagën dhe DPM-ja ka kërkuar interpretimin e vendimit gjyqësor nr. 232/2021.

20.2. Pretendimi për *diskriminim*, për shkak të statusit të ish të përndjekurit politik është haptazi i pabazuar, pasi kërkuesi nuk ka parashtruar argumente kushtetuese konkrete dhe të mjaftueshme. Ai nuk rezulton të ketë paraqitur ankim pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

21. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

22. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, Gjykata vëren se sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, individit është subjekt i kushtëzuar. Si i tillë, ai mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të. Kjo do të thotë se kërkuesi duhet të provojë legjitimitimin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial.

23. Gjykata ka pohuar se, në parim, statusi i “viktimit” përjashtohet vetëm nëse organet publike kanë njohur shkeljen, në mënyrë të shprehur ose në substancë, dhe më pas e kanë riparuar atë. Në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave të gjykimin, çështja nëse kërkuesi ka marrë shpërblim të drejtë, është një çështje e rëndësishme dhe në këtë rast vendimi gjyqësor që cakton shpërblimin e drejtë përbën korrigjim të mjaftueshëm, ndaj kërkuesi nuk mund të pretendojë më se është viktimë e shkeljes (*shih vendimin nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në çështjen konkrete, subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka kundërshtuar legjitimitimin e kërkuesit me argumentin se ai nuk ka interes për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, pasi me dhënien e vendimit nga Gjykata Administrative për



konstatimin e shkeljes, ai e ka realizuar efektivisht të drejtën kushtetuese.

25. Gjykata konstaton se vendimi gjyqësor nr. 232/2021 ende nuk është ekzekutuar tërësisht nga subjekti i interesuar, DPM-ja. Gjykata Administrative, në datën 7.9.2022, ka konstatuar shkeljen e afatit të arsyeshëm 1-vjeçar në procedurën e ekzekutimit të këtij vendimi gjyqësor. Në vijim, kërkuesi, në datën 10.10.2022 ka paraqitur padi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me objekt shpërblimin e dëmit nga vonesa në ekzekutim. Gjykimi në shkallë të parë ka përfunduar në favor të kërkuesit në datën 4.7.2023, por subjekti i interesuar, DPM-ja, ka paraqitur ankim dhe çështja pritet të merret në shqyrtim nga gjykata e apelit. Në këto rrethana, kërkuesi është ende në pritje të ekzekutimit të plotë të vendimit gjyqësor, si dhe të shqyrtimit të ankimit në gjykatën e apelit për dëmshpërblimin nga vonesa në ekzekutim. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuesi nuk e ka humbur statusin e viktimës së shkeljes, ndaj legjitimohet *ratione personae*.

26. Një kriter tjetër paraprak është edhe ai për shterimin e mjeteve juridike efektive, i parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Duke qenë se mjeti juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij (*shih vendimin nr. 31, datë 4.10.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se bazuar në nenin 42 të Kushtetutës, ajo shqyrton pretendimin kryesor që lidhet me kohëzgjatjen e gjykimit, ndërsa procedurat dhe vendimet gjyqësore që shqyrtojnë kërkesat për përshejtimin e procedurave janë në funksion pikërisht të kësaj të drejte kushtetuese dhe nuk mund të qëndrojnë në mënyrë autonome nga pretendimi kryesor. Çdo veprim ose mosveprim i organeve kompetente në fazën që lidhet me procedurat e mjetit riparues/korrigjues ka të bëjë me efektivitetin e tij në praktikë, ndaj individit nuk mund t’i kërkohej që edhe në këtë fazë të përdorë ose të shterojë mjetet juridike që parashikojnë nenet 399/1 e vijues të KPC-së. Një qëndrim i ndryshëm do të bënte që këto mjete të humbnin qëllimin e tyre

dhe do t’i vinin individit një barrë të tepruar, pasi do ta detyronin atë të fillonte procese gjyqësore për të siguruar shpejtësinë dhe efektivitetin e një mjeti që në vetvete ka për qëllim përshejtimin dhe parandalimin e shkeljes së kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor (*shih vendimin nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në çështjen konkrete, kërkuesi ka parashtruar se ka përdorur të gjitha mjetet juridike në dispozicion, duke hapur disa procese gjyqësore dhe ende nuk i është ekzekutuar e drejta e fituar me vendim gjyqësor përfundimtar, duke evidentuar se zvarritja ka ndodhur për shkak të statusit të tij si ish i përndjekur politik. Subjekti i interesuar, DPM-ja, ka prapësuar se kërkuesi nuk ka shteruar të gjitha mjetet në dispozicion për pretendimin që lidhet me kohëzgjatjen e procedurës së ekzekutimit, pasi çështja e sqarimit dhe interpretimit të vendimit gjyqësor nr. 232/2021 është në pritje për t’u shqyrtuar nga gjykata e apelit. Lidhur me pretendimin për diskriminim, të dyja subjektet e interesuara kanë prapësuar se kërkuesi nuk i ka shteruar mjetet juridike efektive, pasi ai nuk i është drejtuar paraprakisht Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

28. Gjykata konstaton se midis palëve janë zhvilluar gjashtë procese gjyqësore, të cilat kanë në thelbin e tyre zgjidhjen e padrejtë të marrëdhënies së punësimit dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar kërkuesit: i. procesi gjyqësor për zgjidhjen e padrejtë të punësimit dhe shpërblimin e dëmit; ii. procesi gjyqësor për kthimin e shumës të mbajtur padrejtësisht nga punëdhënësi në ekzekutimin e vendimit për shpërblimin e dëmit nga zgjidhja e padrejtë e punësimit; iii. procesi gjyqësor për shpërblimin e dëmit nga vonesa dhe ekzekutimi i paplotë i vendimit për shpërblimin e dëmit nga zgjidhja e padrejtë e punësimit, proces i cili ka përfunduar me vendimin nr. 232/2021; iv. procesi gjyqësor për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 232/2021; v. procesi gjyqësor për shpërblimin e dëmit nga shkelja e afatit të arsyeshëm të ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 232/2021; vi. procesi gjyqësor për sqarimin dhe interpretimin e vendimit gjyqësor nr. 232/2021. Pesë prej këtyre proceseve janë vënë në lëvizje nga kërkuesi, ndërsa procesi i gjashtë është vënë në lëvizje nga subjekti i interesuar, DPM-ja. Ky proces i fundit nuk është një mjet i zakonshëm ankimi, në kuptimin e detyrimit që ka



individit për të shteruar mjetet juridike në dispozicion. Po kështu, Gjykata vëren se kërkuesi ka vënë në lëvizje edhe Avokatin e Popullit, i cili ka rekomanduar zyrtarisht ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr. 232/2021. Duke mbajtur në konsideratë tërësinë e këtyre rrethanave, Gjykata çmon se, në rastin konkret, kërkuesi e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion lidhur me pretendimin për kohëzgjatjen e procedurave të ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

29. Për sa i takon pretendimit për diskriminimin, Gjykata vëren se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është person juridik publik, që organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, për të siguruar mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin (*nenet 2 dhe 21*). Në përputhje me qëllimin e tij, ligji parashikon se paraqitja e ankimit përpara komisionerit nuk është kusht për të ngritur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale (*neni 34, pika 2*). Nga ana tjetër, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se kërkuesi ka qenë palë ndërgjyqëse në gjashtë procese gjyqësore, katër prej të cilave lidhen me vonesën në ekzekutim, çmon se detyrimi për t’u mbrojtur nga diskriminimi përmes një padie të re në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm do të ishte barrë dhe formalizëm i tepruar në ngarkim të tij, në kontekstin e mbrojtjes së të drejtave themelore. Në këtë situatë, Gjykata vlerëson se prapësimi i subjekteve të interesuara nuk qëndron, ndaj ankimi i kërkuesit e plotëson kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion edhe për këtë pretendim⁸³.

30. Në lidhje me verifikimin e kriterit *ratione temporis*, Gjykata vë në dukje se sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa

paraqitet brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Gjykata ka pohuar se në rastet kur është e qartë se kërkuesi nuk ka një mjet juridik efektiv në dispozicion, afati për t’u drejtuar asaj fillon nga data e aktit të kundërshtuar ose data në të cilën ai është prekur drejtpërdrejt ose ka marrë dijeni për efektet negative të aktit. Për më tepër, kur shkelja e pretenduar përbën një situatë të vazhdueshme kundër së cilës nuk ka mjete juridike të brendshme, afati i ankimit fillon të ecë vetëm kur kjo situatë përfundon. Për sa kohë që situata vazhdon, rregulli i afatit ligjor 4-mujor nuk është i zbatueshëm. Megjithatë, një situatë e vazhdueshme nuk mund të shtyjë për një kohë të pacaktuar zbatimin e afatit të paraqitjes së kërkesës, pasi individit ka edhe detyrimin për të treguar kujdesin e duhur dhe të ndërmarrë nismën e ankimit për dështimin e vazhdueshëm të organeve të pushtetit publik për të përmbushur disa prej detyrimeve të tij (*shih vendimin nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se kërkuesi e ka paraqitur ankimin kushtetues individual në datën 11.4.2023, kohë në të cilën vendimi gjyqësor nr. 232/2021 ishte ende i paekzekutuar, ndërsa gjykimi për kërkesën për dëmshpërbllim nga vonesa në ekzekutim nuk kishte përfunduar në shkallë të parë, edhe pse kishte kaluar afati ligjor 3-mujor. Gjykimi në shkallë të parë ka përfunduar pas 9 muajve, në datën 4.7.2023, ndërsa subjekti i interesuar, DPM-ja, e ka apeluar atë. Këto fakte ndodhën pasi ishte vendosur kalimi i çështjes së ankimit kushtetues individual për shqyrtim në seancë plenare. Në këto rrethana, Gjykata çmon se situata e shkeljes ka natyrë vazhduese dhe se kërkuesi ka treguar kujdesin e duhur për të kundërshtuar mosveprimin e autoriteteve publike, ndaj ai legjitimohet edhe *ratione temporis* për vënien në lëvizje të gjykit kushtetues.

⁸³ Gjyqtarët Elsa Toska, Sandër Beci dhe Ilir Toska votuan për mosshqyrtimin në themel të pretendimit për cenimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimin, me argumentin e mosshterimit pranë gjykatave të zakonshme. Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar garanton edhe të drejtën e ankimit në gjykatë të individit që ka pësuar diskriminim, proces në të cilin palët, në respektim të parimit të kontradiktoritetit dhe në përputhje me barrën e të provuarit, paraqesin prova mbi të cilat bazojnë pretendimet e tyre. Në këtë kuptim, për ankimin kushtetues individual, në respektim të nenit 131, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata

duhet të mbajë parasysh se gjykimi kushtetues vjen pas gjykit të zakonshëm si gjykim subsidiar. Në këtë kontekst, kërkuesi në ankimin kushtetues individual duhet të paraqet pretendimet jo vetëm në formë, por edhe në substancë para gjykatave të zakonshme, me qëllim plotësimin e kriterit të shterimit të mjetit efektiv. Fakti që kërkuesi ka vënë në lëvizje disa procese gjyqësore për mosmarrëveshje të ndryshme nga ajo për diskriminimin, nuk mund të interpretohet se ai ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.



32. Në drejtim të legjitimit *ratione materiae*, kërkuesi ka ngritur pretendime për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 232/2021, si dhe për diskriminimin e tij në procedurën e ekzekutimit të këtij vendimi për shkak të statusit të ish të përndjekurit politik.

33. Për sa i takon pretendimit për diskriminimin, Gjykata vëren se kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë, por është mjaftuar me argumentin se organet e shtetit shqiptar kanë ekzekutuar shumë vendime të tjera që janë me pasoja financiare më të rënda për buxhetin e shtetit sesa vlera e përcaktuar në vendimin e çështjes së tij. Gjykata thekson se në gjykimin kushtetues zbatohet parimi i përgjithshëm i së drejtës, sipas të cilit kërkuesi ka barrën e provës për të provuar pretendimin e tij. Për këtë qëllim, ligji nr. 8577/2000, në nenet 27, pika 2, shkronja “dh” dhe 43/b, pika 1, shkronja “c”, të tij, i jep të drejtën kërkuesit të paraqesë prova në gjykimin kushtetues, pa pengesa procedurale dhe pa iu dhënë vlerë provuese të paracaktuar ndonjë prej provave. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuesi nuk ka arritur të provojë se ai është trajtuar në mënyrë të ndryshme nga individë të tjerë në situatë të ngjashme me të, ndaj pretendimi i tij për diskriminimin është haptazi i pabazuar dhe nuk mund të merret në shqyrtim. Mbi bazën e këtij arsytimi, Gjykata çmon se është e pabazuar edhe kërkesa procedurale e subjektit të interesuar, DPM-së, për të thirrur në gjykim Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

34. Në lidhje me pretendimin për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor, Gjykata konstaton se në thelb të tij qëndron argumenti se, ndonëse ai i ka shteruar formalisht në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm mjetet juridike për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, ato nuk kanë rezultuar efektive për t'i mundësuar realizimin e së drejtës së tij për të përfituar tërësisht shumat e përcaktuara në vendimin gjyqësor përfundimtar nr. 232/2021. Ky pretendim lidhet me të drejtën e procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe, si i tillë, hyn në juridiksionin kushtetues. Gjykata, duke u bazuar edhe në mënyrën se si është parashtuar pretendimi i kërkuesit, vlerëson ta shqyrtojë atë në këndvështrim të së drejtës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm

35. Kërkuesi ka pretenduar se DPM-ja, në bazë të vendimit nr. 232/2021, të Gjykatës Administrative, kishte detyrimin që të paguante interesat për pagimin me vonesë të pagës së 16 muajve, si dhe detyrimin për të derdhur kontributet përkatëse për sigurimet shoqërore. Ndonëse kërkuesi ndoqi procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, duke vënë në lëvizje shërbimin përmbarrimor dhe gjykatën, vendimi mbeti i paekzekutuar, duke i sjellë atij pasoja në përfitimin e një mase të ulët pensioni.

36. Subjekti i interesuar, DPM-ja, ka prapësuar se pretendimi për kohëzgjatjen e paarsyeshme të ekzekutimit është i pabazuar, pasi nga detyrimi i vendimit gjyqësor nr. 232/2021, tashmë ka mbetur pa u ekzekutuar vetëm pjesa që lidhet me kontributet shoqërore dhe tatimin mbi pagën, por kjo pjesë detyrimi nuk mund të ekzekutohet për shkak se DPM-ja e ka paguar kërkuesin me 144.266 lekë me urdhrin e shpenzimit të datës 17.11.2017, në ekzekutim të vendimit gjyqësor që ka shpallur të pavlefshme mbajtjen e kësaj shume sipas rekomandimit të auditit. Sipas tij, për këtë pjesë të detyrimit, pritet përfundimi i procesit gjyqësor për sqarimin dhe interpretimin e vendimit gjyqësor, proces i cili tashmë është në shkallë të dytë.

37. Në të njëjtën linjë, edhe subjekti tjetër i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se prej vendimit gjyqësor ka mbetur pa u ekzekutuar vetëm pjesa që lidhet me kontributet shoqërore, detyrim i cili i është paguar kërkuesit më herët nga DPM-ja.

38. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë, ndërsa neni 142, pika 3, i Kushtetutës detyron organet e shtetit të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.

39. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar se aksesit në gjykatë do të ishte iluziv nëse sistemi ligjor i brendshëm do të lejonte që një vendim gjyqësor përfundimtar të mos ekzekutohet. Ekzekutimi i vendimit të dhënë nga gjykata duhet të konsiderohet si pjesë integrale e gjykimin për qëllimet e nenit 6 të KEDNJ-së (*shih vendimin e GJEDNJ-së Qufaj co sh.p.k. kundër Shqipërisë, § 38, datë 18 nëntor 2004*).



40. Mbi bazën e kësaj jurisprudence, Gjykata ka theksuar se parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të parashikuara në nenin 142, pika 3, të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufij për realizimin e saj (*shih vendimet nr. 4, datë 20.2.2013; nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 1, datë 19.1.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ai përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 25, datë 27.3.2017; nr. 1, datë 21.1.2016; nr. 35, datë 27.10.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Gjithashtu, Gjykata, duke u mbështetur edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, është shprehur se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuarit dhe të autoriteteve përkatëse, si dhe interesin e kërkuarit (*shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

i. Kompleksiteti i çështjes

42. Çështja në shqyrtim ka si objekt ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 232/2021,

të Gjykatës Administrative, me të cilin është vendosur detyrimi i subjektit të interesuar, DPM-së, t'i paguajë kërkuarit shumën 261.753 lekë si interes për vonesën në pagimin e pagës së 16 muajve, si dhe të derdhë në llogarinë e ISSH-së shumën 15.932 lekë si kontribut të punëdhënësit për ish-punonjësin për periudhën 26.9.2013–20.1.2015 dhe shumën 9.540 lekë si tatim mbi pagë. Ky detyrim është caktuar si dëm i shkaktuar nga marrëdhënia e punësimit të kërkuarit, e ndërprerë në shkelje të ligjit, për të cilin midis kërkuarit dhe subjektit të interesuar, DPM-së, ishin zhvilluar më parë dy procese gjyqësore, të zgjidhura në favor të tij.

43. Gjykata çmon se nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura, çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta ose kompleksitet që mund të justifikojë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së kërkuarit dhe i autoriteteve publike, si dhe i interesit të tij është me rëndësi në këtë kontekst.

ii. Sjellja e kërkuarit

44. Kohëzgjatja për të ekzekutuar vendimet gjyqësore të formës së prerë është vlerësuar nga Gjykata si thelbësore për të përcaktuar nëse ndodhemi përpara tejkalimit të afateve të arsyeshme. Ky element lidhet edhe me veprimet ose mosveprimet e kërkuarit, të cilat mund të kenë çuar në moszekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e caktuara nga ligji (*shih vendimin nr. 25, datë 27.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Në çështjen konkrete, Gjykata vlerëson se kërkuari nuk është bërë pengesë për realizimin e procesit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor përfundimtar. Ai ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke përdorur të gjitha mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e së drejtës së cenuar. Lidhur me afatet kohore, vendimi gjyqësor përfundimtar është dhënë në datën 1.2.2021 dhe për ekzekutimin e tij, kërkuari, në datën 3.3.2021, i është drejtuar shoqërisë përmbartimore private. Ndonëse subjekti i interesuar është njoftuar për ekzekutimin vullnetar në datën 4.3.2021, vendimi mbeti i paekzekutuar në të gjitha pjesët e tij deri në datën 3.7.2023. Përgjatë kësaj periudhe, kërkuari i është drejtuar edhe tre herë të tjera gjykatave të zakonshme për të detyruar gjyqësisht DPM-në për ekzekutimin e vendimit, për konstatimin e shkeljes së afatit të ekzekutimit të vendimit dhe për shpërblimin e dëmit. Subjekti i interesuar ka ekzekutuar pjesërisht detyrimin vetëm



pas njoftimit nga Gjykata se çështja e kërkuetit kishte kaluar për shqyrtim në seancë plenare.

46. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkueti ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale për të rivendosur të drejtën e cenuar.

iii. Sjellja e autoriteteve

47. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit. Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë (*shih vendimet nr. 4, datë 20.2.2013; nr. 10, datë 1.3.2012; nr. 2, datë 1.2.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Gjykata konstaton se duke filluar nga data 1.2.2021, kur është nxjerrë vendimi i formës së prerë, ka pasur një korrespondencë të gjatë midis kërkuetit, shoqërisë përmbarimore dhe autoriteteve shtetërore. Shoqëria përmbarimore i ka dërguar shkresa në vazhdimësi DPM-së, duke lëshuar edhe urdhra për bllokimin e llogarive të saj, megjithatë vendimi ka mbetur i paekzekutuar. Gjatë gjithë kësaj kohe nga ana e palës debitore, konkretisht DPM-së, si palë e paditur gjatë procesit gjyqësor, nuk është marrë asnjë masë konkrete për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë. Përkundrazi, subjekti i interesuar, DPM-ja, ka kryer veprime aktive për të penguar ekzekutimin, siç janë: i. paraqitja e kërkesës për sqarim dhe interpretim vendimi, gjykim i cili është pushuar në shkallë të parë për shkak të mosparaqitjes në gjykim të subjektit të interesuar; ii. ankim ndaj vendimit gjyqësor të pushimit; iii. ankim ndaj vendimit gjyqësor të shkallës së parë për dëmshpërblimin e kërkuetit nga vonesa në ekzekutim. Subjekti i interesuar debitor është vënë në lëvizje dhe ka përmbushur një pjesë të detyrimit vetëm në datën 3.7.2023, pasi është njoftuar që çështja e kërkuetit kishte kaluar për shqyrtim në seancë plenare. Konkretisht, në datën 3.7.2023, ai ka përmbushur një pjesë të detyrimit, duke lënë pa ekzekutuar detyrimin për derdhjen e kontributeve shoqërore dhe tatimin mbi pagë, detyrim i cili ka efekt të drejtpërdrejtë në masën e pensionit të kërkuetit.

49. Për sa më lart, Gjykata çmon se është detyrim i debitorit, në cilësinë e një institucioni shtetëror, pjesë e pushtetit ekzekutiv, të gjejë mundësitë e

duhura për të ekzekutuar detyrimin sipas vendimit gjyqësor dhe jo të paraqesë pengesa.

iv. Rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkueti

50. Kërkueti pretendon se ai ka statusin e ish të përndjekurit politik dhe se vonesa në ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë lidhet drejtpërdrejt me masën e pensionit që ai përfiton, duke parashtruar se ka dalë në pension që në vitin 2016.

51. Gjykata vëren se interesi i kërkuetit dhe rreziku që sjell tejzgjatja e procedurave për të, përbën një aspekt të rëndësishëm të vlerësimit të kohëzgjatjes së arsyeshme të procedurave të ekzekutimit. E drejta e pensionit dhe masa e tij përbën një interes vetjak dhe jetësor, ndaj një çështje e tillë duhet të trajtohet me përparësi dhe shpejtësi të veçantë. Për më tepër, në rastet e individëve me statusin e ish të përndjekurve politikë dhe të dënuar padrejtësisht, veprimet e autoriteteve shtetërore, në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe ushtrimit të kompetencave të tyre, duhet të jenë të atilla që të krijojnë lehtësi dhe thjeshtësi për këta individë, me qëllim rehabilitimin dhe riintegrimin e plotë të tyre në shoqëri. Për rrjedhojë, çështja konkrete është e një natyre të tillë, që interesi i kërkuetit, rrezikohet në një shkallë të konsiderueshme nga çdo ditë vonesë e ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

52. Në përfundim, Gjykata konstaton se kërkueti i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6, pika 1, i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit nga autoritetet e ngarkuara nga ligji dhe brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor përfundimtar.

53. Në përfundim, Gjykata vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuetit, sipas arsytimit të mësipërm, është i bazuar, ndaj duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.



2. Konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektin e së drejtës për ekzekutimin e vendimit të gjykatës brenda afatit të arsyeshëm.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 30.11.2023.

Shpallur më 29.12.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Genti Ibrahim, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini

Anëtarë kundër: Ilir Toska

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 2 (D) 2023 të Regjistrisë Themeltar, që i përket kërkuarit Durim Grabova, me objekt: “1. Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit nr. 232, datë 1.2.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. 2. Konstatimi i cenimit të së drejtës për të mos u diskriminuar, si pasojë e statusit të të përndjekurit politik nga regjimi komunist”, unë gjyqtari në pakicë ndaj qëndrim të ndryshëm nga shumica për sa i përket kërkit të parë të pranuar. Në vlerësimin tim, kërkuari nuk legjitimohet *ratione personae* për sa i përket kërkit për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit nr. 232/2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndaj për këtë shkak kërkesa duhet të rrezohet edhe në lidhje me këtë kërkim.

2. Duke iu referuar rrethanave të kësaj çështjeje, rezulton se procesi kushtetues në fjalë, i vënë në lëvizje nga kërkuari, ka të bëjë me procesin gjyqësor të nisur po prej tij në gjykatat e zakonshme për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave për ekzekutimin e vendimit nr. 232/2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me të cilin është vendosur pranimi i padisë, duke detyruar subjektin e interesuar, DPM-në, që t'i paguajë kërkuarit shumën 261.753 lekë si interesa për vonesën në pagimin e pagës së 16 muajve, si dhe të derdhë në llogarinë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore shumën 15.932 lekë, si kontribut të punëdhënësit për ish-punonjësin për periudhën 26.9.2013–20.1.2015 dhe shumën

9.540 lekë, si tatim mbi pagë. Në lidhje me këtë kërkesë, me vendimin nr. 38, datë 7.9.2022, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka konstatuar shkeljen e afatit të arsyeshëm 1-vjeçar në procedurën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 232/2021 nga debitori, çka i ka dhënë të drejtë kërkuarit, në zbatim të nenit 399/4, paragrafi i dytë, të KPC-së, që të paraqiste kërkesëpadi për shpërblimin e dëmit si rezultat i vonesës në ekzekutim.

3. Kërkuari i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me kërkesëpadi në datën 10.10.2022, me objekt shpërblimin e dëmit jopasuror në shumën 250.000 lekë të shkaktuar nga mosekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Pasi ka pritur vendimin në fjalë, me kërkesën e datës 11.4.2023, kërkuari i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, mbi të njëjtin shkak, pra mosekzekutimin e vendimit gjyqësor nr. 232/2021.

4. Ndërkohë që çështja ishte për shqyrtim në Gjykatë dhe ishte vendosur kalimi i saj për shqyrtim në seancë plenare, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka përfunduar gjykimin për shpërblimin e dëmit të kërkuarit nga vonesa në ekzekutim dhe me vendimin nr. 3416, datë 4.7.2023, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke urdhëruar shpërblimin e tij në shumën 240.000 lekë. Kjo çështje, mbi bazën e ankimit të subjektit të interesuar, DPM-së, është në pritje të gjykohet në gjykatën e apelit.

5. Nga ana tjetër, gjatë gjyimit ka rezultuar edhe se procedura e ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 232/2021 ka vijuar dhe në datën 3.7.2023 DPM-ja (debitori) ka përmbushur detyrimin për shumën 360.953 lekë, që përfshinte interesat për vonesën e pagimit të pagave në shumën 261.753 lekë, shpenzimet gjyqësore në shumën 99.200 lekë, si dhe tarifën përmbartimore në shumën 36.000 lekë. Po kështu, DPM-ja, në datën 20.6.2023, i ka kërkuar Gjykatës Administrative të Apelit përshpejtimin e gjyimit të çështjes të vënë në lëvizje nga ajo për ndreqjen, interpretimin dhe sqarimin e vendimit gjyqësor nr. 232/2021, në lidhje me disponimin për derdhjen e tatimit mbi pagën, që, sipas atij subjekti, është e vetmja arsye për të cilin nuk ekzekuton tërësisht vendimin gjyqësor. Sipas subjektit të interesuar, kërkuari i është kthyer tatimi i mbajtur mbi pagën (në zbatim të vendimit nr. 2335, datë 25.5.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së



Parë), çka pranohej edhe në arsyetimin e vendimit gjyqësor, por se në dispozitiv përcaktohej detyrimi në shumën 9.540 lekë, ndërkohë që nga përmbartuesi gjyqësor kërkohej përmbushja sërish e një detyrimi të tillë në shumën 152.640 lekë. Nga ana tjetër, sipas subjektit të interesuar, në funksion të ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 232/2021, për sa i përket derdhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore, atij do t'i duhej të derdhte për llogari të kërkuarit edhe tatimin mbi pagën për periudhën 16-mujore, pasi sistemi informatik tatimor nuk të linte të veproje ndryshe. Në një situatë të tillë, shuma që do t'i paguhej kërkuarit do ishte më e madhe se detyrimi sipas vendimit gjyqësor nr. 232/2021, ndërkohë që rikuperimi i saj nga kërkuari do të ishte i pamundur për sa kohë që tashmë ai është në pension.

6. Në lidhje me kërkimin e parë të ankimit kushtetues, kërkuari ka pretenduar se i është cenuar e drejta për ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, për shkak se, duke qenë se ka mbi 5 vjet që ka dalë në pension pleqërie, vonesa në ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr. 232/2021 nga subjekti i interesuar, DPM-ja, me gjithë kërkesat dhe paditë gjyqësore të vijueshme të tij, i ka shkaktuar një dëm financiar të drejtpërdrejtë, përveçse një dëm në llogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë. Edhe padia e tij për shpërblimin e dëmit nga zvarritja e ekzekutimit është në shqyrtim nga gjykata e shkallës së parë prej disa muajsh, duke tejkaluar afatin ligjor 3-mujor.

7. Në lidhje me legjitimitimin e kërkuarit, shumica ka vlerësuar se: *i.* plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike në dispozicion (*shih paragrafin 28 të vendimit*); *ii.* legjitimohet *ratione temporis*, për shkak se kërkesa është paraqitur në një kohë kur vendimi gjyqësor nr. 232/2021, ishte ende i paekzekutuar, ndërsa gjykimi i padisë për dëmshpërblim nga vonesa në ekzekutim nuk kishte përfunduar në shkallë të parë edhe pse kishte kaluar afati ligjor 3-mujor, çka e bënte me natyrë vazhduese situatën e shkeljes së pretenduar të së drejtës për ekzekutim brenda një afati të arsyeshëm (*shih paragrafin 31 të vendimit*); *iii.* legjitimohet *ratione materiae* për shkak se mjetet juridike të përdorura nga ai për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, nuk kanë rezultuar efektive për t'i mundësuar realizimin e së drejtës së tij për të përfituar tërësisht shumën e përcaktuar në vendimin gjyqësor përfundimtar nr. 232/2021 (*shih paragrafin 34 të vendimit*). Pasi ka shqyrtuar themelin e

pretendimeve të kërkuarit, shumica ka arritur në përfundimin se është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit nga autoritetet e ngarkuara nga ligji dhe brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor përfundimtar (*shih paragrafin 52 të vendimit*), duke disponuar për: “Konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektin e së drejtës për ekzekutimin e vendimit të gjykatës brenda afatit të arsyeshëm”.

8. Në drejtim të legjitimitimit *ratione personae* shumica ka pranuar se kërkuari nuk e ka humbur statusin e “viktimit” për sa kohë ai është ende në pritje të: *i.* ekzekutimit të plotë të vendimit gjyqësor dhe *ii.* shqyrtimit të ankimit në gjykatën e apelit për dëmshpërblimin nga vonesa në ekzekutim (*shih paragrafin 25 të vendimit*).

9. Duke ju referuar pretendimeve të kërkuarit evidentohen dy shkaqe të ndryshme mbi të cilat ai mbështet kërkesën. I pari lidhet me mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë të dhënë në favor të tij, duke përcaktuar detyrime për palën debitore, kurse shkak u tjetër lidhet me mosshqyrtimin e kërkesës për dëmshpërblim për vonesën e konstatuar tashmë, pretendim ky që në jurisprudencën kushtetuese është trajtuar në këndvështrim të efektivitetit të mjeteve të reja procedurale të KPC-së (*shih vendimin nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese - çështja Zaro nr. 3*). Pikërisht në përputhje me këtë vendim shumica ka bazuar dhe justifikuar legjitimitimin e kërkuarit në çështjen konkrete, por që në vlerësimin tim i ka dhënë kuptim të ndryshëm asaj që ka synuar Gjykata të trajtojë në atë rast specifik. Në atë vendim Gjykata u ndal në mënyrë më të detajuar, bazuar edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, në përcaktimin e konceptit të “viktimit” në drejtim të legjitimitimit *ratione personae*, pra të interesit të drejtpërdrejtë për të filluar një gjykim kushtetues. Kjo sepse, edhe pse procesi gjyqësor i konstatimit të cenimit dhe i dëmshpërblimit në gjykatën e shkallës së parë kishte përfunduar, për sa kohë që çështja ishte ende në gjykatën e apelit, kërkuari, pavarësisht se i ishte njohur e drejta për t'u dëmshpërblyer, nuk kishte përfituar shumën konkrete që synonte riparimin e shkeljes. Për rrjedhojë, në atë çështje u shtrua për shqyrtim efektiviteti i mjetit për sa kohë që për gjykimin në apel dispozita procedurale nuk kishte një afat të përcaktuar për përfundimin e tij, ndërkohë që gjykata jepnin një interpretim të ndryshëm nga ai për afatin e gjykimit në shkallë të parë.



10. Në rastin konkret, edhe pse kërkuesi ka parashtruar një shkak të tillë, çështja nuk rezulton të jetë trajtuar nga shumica në këtë drejtim, por ajo ka analizuar kriteret që përcaktojnë kohëzgjatjen e procesit gjyqësor dhe të ekzekutimit të vendimit. Në vlerësimin tim, në këtë rast organet publike kanë njohur shkeljen, në mënyrë të shprehur dhe në substancë, dhe e kanë riparuar atë duke njohur edhe dëmshpërblimin përkatës, masa e të cilit përbën korrigjim të mjaftueshëm për kërkuenin në lidhje me shkeljen e konstatuar. Për më tepër, edhe vendimi gjyqësor nuk rezulton të mos jetë ekzekutuar tërësisht, por pjesërisht nga ana e debitorit, dhe ka të bëjë me një pjesë për të cilin ai pretendon se është shlyer tashmë, ndaj ka kërkuar nga gjykata e zakonshme interpretimin e vendimit, ashtu edhe përshtetimin e procedurave për këtë shkak. Konstatoj se përgjatë proceseve gjyqësore, kërkuesi ka vënë edhe më parë Gjykatën në lëvizje me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 79, datë 13.12.2013, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (për rikthimin në detyrë dhe pagimin e pagave deri në momentin e rikthimit). Me vendimin nr. 41, datë 25.6.2015, Gjykata, e cila në atë kohë kishte juridiksion të shqyrtonte këtë kërkesë, vlerësoi se debitori, DPM-ja, kishte ndërmarrë veprime për ta ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë për rikthimin në detyrë të kërkuetit dhe fillimin e marrëdhënieve financiare, kurse në lidhje me detyrimin për shpërblimin e dëmit, ka rezultuar se është paguar një pjesë dhe është shprehur vullneti për përmbushjen edhe të pjesës së mbetur. Për rrjedhojë, Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës, pasi vlerësoi se autoritetet shtetërore kishin vepruar në përputhje me të drejtat e tyre, duke treguar interes për ekzekutimin e detyrimit ndaj kërkuetit.

11. Megjithatë, pavarësisht se vendimi i dëmshpërblimit nuk është ekzekutuar ende, Gjykata në të tilla raste nuk ka arsye të vërë në dyshim suksesin e atij mjeti, pra natyrën dhe karakterin riparues të tij, përveçse mund të diskutojë efektivitetin e tij, siç ka bërë në *çështjen Zaro nr. 3*. Gjithsesi, edhe nëse arrihet në përfundimin se kërkuesi ka ende statusin e viktimës, kjo nuk mund të shërbejë për legjitimin *ratione personae* të tij për atë pjesë të kërkesës që ka të bëjë me konstatimin e

cenimit për shkak të mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

12. *Së pari*, vijimi i mosekzekutimit të plotë të vendimit gjyqësor, pas konstatimit të shkeljes së të drejtës kushtetuese të kërkuetit për ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm nga gjykata kompetente e juridiksionit të zakonshëm, nuk mund të përbëjë shkak të ri për konstatimin sërish të shkeljes së kësaj të drejte, tashmë nga kjo Gjykatë. Sikurse ajo ka theksuar, konstatimi prej saj i shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt për shkak të mungesës së efektivitetit të mjetit kompensues synon të mundësojë rivendosjen sa më shpejt të së drejtës së shkelur përmes përshtetimit të procesit në gjykatën e apelit, duke zbatuar kjo e fundit dispozitat procedurale në përputhje me kuptimin e dhënë nga Gjykata në vendimin e saj. Nga ana tjetër, ky konstatim nuk përbën njohje të një shkeljeje të re në procesin gjyqësor, pra nuk nënkupton se i njeh kërkuetes të drejta të tjera në lidhje me afatin e arsyeshëm (*shih çështjen Zaro nr. 3*). Në një rast tjetër të ngjashëm, Gjykata ka theksuar se në rastet e një shkeljeje të konstatuar tashmë me vendim gjyqësor, por që vijon ende, kjo nuk përbën një shkak të ri ose një mosmarrëveshje të re kushtetuese dhe vetëm fakti i mosshqyrtimit të çështjes brenda afatit të caktuar nga Gjykata nuk është i mjaftueshëm në nivel kushtetues për të argumentuar pretendimin e cenimit të të drejtave kushtetuese, për sa kohë që vendimi i ka dhënë pasojat e tij në drejtim të caktimit të shpërblimit të drejtë. Vijimi i shkeljes, sipas Gjykatës, i jep të drejtë individit të cenuar të përdorë mjetet juridike të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së për të kërkuar shpërblimin e dëmit (*shih vendimin nr. 20, datë 5.4.2023, të Gjykatës Kushtetuese - çështja Zaro nr. 2*).

13. *Së dyti*, siç kam theksuar më sipër, fakti që çështja e shpërblimit të dëmit është në pritje për t'u shqyrtuar në gjykatën e apelit, i shërben Gjykatës për të vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e mjetit kompensues, por nuk përbën shkak për të konstatuar sërish të njëjtën shkelje të së drejtës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, si element i së drejtës për proces të rregullt. Në *çështjen Zaro nr. 3* Gjykata ka pohuar se, edhe pse ka kaluar rreth 1 vit nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë që ka vendosur shpërblimin e dëmit, pra nga dhënia e masës së favorshme ndaj individit të cenuar në të drejtën e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ai jo vetëm që nuk ka mundur ta



ekzekutojë këtë vendim, por është ende në pritje të shqyrtimit të ankimit në gjykatën e apelit, e cila, për më tepër, ka mbajtur qëndrimin se kjo çështje do të shqyrtohet në përputhje me afatet e përgjithshme procedurale. Ndaj vlerësohet se individi nuk e ka humbur statusin e viktimës, në drejtim të përshtatshmërisë dhe efektivitetit të mjetit kompensues, ndaj ai legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës drejtpërdrejt me kërkesë për të shqyrtuar efektivitetin e këtij mjeti.

14. Legjislacioni ka parashikuar dy lloj mjetesh juridike në dispozicion të individit në lidhje me kohëzgjatjen e paarsyeshme të çështjes dhe ekzekutimin e vendimit gjyqësor: 1) mjetet përsheptuese/parandaluese; dhe 2) mjetet korigjuese/dëmshpërblyese. Qëllimi i këtyre mjeteve është që të garantojnë të drejtën për gjykim brenda afatit të arsyeshëm në dy plane: i parandalimi i shkeljes ose i vazhdimit të saj, në kuptimin që në një çështje konkrete, e cila është duke zgjatur në kohë, të urdhërohet përsheptimi i procedurave, në mënyrë që individit të mos i cenohet e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm ose për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë: ii rivendosja e së drejtës së shkelur kur konstatohet shkelje e afatit të arsyeshëm, nëpërmjet përfundimit të procedurave sa më shpejt të jetë e mundur dhe eventualisht, caktimit të një shpërblimi të drejtë. Këto mjete juridike janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën në atë mënyrë që, në rast se mjetet parandaluese nuk kanë qenë efektive, pra nuk kanë arritur të sjellin përsheptimin e procedurave dhe parandalimin e shkeljes ose vijimit të saj, ato i lënë vend aplikimit të mjeteve korigjuese të kësaj vonese.

15. Në praktikën e saj Gjykata ka vënë disa herë në diskutim qasjen e saj në lidhje me këto mjete, ashtu edhe legjitimitimin e kërkuarit atëherë kur mjetet ligjore kanë njohur shkeljen duke vendosur si përsheptimin, ashtu edhe dëmshpërblimin për këtë shkak, si masë korigjuese. Sipas qëndrimit tim, në të tilla raste, Gjykata mund të vërë në dyshim vetëm efektivitetin e këtyre mjeteve, çka nuk ka ndodhur në rastin konkret, por ajo nuk mund të shqyrtojë themelin e kërkesave të tilla, pra të vlerësojë kriteret e kohëzgjatjes së arsyeshme, vlerësim që në rastin konkret është bërë nga gjykata e zakonshme, e cila ka dhënë edhe një vendim të formës së prerë. Kjo qasje krijon rrezikun e dublimit të mjeteve juridike dhe ndërhyrjes së Gjykatës edhe në ato raste kur

juridiksioni kushtetues është i përjashtuar, si për shkak të ligjit, ashtu edhe vetë qëndrimit të kësaj Gjykate në çështje të ngjashme.

16. Për sa kohë që kërkuari ka përdorur mjetet riparuese dhe korigjuese në dispozicion dhe ato kanë sjellë efekte në drejtim të së drejtës së pretenduar të cenuar, duke njohur shkeljen dhe duke përsheptuar ekzekutimin (pjesërisht), ashtu edhe duke njohur korigjimin, ai nuk ka asnjë pengesë që të vijojë të kërkojë dëmshpërblim për shkeljen vijuese në gjykatat e zakonshme. Vendimi i Gjykatës në rastin konkret merr natyrë deklarative dhe nuk sjell asnjë pasojë të ndryshme, ashtu si dhe nuk i garanton kërkuarit ndonjë mjet tjetër të ndryshëm nga ato që ofron legjislacioni dhe që tashmë ai i ka në dispozicion. Edhe gjykatat e zakonshme nuk kanë asnjë pengesë të pranojnë kërkesa të tilla për shkelje vijuese në kuptim edhe të qëndrimit të Gjykatës në çështjen Zaro nr. 2.

17. Për më tepër, në lidhje me kriterin e interesit të kërkuarit, pavarësisht se Gjykata ende nuk ka arritur në një qëndrim të konsoliduar për sa u përket elementeve që duhet të merren parasysh, vlerësoj se e drejta e sigurimeve shoqërore në pleqëri buron nga neni 52 i Kushtetutës për këdo, ndaj kjo e drejtë kushtetuese mjafton, në mënyrë të pavarur, për të dhënë shkas për mbrojtjen e saj.

18. Në përfundim, vlerësoj se kërkuari nuk legjitimohet *ratione personae* për kërkimin e parë të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë kërkesa e tij duhet të rrëzohet në tërësi.

Anëtar: Ilir Toska

URDHËR
Nr. 5, datë 3.1.2024

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”; të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,



URDHËROJ

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, z. Endrit Musaj, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Trajnimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore, për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.

2. Kompetencat e deleguara të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në datën 31 dhjetor 2024.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet z. Endrit Musaj, drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Trajnimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ardit Bido

VENDIM

Nr. 364, datë 15.12.2023

**MBI MIRATIMIN E ÇMIMIT TË
BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE,
QË DO T'U PAGUHET PRODHUESVE
EKZISTUES ME PËRPARËSI,
PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të neneve 10 dhe 31, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si dhe neneve 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 930/36 prot., datë 13.12.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2024”, konstatoi se:

- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, më datë 23 mars 2023, ka miratuar ligjin e ri nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 7/2017.

Në nenin 10, pika 4, përcaktohet se: “Për prodhues ekzistues me përparësi, çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga burimet hidrike me kapacitet të instaluar deri në 15 mw caktohet nga ERE në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit”. Metodologjia përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në çmimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike ose deri në krijimin e tij, në çmime të krahasueshme të tregjeve të organizuara të vendeve fqinje, plus një bonus të caktuar për promovimin e këtyre burimeve, i cili merr në konsideratë një kthim të arsyeshëm të vlerës së investimeve. Në çdo rast, ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE në vitin 2016”.

- Gjithashtu, në pikën 2, të nenit 31, të këtij ligji përcaktohet se aktet nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, të ndryshuar, vazhdojnë të mbeten në fuqi dhe të zbatohen deri në momentin e miratimit të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji (ligjit nr. 24/2023).

- Me vendim të Këshillit Ministrave 687/2017, të ndryshuar, është miratuar metodologjia e përcaktimit të “Çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, ku ky çmim përlllogaritet sipas formulës si vijon: çmimi vjetor i blerjes (lekë/kwh) = Çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) i energjisë elektrike në profilin bandë (*baseload*) i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent/kwh X bonusin për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.2 X normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit”.

- Nga të dhënat paraprake nga faqja e internetit të Bursës Hungareze të Energjisë (<https://hupx.hu/en/market-data/dam/regular-reports>), është marrë çmimi i deritanishëm mesatar për periudhën 11-mujore të tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (*baseload*) për vitin 2023, i cili rezulton në vlerën 109.39 euro/mwh.

- Sipas metodologjisë, me normë mesatare të shkëmbimit të vitit të fundit, kuptohet kursi mesatar vjetor i këmbimit euro/lekë, i publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin 2023. Nga të dhënat e deritanishme të publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit, rezulton se kursi mesatar i



këmbimit për 11 muajt, tashmë të mbyllur të vitit 2023 (janar–nëntor), rezulton të jetë 108.84 lekë/euro.

- Nga të dhënat paraprake rezulton se çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike do të jetë 14.29 lekë/kwh. Në zbatim të VKM-së nr. 687/2017, të ndryshuar, ky çmim rezulton të jetë mbi nivelin maksimal të çmimit të llogaritur të blerjes së energjisë elektrike të përcaktuar në germën “d”, prej 10 lekë/kwh. Për rrjedhojë, çmimi i blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2024 do të jetë ai prej 10 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi prej 10 lekë/kwh, për vitin 2024.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 365, datë 15.12.2023

MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 73, DATË 13.4.2022

Në mbështetje të neneve 16, 19, 20, germa “c”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, pika 7 dhe 9, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për

vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2231/1 prot., datë 13.12.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022”, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me anë të vendimit nr. 324, datë 14.12.2022, ndër të tjera vendosi: 1. të shtyjë fuqinë juridike të vendimit 73, datë 13.4.2022, të Bordit të ERE-s deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë OSSH sh.a. për vitin 2023 ose konstatimit të ndryshimit të kostove bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- ERE, me anë të shkresës nr. 2231 prot., datë 3.10.2023, solli në vëmendje të OSSH sh.a. detyrimin për aplikimin për përcaktimin e tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2024, të shoqëruar me informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- OSSH sh.a., me anë të shkresës nr. 2026 prot., datë 24.10.2023, u shpreh se në kushtet e vazhimit të furnizimit me energji elektrike për mbulimin e humbjeve, në zbatim të VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve, për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe të ndryshimeve në çmimin e energjisë elektrike që do të blihet për mbulimin e humbjeve, kërkon “Mosndryshimin e tarifës së shpërndarjes për vitin 2024, sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022”.

- Gjithashtu, OSSH sh.a., me anë të shkresës nr. 10346/5 prot., datë 8.11.2023, përcolli pranë ERE-s “Sqarim shtesë në shkresën tonë nr. 10346/3 prot., datë 23.10.2023, ‘Kërkohet mosndryshimi i tarifave të shpërndarjes për vitin 2024, sipas vendimit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022’”, duke sqaruar se kjo kërkesë lidhet me mosndryshim të kushteve (kostove të përfshira) në furnizimin me energji elektrike për mbulimin e humbjeve në rrejtin e



shpërndarjes dhe se rezervon të drejtën për të aplikuar për ndryshim të tarifave vetëm në rast të ndryshimit të kostove të lidhura me mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe plotësoi kërkesën e sipërcituar me anë të shkresës nr.10346/5 prot., datë 8.11.2023, “Sqarim shtesë në shkresën tonë nr. 10346/3 prot., datë 23.10.2023, ‘Kërkohet mosndryshimi i tarifave të shpërndarjes për vitin 2024, sipas vendimit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022”.

- ERE, me shkresën nr. 2236/2 prot., datë 15.11.2023, për të vlerësuar për një tarifë të drejtë në lidhje me kërkesat e paraqitura, i kërkoi shoqërisë OSSH sh.a. të paraqesë në ERE të gjithë të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm lidhur me ushtrimin e aktivitetit të saj si operator i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Në përgjigje të kërkesës së ERE-s, shoqëria, me shkresën nr. 12896 prot., datë 13.12.2023, paraqiti pranë ERE-s informacionin dhe të dhënat paraprake mbi aktivitetin e saj ushtrimor e financiar për vitin 2023 dhe parashikimeve sa i përket vitit 2024.

- Konstatohet se të dhënat e pasqyruara në korrespondencat e sipërcituara nga ana e shoqërisë OSSH sh.a. janë vetëm të dhëna sintetike dhe jo analitike, nuk janë të argumentuara me shpjegimet përkatëse, sa i takon të ardhurave dhe shpenzimeve të shoqërisë për periudhën aktuale, si dhe pasqyrojnë të dhëna mbi aktivitetin të cilat nuk mundësojnë kryerjen e një vlerësimi mbi kostot e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2023.

- Për sa më lartë, vlerësohet se për sa kohë të dhënat ekonomike të viteve 2021–2022 të jenë në proces rivlerësimi dhe auditimi dhe mund të ketë dhe ndryshime të komponentëve përlllogaritës të tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike të cilët më herët kanë shërbyer dhe për miratimin e tarifave nga ERE, me anë të vendimit nr. 73/2022, nuk mund të kryhet një vlerësim mbi kostot të cilat pritet të përballet shoqëria OSSH sh.a. dhe për vitin 2024.

- Me shkresën nr. 6713/1 prot., datë 26.7.2023, shoqëria OSSH sh.a., ka depozituar në ERE “Planin e zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për vitin 2023, si dhe planin e zhvillimit për periudhën 2023–2027”.

- ERE, me shkresën nr. 1858/2 prot., datë 24.10.2023, me qëllim vazhdimin e procesit të shqyrtimit të këtij plani ka kërkuar informacion në plotësim të sa depozituar nga shoqëria.

- Në mënyrë që shoqëria OSSH sh.a., edhe për vitin 2024, të mund të realizojë aktivitetin për të cilin është licencuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në zbatim të nenit 20, germa “c”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, bëhet e domosdoshme të vijojë faturimin bazuar në tarifat e miratuara nga ERE.

- Me përfundimin e gjendjes së emergjencës së furnizimit me energji elektrike, më datë 31 dhjetor 2023, përfundon edhe vendosja e detyrimit të shërbimit publik ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, që kanë kontratë me shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. për shitjen e energjisë elektrike e cila shkon për mbulimin e humbjeve të rrjetit të shpërndarjes. Si rrjedhojë, OSSH sh.a., përgjatë vitit 2024, mund të përballet me faktin e blerjes së sasisë së energjisë elektrike në treg të parregulluar, me qëllim mbulimin e humbjeve të rrjetit të shpërndarjes me çmime të paparashikuara.

- Nëse ERE do të konstatojë një ndryshim të kostove të njohura në përlllogaritjen e tarifave të shërbimit të shpërndarjes të miratuara me anë të vendimit nr. 73/2022, të Bordit të ERE-s, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, diferenca e korigjueshme do të duhet t’i lihet si rezervë shoqërisë, me qëllim përbalimin e kostove të paparashikuara që mund të afektohet për mbulimin e humbjeve të rrjetit të shpërndarjes përgjatë vitit 2024, si dhe rekuperimin e kapitalit negativ të akumuluar ndër vite.

- Shoqëria OSSH sh.a. duhet të marrë masa për përcjelljen në ERE të kostove dhe të ardhurave faktike të shpërndarjes së energjisë elektrike, si dhe të marrë masa në plotësimin e kërkesave dhe dispozitave të akteve ligjore dhe rregullatore në fuqi të cilësuar si më lartë.

- Në zbatim të dispozitave të sipërcituara, kur tarifat e miratuara rezultojnë të ndryshme nga ato të përkohshme, ERE do të vendosë masat e përshtatshme kompensuese sikurse vepruar dhe në procedurat e ndjekura sipas vendimarrjeve respektive të periudhave të mëparshme, në zbatim të parashikimeve të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 182, datë 10.11.2017.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë OSSH sh.a. për vitin 2024, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e shoqërisë OSSH sh.a. do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre, sipas përcaktimeve të nenit 20, germa “c”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe metodologjisë përkatëse, të miratuar nga ERE.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 366, datë 15.12.2023

MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT
TË BORDIT TË ERE-s NR. 74,
DATË 13.4.2022

Në mbështetje të neneve 16, 19, 20, germa “c”, 83 dhe 85, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 6, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë

17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2230/5 prot., datë 13.12.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022”, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 325, datë 14.12.2022, ka vendosur ndër të tjera: 1. të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a. për vitin 2023, për çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal ose konstatimit të ndryshimit të kostove bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- ERE, me shkresën nr. 2230 prot., datë 3.10.2023, ka sjellë në vëmendje të shoqërisë FSHU sh.a., detyrimin për të aplikuar për përcaktimin e çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, në përputhje me nenin 5, pika 3, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal” dhe nenin 21, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016.

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 6836/3 prot., datë 30.10.2023, ka bërë me dije se edhe për vitin 2024 pritet që shoqëria KESH sh.a., të vazhdojë të furnizojë me energji FSHU sh.a., me çmime të reduktuara, duke pasur si synim mosndryshimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për klientët fundorë të cilët shërbehen nga FSHU sh.a. Sipas parashikimeve të FSHU sh.a., çmimet e rregulluara të blerjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a., sigurojnë mbulim të shpenzimeve të reduktuara të FSHU sh.a. dhe një performancë minimale pozitive mbijetese. Në këto kushte, shoqëria FSHU sh.a., për vitin 2024, ka kërkuar që çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 325, datë 14.12.2022, të mos ndryshojnë.

- Në vijim, ERE, me anë të shkresës nr. 2230/2 prot., datë 15.11.2023, ka kërkuar nga shoqëria FSHU sh.a. të paraqesë në ERE të gjithë të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm lidhur me ushtrimin e aktivitetit të saj.



- Në përgjigje të shkresës së ERE me nr. 2230/2 prot., datë 15.11.2023, shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 6836/5 prot., datë 6.12.2023, ka bërë me dije se për shkak të vonesave në vlerësimin e asetëve të OSHEE Group, kryer nga shoqëria audituese “Deloitte” në vitin 2020 dhe raportuar në vitin 2021, është kërkuar që të bëhen ndryshimet dhe aprovimet e nevojshme në Pasqyrat Financiare për vitet 2020 dhe 2021, dhe procesi i auditimit të tyre bashkë me pasqyrat financiare të vitit 2022 është akoma në proces. Gjithashtu, në vijim, shoqëria ka paraqitur të dhëna sintetike në formë tabelore, lidhur me ushtrimin e aktivitetit të saj, pa dhënë sqarimet dhe argumentet përkatëse, sikurse parashikuar në metodologjinë e përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal.

- Në mënyrë që shoqëria FSHU sh.a., edhe për vitin 2024, të mundet të realizojë aktivitetet për të cilat është licencuar, konform ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, bëhet e domosdoshme të vijoje faturimin bazuar në çmimet e miratuara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a., për vitin 2024, për çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e shoqërive, do të bëhet korigjimi dhe kompensimi përkatës i tyre, në përputhje me përcaktimet e nenit 20, germa “c”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe metodologjive përkatëse, të miratuara nga ERE.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën

Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 367, datë 15.12.2023

MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 206, DATË 16.12.2019, “MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË PËRKOHSHME TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA ALBGAS SHA”, PËR VITIN 2024

Në mbështetje të neneve 13, pika 1, 16, pika 2, 17, germa “e” dhe 33, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe të nenit 21, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2232/2 prot., datë 13.12.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi lënie në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, ‘Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a.’, për vitin 2024”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 326, datë 14.12.2022, vendosi ndër të tjera: shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të Bordit të ERE-s, për vitin 2023, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në aplikimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a.

- ERE, me shkresën nr. 2232 prot., datë 3.10.2023, i ka sjellë në vëmendje shoqërisë “Albgaz” sh.a. të paraqesë në ERE një kërkesë për miratimin e tarifave të reja, jo më vonë se gjashtë muaj para hyrjes së tyre në fuqi. Kërkesë e cila duhet të shoqërohet me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin sipas metodologjisë përkatëse.

- Shoqëria Albgaz sh.a., në përgjigje të sa më sipër, me shkresën nr. 118/1 prot., datë 7.11.2023, thekson se rrethanat në të cilat shoqëria “Albgaz” sh.a. zhvillon aktivitetin e saj të përditshëm si OST e gazit natyror, nuk ka pasur zhvillime domethënëse



të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejtë në elementet të cilat përcaktojnë metodologjinë e tarifës. Shoqëria “Albgaz” sh.a. kërkon që për vitin 2024 të mbetet në fuqi tarifa aktuale e transmetimit e miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 326, datë 14.12.2022.

- Neni 17, germa “e”, e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, parashikon se: ERE, mund të miratojë tarifa të përkohshme transmetimi ose shpërndarjeje, në rast kur operatorët e transmetimit ose shpërndarjes krijojnë vonesa në ndryshimin e tarifave. Në këtë rast, kur tarifat e miratuara rezultojnë të ndryshme nga ato të përkohshme, ERE vendos masat e përshtatshme kompensuese.

- Duke pasur parasysh se Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 293, datë 23.10.2023 vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve nga shoqëria “Albagaz” sh.a., që përmban investimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të shoqërisë, si dhe vlerësohet se deri në momentin e paraqitjes së aplikimit të shoqërisë për miratimin e një tarife transmetimi të gazit natyror, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, bëhet e nevojshme shtyrja e fuqisë juridike e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 206 datë 16.12.2019. Për arsye se tarifa e shërbimit të transmetimit të gazit natyror është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit nga shoqëria “Albgaz” sh.a., konform ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe të direktivave të Komunitetit të Energjisë, ku aksesimi në rrjet për përdoruesit e sistemit të transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet t'i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të Bordit të ERE-s, për vitin 2024, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në aplikimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë “Albgaz” sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme, do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre, sipas përcaktimeve të nenit 17, pika “e”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 56, datë 27.12.2023

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME SHKODËR SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM-ja nr.958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 27.12.2023, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin për herë të parë të shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a.’”,

KONSTATON SE:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a., me shkresën nr. 1452 prot., datë



10.11.2023 dhe me shkresën nr. 2302 prot., datë 12.12.2023, plotësim dokumentacioni mbi aplikimin për licencim, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të Shoqërisë Rajonale UK Shkodër sh.a. në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” (VKM-ja nr. 302).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria Rajonale Ujësjetës-Kanalizime Shkodër sh.a. (NUIS M37819701O) është themeluar më datë 5.4.2023, me aksionarë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51%, dhe bashkitë Shkodër me 36.33%, Vau-Dejës me 3.23%, Malësi e Madhe me 6.39%, Pukë me 2.19% dhe Fushë- Arrëz me 0.86%;

b) Drejtuesi teknik i shoqërisë, z. Lazër Pemaj, është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit në vitin 1989 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958, mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;

c) Drejtuesi teknik i shoqërisë, znj. Blerina Arrtunda, është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, dega Mjedis, profili trajtim uji, në vitin 2017 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958, mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;

d) Shoqëria Rajonale UK Shkodër sh.a. deklaron se ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 172 838 banorë të bashkive UK Shkodër, UK Vau-Dejës, UK Malësi e Madhe, UK Pukë, UK Fushë-Arrëz;

e) Shoqëria Rajonale UK Shkodër sh.a. deklaron se ofron shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura për ITUN Velipojë dhe Shirokë me një kapacitet për rreth 50,000 PE, për 40 000 banorë të qytetit të Shkodrës.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e shoqërisë Rajonale UK Shkodër sh.a., të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësitë tekniko-profesionale, aftësitë financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjetësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë Rajonale UK Shkodër sh.a. është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetës-Kanalizime Shkodër sh.a. me (NUIS M37819701O), në kategoritë:

a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura,

c) Kategoria D - Për përpunimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Rajonale Ujësjetës-Kanalizime Shkodër sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues ligjor: Mark Molla;

b) Drejtues teknik: Lazër Pemaj;

c) Drejtues teknik: Blerina Arrtunda.

3. Zona e shërbimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjetës-Kanalizime Shkodër sh.a. janë bashkitë Shkodër, Vau-Dejës, Malësi e Madhe, Pukë, Fushë-Arrëz.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i Shoqërisë Rajonale Ujësjetës-Kanalizime Shkodër sh.a. detyrohet të nënshkruajë



kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

7. Vendimi i KKRR-së nr.160, datë 30.12.2020, “Për licencimin e Shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Malësi e Madhe sh.a.”, shfuqizohet. Vendimi i KKRR-së nr. 271, datë 28.12.2021, “Për licencimin e Shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a.”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndrichim Shani

VENDIM
Nr. 57, datë 27.12.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 3, DATË 30.1.2023,
“PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME
KUKËS”**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (rregullorja e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 27.12.2023, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 3, datë 30.1.2023, Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Kukës”

VËREN SE:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Kukës, me shkresën nr. 1007 prot., datë 11.12.2023, me lëndë “Kërkesë për ndryshimin e drejtuesit ligjor të shoqërisë” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe rregullores së licencimit, të ndryshuar.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Kukës, për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, të ndryshuar.

3. KKRR-ja ka licencuar Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Kukës, me vendimin nr. 3, datë 30.1.2023, “Për licencimin e Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Kukës, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura”.

4. Drejtues ligjor i Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Kukës, z. Sahit Doçi, ka përfunduar studimet e larta për ekonomi industriale, Tiranë, në vitin 1984.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Kukës të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958, dhe rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Kukës është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,



VENDOSI:

1. Në pikën 2, të vendimit të KKRR-së nr. 3, datë 30.1.2023, “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Kukës” bëhen këto ndryshime:

“Drejtues Ligjor: z. Sahit Doçi”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 58, datë 27.12.2023

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS-KANALIZIME V Lorë SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime”(vendimi i KKRR-së nr. 539),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 27.12.2023, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria

Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e UK Vlorë sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, sipas kërkesës së shoqërisë, me shkresën nr. 2257 prot., datë 29.9.2023, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura” dhe më pas me shkresën nr. 2336/1 prot., datë 6.10.2023, me lëndë “Saktësim i dokumentacionit për dosjen e aplikimit të tarifës”, ka bërë plotësimet përkatëse sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe vendimin nr. 539, të KKRR-së,

KONSTATON SE:

1. Paraqitja e kërkesës së shoqërisë UK Vlorë, për vendosjen e nivelit të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura, është në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin e KKRR-së nr. 539, datë 30.12.2021. KKRR-ja, me vendimin nr. 46, datë 10.11.2023, vendosi për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e nivelit tarifor të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Vlorë.

2. Shoqëria UK Vlorë sh.a. ushtron aktivitetin e saj me tarifa të miratuara nga ERRU-ja, sipas vendimit të KKRR-së nr. 51, datë 28.10.2019, për Bashkinë Vlorë. Me shkresën nr. 2257 prot., datë 29.9.2023, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura”, Ujësjellës-Kanalizime Vlorë propozon nivelet tarifore fikse dhe volumetrike për secilin shërbim, sipas tabelës nr. 1.

Tabela 1. Tarifat aktuale dhe të propozuara nga shoqëria UK Vlorë

| Kategoria e konsumatorëve | Tarifat aktuale | Tarifat e propozuara 2024 |
|-----------------------------|--------------------------|---------------------------|
| A. Shërbimi i FU-së | lek/m³ | lek/m³ |
| 1. Konsumatorë familjarë | 45 | 60 |
| 2. Konsumatorë publik | 100 | 133 |
| 3. Konsumatorë privat | 100 | 133 |
| B. Shërbimi i KUN-së | lek/m³ | lek/m³ |
| 1. Konsumatorë familjarë | 15 | 17 |
| 2. Konsumatorë publik | 25 | 28 |
| 3. Konsumatorë privat | 25 | 28 |



| C. Për shërbimin e përpunimit e ujërave të zeza* | lek/m³ | lek/m³ |
|---|--------------------------|--------------------------|
| 1. Konsumatorë familjarë | | 10 |
| 2. Konsumatorë publik | | 12 |
| 3. Konsumatorë privat | | 12 |
| D. Tarifë fikse shërbimi | lek/muaj/lidhje | lek/muaj/lidhje |
| 1. Konsumatorë familjarë | 100 | 200 |
| 2. Konsumatorë publik | 150 | 400 |
| 3. Konsumatorë privat | 150 | 400 |

3. Shoqëria Ujësjetës-Kanalizime Vlorë sh.a. është e licencuar me vendimin e KKRR-së nr. 245, datë 2.6.2022, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjetës-Kanalizime Vlorë sh.a.” për kategoritë A (për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik) dhe kategorinë C (për largimin e ujërave të ndotura), i ndryshuar. Shoqëria Ujësjetës-Kanalizime Vlorë sh.a. nuk është e licencuar për kategorinë D (për trajtimin e ujërave të ndotura), për këtë arsye, propozimi i shoqërisë për nivel të ri tarifor për shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura nuk është marrë në konsideratë në këtë vendim.

4. Shoqëria Ujësjetës-Kanalizime Vlorë sh.a., në propozimin e saj për nivel të ri tarifor, nuk ka respektuar kriterin e përcaktuar sipas nenit 18, pika 5, të “Metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve UK”, ku citohet se tarifa volumetrike për klientët jofamiljarë llogaritet me koeficientin tarifor maksimal 2 (dy) krahasuar me klientët familjarë.

5. Shoqëria në relacionin e saj e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave sipas argumenteve të mëposhtme:

- nevoja për përmirësimin e performancës financiare dhe mbulimi i kostove operacionale;
- aplikimi për nivel të ri tarifor për shkak të rritjes së çmimeve të materialeve;
- reduktimi i ujit pa të ardhura i cili vazhdon të jetë në nivele të larta;
- përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ujit, rritjen e vazhdimësisë së furnizimit me ujë;
- tarifat e reja të propozuara synojnë edhe mbulimin e shpenzimeve të riparimeve për eliminimin e defekteve apo lidhjeve të paligjshme, instalimin e matësve, rregullimin dhe menaxhimin e rrjetit të furnizimit.

6. Gjatë procesit të analizës teknike ekonomike, sipas metodologjisë së vendosjes së tarifave të përcaktuara në vendimin e KKRR-së nr. 539, datë 30.12.2021, ERRU-ja ka kërkuar informacion të

detajuar për të dhënat e raportuara në modelin e aplikimit dhe në planin e biznesit.

7. Në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe në analizën ekonomike financiare, janë marrë në konsideratë përmeshja nga UK Vlorë e kriterëve të mëposhtme:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, të ndryshuar, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo të kushteve të tjera të tregtimit;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar;

d) kërkesave të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”;

e) orientimin drejt mbulimit të kostove operacionale për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura;

f) tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen;

g) propozimin për miratimin e tarifave për të gjithë zonën për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura, ERRU-ja e gjen të justifikuar, por jo në nivelin e propozuar nga shoqëria, referuar analizës tekniko-ekonomike.

8. Në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë, ERRU-ja ka vendosur detyra për t’u realizuar nga UK Vlorë:

- të aplikojë urgjentisht pranë ERRU-së për licencim për shtimin e kategorisë D të shërbimit për trajtimin e ujërave të ndotura;



b) instalimi i matësve në burim (*bulk meter*), si edhe në matësit familjarë, sidomos në zonat rurale ku shpërdorimi i ujit për vaditje është i lartë në mënyrë, që të realizojë objektivin e vendosur nga ERRU-ja për treguesin e nivelit të matjes;

c) të kryejë vlerësimin e “Ujit të prodhuar” bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përftohet;

d) të organizojë task-forcën me ndihmën edhe të Bashkisë Vlorë, për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetet e furnizimit dhe abuzimet kryesisht për klientët privat (hotele, bare dhe restorante), si dhe për klientët familjarë në zonat rurale;

e) të trajtojë stafin teknik profesionist mbi njohjen, hartimin e bilancit të ujit me të dhëna sa më afër realitetit dhe përlllogaritjen e komponentëve të tij sa më saktë, për të pasur situatë reale mbi UPA:

- të merren masat dhe të bëhen korrigjimet përkatëse gjatë hartimit të bilancit të ujit për vitin 2023 dhe 2024, e në vazhdim;

- të gjejë mundësitë për të nxjerrë jashtë pune rrjetin e vjetër të furnizimit i cili shkakton humbje fizike në nivele të larta;

- të mbajë nën kontroll të gjithë sistemin e furnizimit për të reaguar në kohën e duhur ndaj riparimit të defekteve, për të minimizuar sa më shumë humbjet nga rrjedhjet;

f) të hartojë urgjentisht planin e menaxhimit të aseteve për të orientuar investimet sipas prioritetëve të përcaktuara në të, në mënyrë që të evitohet vjetërsimi i tyre përtej jetëgjatësisë së dobishme për të zvogëluar humbjet nga rrjedhjet dhe eliminimin e rrezikut të cenimit të shëndetit publik nga ndotjet në çarjet;

g) të mirëmbajë sisteme të informacionit teknik dhe financiar, në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave, që të mundësohet verifikimi i të dhënave të parashikuara për t’u realizuar në vitin 2024;

h) të mbajë në sistemet e kontabilitetit kostot e amortizimit të aseteve sipas kërkesave të ERRU-së referuar ndarjes që ka bërë në këtë model aplikimi, në mënyrë që të verifikohet realizimi i investimeve të parashikuara për t’u realizuar në vitin 2024;

i) të ndër marrë masa për përmirësimin e treguesit të normës korrente të arkëtimit duke zbatuar masat e nevojshme për këtë qëllim si: monitorim i klientëve, ndërprerje të shërbimeve të klientëve që

nuk paguajnë, shtimi i qendrave ku paguhen faturat, pagesa bankare, apo pagesa *online*;

j) të hartojë një organigramë të detajuar të stafit dhe përshkrimet përkatëse të punës dhe detaje të tjera që justifikojnë numrin e punonjësve në shoqëri;

k) të monitorohet konsumi i energjisë dhe të menaxhohet për të fituar kontrollin mbi këto kosto, duke zbatuar një sistem për menaxhimin e energjisë, e cila për shoqërinë do të ishte një mënyrë për të zhvilluar dhe zbatuar një strategji afatgjatë për energjinë, duke ndjekur hapat si më poshtë;

- të reduktojë humbjet e ujit, për çdo m³ ujë të humbur që është pompuar dhe ka shkaktuar konsum të energjisë si një nga masat më të rëndësishme për reduktimin e konsumit të energjisë;

- të hartojë një databazë me të gjithë konsumin e energjisë (bazuar te matësit, faturat e energjisë etj.), duke përfshirë të gjitha elementet e energjisë dhe sasitë korresponduese të konsumit dhe kostos;

- të krahasojë dhe kontrollojë konsumin mujor të energjisë me muajin paraardhës, me të njëjtin muaj të vitit paraardhës dhe të shpjegojë nëse është më shumë dhe pse ka ardhur ky ndryshim;

- të realizojë trajnime për eficiencën e energjisë për stafin operativ.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifën e propozuara nga operatori mbi bazën e metodologjisë së miratuar me vendimin nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime”, arrin në konkluzionin se tarifën e propozuara sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuar, si dhe përbalueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik, në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”. Për gjithë sa më sipër, në zbatim të neneve 13, 14 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a., si më poshtë:



Tabela 2. Tarifat e miratuara nga ERRU-ja për shoqërinë UK Vlorë

| Kategoria e klientëve | Tarifa |
|--|--------------------------|
| A. Tarifa volumetrike për shërbimin FU | lek/m³ |
| 1. Klientë familjarë | 60 |
| 2. Klientë publik | 120 |
| 3. Klientë privat | 120 |
| B. Tarifa volumetrike për shërbimin KUN | lek/m³ |
| 1. Klientë familjarë | 17 |
| 2. Klientë publik | 28 |
| 3. Klientë privat | 28 |
| C. Tarifë fikse shërbimi | lek/muaj/lidhje |
| 1. Klientë familjarë | 200 |
| 2. Klientë publik | 400 |
| 3. Klientë privat | 400 |

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2024, për UK Vlorë do të jenë:

Tabela 3. Objektivat e treguesve të performancës për vitin 2024 sipas ERRU-së

| TKP-ja | Nr. | Emri i TKP-ve | Njësia TKP | Objektivat e vendosura nga KKRR-ja |
|-------------------------------|-----|---|--------------------------------|------------------------------------|
| Mbulimi me shërbim | 1.1 | Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë | % | 93.62 |
| | 1.2 | Mbulimi me shërbimin me kanalizime | % | 71.25 |
| TKP-ja teknike | 2.1 | Uji pa të ardhura | % | 65 |
| | 3 | Niveli i matjes | % | 70 |
| | 4 | Vazhdimësia e furnizimit me ujë | orë/ditë/popullsi | 13.5 |
| | 5.1 | Efikasiteti i energjisë për ujin | kwh/m ³ | 0.77 |
| | 6 | Eficienca e stafit | staf/1000 popullsi të shërbyer | 2.01 |
| Shërbimi ndaj klientit | 7.1 | Ankesat e klientëve | % | 6.29 |
| | 7.2 | Ankesat e klientëve që kanë marrë përgjigje | % | 14.11 |
| | 7.3 | Ankesat e klientëve që kanë marrë zgjidhje | % | 8.51 |
| TKP-ja financiare | 8.1 | Norma korrente e arkëtimit | % | 85 |
| | 8.2 | Norma e përgjithshme e arkëtimit | % | 91.49 |
| | 9.1 | Mbulimi i kostove O&M | % | 96.25 |
| | 9.2 | Mbulimi i kostove totale | % | 57 |

3. PAGESA rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a. do të jetë 0.77% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. UK Vlorë detyrohet të nënshkruajë kontratën “Për aplikimin e tarifave të miratuara nga ERRU dhe shlyerjen e pagesës rregullatore”, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

5. Vendimi i KKRR-së nr. 51, datë 28.10.2019, “Mbi tarifën e ujit për konsum publik për shoqërinë UK Vlorë sh.a.” shfuqizohet.

6. Ky vendim hyn në fuqi me datë 1.2.2024 dhe është i vlefshëm deri në 31.12.2025.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndrichim Shani

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

| | |
|--|-----------------|
| | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 480 lekë